

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIII - Nr. 7377 E premte 8 Dhjetor 2017 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion **Ditës**
E nde sot, pohimet e dala mode rreth dijës vazhdojnë të struken prapa mënyrës si mendojnë jo pak specialistë dhe mësues për kurrikulën, për ...
Vijon në faqen 20

Nga PËLLUMB KARAMETA
Dija në "epokën google" dhe rinia



Opinion **Ditës**
Brezat disponojnë vlera të ndryshme në kohëra të ndryshme dhe askush nuk i njeh dhe vlerëson ato realisht më mirë se vetë koha. Por, kjo nuk do të thotë...
Vijon në faqen 21

Nga ROVENA HOXHA
A ka evoluar konflikti midis brezave në Shqipëri?



Vendimi, janë 1138 vetë në të gjithë vendin

ALUIZNI, lista e re me 638 pronarë që do të përfitojnë kompensim nga shteti

Ndërtuan pa leje, tapi edhe për 500 të tjerë që u legalizohen oborret

Nga ORNELA MANJANI

ALUIZNI publikon listën me 500 personat që kanë ndërtuar pa leje dhe marrin tapitë për parcelën ndërtimore dhe 638 pronarët që u është prekur toka nga ndërtimet pa leje dhe marrin kompensimin për truallin. Përfituesit ...
Në faqen 16-19

HAPEN PROCEDURAT PËR KREUN E RI TE PROKURORISE, KRITERET. ZBARDHEN DEBATET TE 'LIGJET'

'KRYEPROKURORI', KREU I PD: VETING. RAMA: FILLOI AVAZI

SHBA e BE: Të ikë Llalla, të zgjidhet prokuror i përkohshëm. Kryemadhi: Të respektohet Kushtetuta. Nishani: Duhet 94 vota



(Në foto) Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

TAKIMET PER BASHKEPUNIM

Meta dekoron Muselier në Marsejë, vajzën që i dha lulet Mbretëreshës Geraldinë
Në faqen 9

KERKOEJ NE ITALI

Arrestohet në lokalitetin e basteve i kërkuari Besnik Çapja, avokati: S'ka lidhje me ta
Në faqen 11

VIZITA HISTORIKE

Ndarja e kufijve, Erdogan sherr me Pavlopulos. Na ktheni edhe ushtarët dezertorë
Në faqen 14

IZOLIMI E KUSHTET

Udhëtimi i ferrit në Dukagjin, 150 persona humbën jetën në aksidente, Rahodina apel shtetit
Në faqen 12



"TE PAEKSPOZUARIT"
Themie Thomai: Pse nuk përmyteshim në kohën e Enverit. Si u bëra ministre
Në faqen 10

Rrëfimi i ish-dhjetoristit: "Zonja dhe zotërinj", pedagogu që e tha i pari

Çollaku: Librat e ndaluar që shkëmbejmë me Edi Ramën

"Çfarë bisedohej mes intelektualëve në kafën ku shkonte edhe Berisha"

Nga VALENTINA MADANI

Dhjetor '90. Ishin ditë të drrekshme, por plot ëndrra. Studentët ishin në kërkim të ndryshimit. E nisën mesnatën e së shtunës së 8 dhjetorit. Errësira mbulonte qytetën e tyre. U vunë në kërkim të dritës de-



risa e ndezën atë mes shumë rreziqeve. Nisën kështu përballjen me diktaturën komuniste. Kreshnik Çollaku është njëri nga dëshmitarët e shumtë të revoltës rinore të 8 dhjetorit 1990. Ai sjell ndërmend për "Gazeta Shqiptare" thirrjet e para ...
Në faqen 6-7

KRYEPROKURORI MANDATI

Kryeprokurorit i mbaroi afati, Lu: Ne nxisim Parlamentin të zbatojë ligjin

SHBA e BE: Të ikë Llalla, të zgjidhet prokuror i përkohshëm

Vlahutin: Zgjedhja, me shumicë të thjeshtë

Valentina Madani

Ambasada e SHBA-ve dhe delegacioni i Bashkimit Europian mbështesin procedurën për zëvendësimin e Prokurorit të Përgjithshëm. Njëzëri ata i kërkuar Kuvendit të zbatojë ligjin dhe se mbështesin opinionin ligjor të OPDAT dhe EURALIUS. Ambasadori amerikan, Donald Lu përmes një deklarate për mediat kërkoi dje largimin e kryeprokurorit Adriatik Llalla, duke i bërë thirrje Kuvendit të zbatojë ligjin për zgjedhjen e kryeprokurorit të ri. Kreu i diplomacisë amerikane bën me dije se mbështet opinionin ligjor që OPDAT dhe EURALIUS i kanë dhënë Parlamentit, në të cilin thuhet se, "Kushtetuta dhe ligji për Prokurorinë janë të qarta. Ambasada e Shteteve të Bashkuara mbështet opinionin ligjor, që OPDAT dhe EURALIUS i kanë dhënë Parlamentit. Ne nxisim Parlamentin të zbatojë ligjin". Pas ambasadës së SHBA-ve në Tiranë, reagoi edhe delegacioni i Bashkimit Europian për çështjen e zgjedhjes së kryeprokurorit të ri të Shqipërisë. Zyra e BE në Tiranë kërkon nga Kuvendi që të nisë procedurat për zgjedhjen e prokurorit të ri, të përkohshëm në përfundim të mandatit të Llallës. "Ligji për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë parashikon dispozita të qarta transitore, siç konfirmohet nga EURALIUS dhe OPDAT në opinionin e tyre në Kuvend. Ne e ftojmë Kuvendin të procedojë në respekt të plotë të ligjit", shprehet BE. Sipas konkluzioneve të BE: "Në situatën që paraqitet këtu, duket se dispozitat kalimtare përcaktojnë të drejtën dhe detyrimin e Kuvendit të zgjedhë një prokuror të lartë, i cili i plotëson kërkesat e neneve 22 deri 27 të ligjit, si prokuror i përkohshëm



Romana Vlahutin dhe ambasadori amerikan, Donald Lu

hëm me shumicë të thjeshtë, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të Kuvendit". BE përmend Kuadrin ligjor për periudhën kalimtare: Neni 179, paragrafi 13 i Kushtetutës thotë:

"Deri në zgjedhjet par-

lamentare, të cilat do të mbahen pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, por jo më vonë se 1 shtatori 2017, zgjedhja e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe Prokurorit të Përgjithshëm do të bëhen nga 2/3 e anëtarëve të Kuvendit. Zgjedhjet e tjera do të

VOTIMI

"Dispozitat kalimtare përcaktojnë të drejtën dhe detyrimin e Kuvendit të zgjedhë një prokuror të lartë, i cili i plotëson kërkesat e neneve 22 deri 27 të ligjit, si prokuror i përkohshëm me shumicë të thjeshtë, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të Kuvendit", thuhet në sqarimin e ambasadës së SHBA.

bëhen nga 3/5 e anëtarëve të Kuvendit". Ngrihet pyetja nëse sigurimi i zgjedhjeve të tjera ka të bëjë me zgjedhjen e kandidatëve të tjerë për organet kushtetuese në periudhën deri më 1 shtator 2017, ose zgjedhjen e kandidatëve të tjerë për organet

"Po shkelet ligji 179/3 i Kushtetutës"

Nishani: Kryeprokurori i përkohshëm zgjidhet me 94 vota

Ish-Prezidenti i Republikës, Bujar Nishani deklaroi dje se zgjedhja e prokurorit të përkohshëm pas mbarimit të mandatit të prokurorit aktual ditën e djeshme mund të bëhet vetëm me 94 vota në Parlament. Nishani shprehet se, edhe pse ka një artific të njëanshme politikisht në ligjin për Prokurorinë, është Kushtetuta ajo që prevalon. Sipas tij, bazuar në ligjin 179/3 të Kushtetutës, "nëse maxhoranca do t'i qëndrojë nocionit të prokurorit të përkohshëm, referenca kushtetuese për këtë moment procedural kërkon dy të tretat e votave, pra 94. Nëse do referohet zgjedhja e tij me 84 vota, duhet propozimi nga KLP. "Kushtetuta, neni 179/13 citon Deri në zgjedhjet parlamentare, që do mbahen pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, por jo më vonë se data 1 shtator 2017, zgjedhja e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe e Prokurorit të Përgjithshëm do bëhet me dy të tretat e anëtarëve të Kuv-



endit (94 vota). Zgjedhjet e tjera do të bëhen me tri të pestat e anëtarëve të Kuvendit (84 vota)". Kjo është Kushtetuta, e zeza mbi të bardhë, që nuk e lëviz as topi, as kryeministri, as parlamenti dhe asnjë përfaqësues ndërkombëtar. Është e vërtetë që ka një artific (i njëanshëm politikisht) në ligjin për Prokurorinë. Por ka një hierarki juridike në çdo vend demokratik. Kushtetuta prevalon mbi çdo ligj. Kushtetuta është ligji themelart, që qëndron i pari në hierarkinë e tërësisë së legjislacionit të një shteti ligjor", deklaroi z.Nishani. Sipas Nishanit, këtë përcaktim të Kushtetutës nuk mund ta lëvizë

"as topi, as kryeministri, as Parlamenti dhe asnjë përfaqësues ndërkombëtar".

"Kryeministri nuk ka asnjë tagër dhe asnjë hapësirë apo mundësi që të propozojë procedurë", tha ai. "Ndaj, oferta e tij ndaj opozitës është thjesht një kurth për betejë të imazhit publik".



kushtetuese në çfarëdo periudhe kohore. Zyra e BE-së në Tiranë sqaron më tej: "Kushtetuta parashihet disa organe kushtetuese që do të zgjidhen nga Kuvendi, këshu që për shembull: Neni 125 paragrafi 2 përcakton një kuorum prej 3/5 për gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, të cilët zgjidhen nga Kuvendi. Neni 147, paragrafi 8 përcakton kuorumin prej 2/3 për miratimin e listës për anëtarët për pozicion të KLG. Neni 147/d, paragrafi 3 përcakton një kuorum prej 3/5 për zgjedhjen e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (HJ) nga lista e themeluar nga Këshilli i Emërimit të Drejtësisë. Neni 148/a përcakton kuorumin prej 3/5 për zgjedhjen e Prokurorit të Përgjithshëm me propozim të Këshillit të Lartë Prokurorial. Neni 149 paragrafi 8 përcakton kuorumin prej 2/3 për miratimin e listës për anëtarët të Këshillit të Lartë Prokurorial".



Petrit Vasili

LSI, KRITIKA SHBA-ve

Vasili: Të huajt s'mund të sillen si pushtues

LSI kritikon ndërkombëtarët për qëndrimin ndaj kryeprokurorit, duke e cilësuar sjelljen e tyre si pushtuese. Njësoj si PD, edhe LSI kërkon që Adriatik Llalla të qëndrojë në detyrë deri sa të shkarkohet nga KLP. Kreu i grupit parlamentar të LSI, Petrit Vasili, shkruan se cilitdo qofshin ata të huaj nuk mund të sillen si pushtues dhe të bekojnë kapjen e drejtësisë nga kanalizimi i kryeministrit. Vasili shkruan në 'FB' se zbatimi i reformës në drejtësi ka hyrë në rrugë shumë të rrezikshme të antikushtetutshmërisë dhe antiligjit, që dëmton shtetin e së drejtës dhe instalon një pushtet të kriminalizuar të antiligjit. "Të huajt, cilitdo qofshin, nuk mund të sillen si pushtues dhe të bekojnë kapjen e drejtësisë nga kanabisit i kryeministrit. Ka vetëm një Kushtetutë dhe as Kuvendi dhe asnjë mision i huaj nuk kanë as më të voglën mundësi ta tjetërsojnë dhe interpretojnë, pasi Kushtetuta nuk ua jep këtë të drejtë. Shqipëria është republikë kushtetuese dhe jo republikë e kanabisit. Po, kryeministri, qeveria dhe kushdo tjetër që kërkon të shkelet Kushtetuta është si ata", shprehet z.Vasili.

REDAKSIONI: Redaktor i Suplementeve dhe Socials: Rezarta Delsula, Redaktor i Rrethave: Trëndafille VISHA, Redaktor i Kulturës: Fatmira Nikolli, Art Designer: Nevila SAMARXHI.

ADMINISTRATA: Përgjegjëse e Financës: Alma Smokthina 0682074397, Shpërndarja: Elvis Llaka Cel 0682074416, Marketingu: Cel:0682074415-email:marketing@gazetashqiptare.com, ADRESA: Ish-Drejtorja e Uzinës së Autotrafikut, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116, Marketingu: Tel:(04) 2359-104/0359-123, Tiranë. Internet: www.gsh.al, Email: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, SHTYPUR në "Klasik" Shpk



EDI RAMA

"Rifilloi avazi! Jo ne, po edhe SHBA-BE e kanë gabim! Dhe prapë s'duan as dialog kur u thua votat ne i kemi, po duam zgjidhje të përbashkët. Sidoqoftë, unë e përsëris ftesën për dialog dhe zgjidhje të përbashkëta, aq më tepër në këtë fazë vendimtare të rrugëtimit të vendit drejt çeljes së negociatave për anëtarësim".



LULZIM BASHA

"I vetmi 'pakt' që ka nevojë Shqipëria është pakti për Kushtetutën dhe shtetin ligjor. Kushtet që BE ka vendosur për Shqipërinë janë të qarta: zbatimi i reformës në drejtësi dhe vetting, lufta kundër drogës dhe krimin, lufta kundër korrupsionit, reforma e administratës publike, respektimi i të drejtave themelore të njeriut".

Prokurori i Përgjithshëm, kreu i PD-së refuzon propozimin e kryeministrit

Basha: Nuk ulem, të zgjidhet me veting. Rama: Rifilloi avazi

"Votat i kemi, por duam zgjidhje të përbashkët"

Spartak Ngjela: Ja pse nuk jep dorëheqjen Llalla

Avokati Spartak Ngjela u shpreh dje në një status në faqen e tij të "Facebook" se Llalla do të bllokoi shtetin. "Pyetja kryesore është kjo: pse nuk jep dorëheqjen Prokurori i Përgjithshëm? Sepse do të bllokoi shtetin. Po ky është krim. E di prokurori këtë, që ai ka qenë në atë post për shtetin dhe jo kundër shtetit? Po, a ka qenë ky prokuror ndonjëherë për shtetin dhe me shtetin? Askush nuk e beson se mund të ketë qenë ndonjëherë me shtetin", ngriti dje pyetjen Ngjela. "Parlamentet janë të zgjedhur nga populli, nuk janë institucione të emëruara. Pikërisht për të mbrojtur shtetin nga krizat. Nëse Saliu me prokurorin e tij kërkojnë të hedhin shtetin në krizë, parlamenti duhet të veprojë. Si ka mundësi të mos zgjedhë Parlamenti prokurorin e përgjithshëm të përkohshëm kur këtë ia kërkon ligji? Pyetje profesionale është kjo: Po nëse befas u cmend KLP dhe do të bllokoi shtetin me një krizë institucionale? Sigurisht që parlamenti e zgjidh... Dhe e fundit: nëse prokurori nuk i ka mbaruar afati i mandatit, mandat ky i dhënë nga Parlamenti, sigurisht që ai ka të drejtë ta kërkojë", u shpreh Ngjela.

Ministri Bushati merr pjesë në Ministerialin e OSBE-së në Vjenë

Me ftesë të Ministrit të Evropës, Integrimit dhe Punëve të Jashtme të Austrisë, Sebastian Kurz; ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati, merr pjesë në takimin e 24-të të Këshillit Ministror të OSBE-së, në Vjenë, nën kryesinë austriake të OSBE-së. Në këtë takim, i cili përfundoi kryesinë austriake të OSBE-së, ministrat do të përgëndrohen në analizën e përpjekjeve të bëra për të zgjidhur konfliktet dhe për të adresuar sfidat në hapësirën e OSBE-së, veçanërisht për zgjidhjen e krizës në Ukrainë dhe përeth saj. Gjatë fjalës së tij, ministri Bushati u ndal në krizën në Ukrainë, duke u bërë thirrje "të gjitha palëve të zbatojnë me shpejtësi dhe plotësisht marrëveshjet e Minskut dhe të respektojnë angazhimet e tyre". Duke iu referuar Kosovës, ministri Bushati theksoi se, "OSBE nuk duhet të diskutojë për Kosovën, pa Kosovën, si pjesë e diskutimit". Bushati, zhvilloi një takim me ministrin e Jashtëm dhe Kancelarin e zgjedhur të Austrisë, Sebastian Kurz. Biseda u përqendrua te perspektiva evropiane e Shqipërisë, duke pasur parasysh që Austria ka presidencën BE-së për vitin e ardhshëm.

Darina Tanushi

Zgjedhja e Prokurorit të Përgjithshëm, pas përfundimit të mandatit të Adriatik Llalës ka ndezur sërish debatet mes mazhorancës dhe opozitës. Kur ende nuk është ngritur Këshilli i Lartë i Prokurorisë, institucioni që ka kompetencë të zgjedhë Prokurorin e ri të Përgjithshëm, sipas reformës në drejtësi, kryeministri Edi Rama dhe mazhoranca i propozuan opozitës të gjejnë një marrëveshje për të zgjedhur këstu një zëvendësues të Llalës, deri në ngritjen e KLP-së. Pas ftesës së bërë nga kryeministri, kryetari i PD-së, Lulzim Basha reagoi dje duke e refuzuar atë dhe duke i kujtuar Ramës se opozita do të bëjë vetëm "pakt" me Kushtetutën dhe ligjin. "I vetmi 'pakt' që ka nevojë Shqipëria është pakti për Kushtetutën dhe shtetin ligjor", u shpreh dje Basha. "Në mbështesim pa asnjë kusht përpjekjen për përmbyshjen e secilit prej këtyre kritereve. 1. Në mbështesim pa asnjë rezervë zhbllokimin e menjëhershëm të reformës në drejtësi dhe krijimin e KLP-së për t'i hapur rrugën krijimit të SPAK-ut dhe të byrosë së hetimit dhe zgjedhjen e Prokurorit të Përgjithshëm në mënyrë kushtetuese, pasi të ketë kaluar vettingun dhe me tre të postat e Kuvendit. 2. Në mbështesim heqjen e imunitetit të Saimir Tahirit dhe hetimin e të gjithë zyrtarëve të lidhur me krimin nga Vangjush Dako dhe Qazim Sejdimi tek shefat e policisë", u shpreh kreu i PD-së, duke renditur 4 kritere. Ndërkohë, mbrëmë duke folur për emisionin "Të Paekspozuarit" në "News 24", Lulzim Basha tha: "Nuk ka asgjë personale me Ramën. Në situatën aktuale janë 3 probleme për çështjen e zgjidhjes së kryeprokurorit. I pari është procesi i anti-kushtetutshmërisë. I dyti është se është një proces politik, pra mazhoranca thotë se



Rama në Bullgari: Koha që Shqipëria e Maqedonia të nisin negociatat

Është koha që Shqipëria e Maqedonia të nisin negociatat", deklaroi dje kryeministri Edi Rama në konferencën rajonale të organizuar nga qeveria e Bullgarisë dhe Banka Botërore, në Sofje, mbi integrimin e Ballkanit në Bashkimin Evropian. "Ndërkohë - theksoi Rama - mbështesim faktin që Serbia dhe Mali i Zi po negociojnë". "Kjo është një kontradiktë në mënyrën se si e shoh unë midis të qenit kaq shumë i përkushtuar ndaj procesit të integritimit nga njëra anë dhe nga ana tjetër, ka ardhur koha për palën evropiane që të ketë qartësi, se cila do të jetë perspektiva jonë", tha Rama. Në të njëjtën kohë, sipas kryeministrit Rama, mosfillimi i bisedimeve duket se bëhet një ushtrim frustrues. "Nuk kanë kaluar 300 as 30 vjet, por vetëm tre vite më parë kur ne nisëm këtë proces të bashkëpunimit rajonal, në të cilin jemi të angazhuar sipas frymës, vizionit dhe modelit evropian - dukej e pamundur. Ja ku jemi si kurrë më parë", tha Rama.



kemi votat vetë. Dhe problemi i tretë është se duan proces pa veting", u shpreh Basha. "Mazhoranca kërkon të bëjë një zgjidhje të tillë dhe nuk ka asnjë mundësi që unë të ulem me Ramën dhe të zgjedh një prokuror pa veting. Ne e kemi dhënë zgjidhjen, kryeprokurori

procurori i Përgjithshëm, kreu i PD-së refuzon propozimin e kryeministrit

nuk mund të caktohet vetëm nga një parti politike dhe nuk mund të jetë një lepu-rush", - tha Basha. Nga ana e tij, kryeministri Rama u shpreh nga Sofja: "LB mos prit të ta lexojnë të huajt Kushtetutën e vendit, po eja të flasim shqip për Shqipërinë, siç e kemi për detyrë nga ata që na zgjidhën". Në një tjetër reagim, Rama shkroi në "FB": "Rifilloi avazi! Jo ne, po edhe SHBA-BE e kanë gabim! Dhe prapë s'duan as dialog kur u thua votat ne i kemi po duam zgjidhje të përbashkët. Sidoqoftë, unë e përsëris ftesën për dialog dhe zgjidhje të përbashkëta, aq më tepër në këtë fazë vendimtare të rrugëtimit të vendit drejt çeljes së negociatave për anëtarësim, kur Shqipëria duhet të fitojë mbi partitë e mbi çdo interes apo frikë të njërit ose tjetrit". Në një prononcim për mediat, nga Bullgaria, Rama tha se "ftesa ime është për një pakt kombëtar evropian, në funksion të çeljes së negociatave si një stacion i Shqipërisë dhe jo i qeverisë vetëm dhe për ta shfrytëzuar këtë çështje të Prokurorit të Përgjithshëm si një pikënisje të rëndësishme duke u nisur nga fakti se parvarësisht se ne kemi mundësinë kushtetuese të një zgjedhje me shumicë të thjeshtë, të krijojmë kushtet që të kemi një zgjedhje të mirëkuptuar me opozitën dhe nga ana tjetër që opozita të përfshihet plotësisht në procesin e mbështetjes së Shqipërisë për të çelur negociatat". "Unë kam për borxh të bëj deri në fund atë që më takon e sigurisht pastaj borxhet që opozita i ka vendit janë borxhet që opozita vetë duhet t'i konsiderojë e t'i trajtojë si të tilla", përfundoi Rama.

KRYEPROKURORI DEBATET

Debate në Komisionin e Ligjeve, PD-LSI ikin nga mbledhja: Jeni në panik

'Kryeprokurori', Halimi: Doni ta zgjidhni për Vitin e Ri. Manja: Jeni antievropianë

Kuvendi hap procesin: 5 ditë kohë për aplikantët

Darina Tanushi

Komisioni i Ligjeve hap dje garën për vendin e Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës, pas përfundimit të mandatit të Adriatik Lallës. Anëtarët e këtij komisioni kanë debatuar për gati tri orë, por në fund deputetët e opozitës janë larguar nga salla e mbledhjes. Ndaj edhe vendimi u miratua vetëm me 10 votat e deputetëve të PS-së, në Komisionin parlamentar të Ligjeve. Sipas vendimit të publikuar në faqen e Kuvendit, brenda 5 ditëve që përfshijnë dhe tri ditët e pushimit zyrtar, deri të martën të gjithë prokurorët që besojnë se plotësojnë kriteret mund të aplikojnë pranë Komisionit të Ligjeve për të qenë kryeprokuror. Këta kandidatë duhet të kalojnë në sukses vetëngun, duhet të mos preken nga ligji i dekriminalizimit, të mos kenë qenë anëtarë, bashkëpunëtorë ose të favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990; të mos jenë bashkëpunëtorë, informatorë ose agjentë të asnjë shërbimi sekret. Po kështu kandidatët për kryeprokuror duhet të mos jenë dënuar më parë me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale dhe të mos jenë larguar nga detyra për shkakë disiplinore, si dhe të mos kenë masë disiplinore në fuqi. Ndërkohë në Kushtetutën e vendit përcaktohet se Prokurori i Përgjithshëm zgjidhet nga radhët e juristëve të spikatur; me jo më pak se 15 vjet përvojë pune, me integritet të lartë moral dhe profesional, që kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës ose kanë një gradë shkencore në drejtësi. Kandidati nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike, ose pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit.

Pas aplikimeve, Komisioni i Ligjeve do të zhvillojë seanca dëgjimore me të gjithë kandidatët dhe brenda dy ditësh pasi të ketë përfunduar dëgjimet, do të përgatit raport për



Mbledhja e djeshme e Komisionit të Ligjeve

secilin kandidat drejtuar Seancës Plenare. Do të jetë kjo seancë që do të vendosë përmes votimit të zgjedhë kryeprokurorin e ri të

përkohshëm, i cili do të ushtrojë detyrën deri në ngritjen e Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Prokurori i përkohshëm duhet të emërohet brenda

afatit 30-ditor. Në fillim të mbledhjes kryetari i komisionit, Ulsi Manja i kërkoi opozitës të bëjnë diskutim juridik dhe të lënë mënjane emocionin politik. "Në kushtet e moskrijimit të KLP-së, Prokurori i Përgjithshëm zgjidhet në bazë të eksperiencës. Kuvendi cakton një nga prokurorët me më shumë eksperiencë", tha Manja. Ndërsa deputetët Alibeaj e Halimi të PD-së sqaruan qëndrimin e tyre, sipas të cilit duhet respektuar Kushtetuta. "Po tentoni të rrëmbeni kreun e akuzës", tha Alibeaj.

Hedhja e shortit për KED



Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, hidhet shorti, kush janë 12 anëtarët

Debate të forta shoqëruan dje edhe hedhjen e shortit për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi. Deputetët e PD-së dhe të LSI-së e cilësuan shortin dje antikush-tettes. Në fjalën e tij, deputeti i PS-së, kreu i komisionit të Ligjeve, Ulsi Manja ftoi opozitën të bëhet pjesë e procesit. "Kërkoj mirëkuptimin e opozitës që nëse duam të mos humbim kohë në krijimin e organeve të reja të sistemit të drejtësisë, hajdeni, i bëjmë ndryshimet kushtetuese me konsensus, bujrum të zhbllokojmë ligjin. Boll kanë pritur shqiptarët për të pasur atë sistem drejtësie që duhet. Për mua ky debat është më tepër politik, e lëmë të salla e ditës së enjte", - tha Manja. Nën kryetarija e Kuvendit, Vasili-ka Hysi u shpreh se kryetari i Kuvendit ka të drejtë të bëjë vetëm një procedurë, hedhjen e shortit "ju dila kudo të flisni, në studiu e ta diskutojmë, të vazhdojmë me procesin". Deputeti i PD-së, Eduard Halimi u shpreh se: "Qëndrimi ynë është që Këshilli i Përkohshëm i Emërimeve në Drejtësi ishte vetëm për vitin e kaluar nuk ka më këshill të përkohshëm të emërimeve". Deputeti i LSI-së, Nasip Naço ashtu si PD e ka qajatur antikush-tettes shortin. "Ligjet i kemi pasur, por nuk i kemi zbatuar korrekt. Kjo që kërkun kryetari i Kuvendit, ekstra procedurë, që thotë jam burri më i mirë në botë. Shortin e kemi hedhur se nuk u ranë gjyqtarët që donit ju", - tha ai. Më pas, gjyqtarët Besnik Imeraj dhe Altina Xhoxhaj janë përzgjedhur si anëtarë të KED nga lista e Gjykatës Kushtetuese, ndërsa dhe Vitorë Tushaj u zgjodh anëtar zëvendësues nga ajo listë. Artan Broci u përzgjedh si anëtar nga lista e Gjykatës së Lartë, ndërsa zëvendësues për këtë institucion u zgjodh gjyqtari Shkëlzen Selimi. Prokurorja Rovena Gashi u zgjodh pa short anëtare e KED, pasi ishte e vetmja kandidat e paraqitur nga Prokuroria e Përgjithshme. Për anëtarin zëvendësues të Prokurorisë së Përgjithshme nuk u hodh shorti, pasi nuk pati kandidatë.

DEBATET NË KOMISIONIN E LIGJEVE

Ulsi Manja: Nuk duam konflikte me opozitën. Emocionet politike t'i lëmë mënjane. Të bëjmë debat të pastër dhe juridik. Nuk duam zgjidhje të njëanshme. Nuk është parashikuar zgjatja e mandatit të kryeprokurorit, Lallës i mbaron sot mandati 5-vjeçar. Deri në krijimin e KLP-së detyrën e kryeprokurorit ta ushtrojë përkohësisht një prokuror me eksperiencë. Sot do të përcaktojmë procedurën për kryeprokurorin e ri të përkohshëm.

Bledi Çuçi: Kuvendi gjendet në një situatë juridike që duhet brenda 30 ditëve të caktojë një prokuror për të kryer funksionet e Prokurorit të Përgjithshëm. Nuk është as emërim, por caktim për kryerjen e Prokurorit të Përgjithshëm dorë të krijohen organet kushtetuese që kanë të drejtë për të emëruar prokurorin e ri. Në si komision në bazë të nenit 111, pika 7, të rregullores së Kuvendit jemi mbledhur për të miratuar një projekt vendim për miratimin e procedurës për emërimin e prokurorit të përkohshëm. Duhet të plotësojmë kriteret që prokurorin e ri që do të ushtrojë detyrën deri në emërimin e prokurorit të ri dhe për analogji sikur kemi bërë edhe me institucionet e tjera, miratim një vendim për procesin. Këtë duhet ta bëjmë brenda 30 ditëve, që duhet të marrë vendimin. Duke qenë se ka edhe pushime zyrtare për shkak të festave, do të doja që ky projekt vendim të bëhet sa më shpejt në mënyrë që të garantohet e gjithë tregu e prokurorëve, rreth 400 që të shprehin interesin.

Eduard Halimi: Jemi kundër sekretarit të përgjithshëm, që dje të shohim 84 vota për emërimin e kryeprokurorit. Askush nuk e kishte menduar që pas 3 vitësh PS do të shpikte Prokuror të Përgjithshëm të përkohshëm për punët tija. Jemi përplasar në Komisionin e Venecias i Prokurorit e Përgjithshëm, Komisioni i Venecias i tha qartë: Prokurori i Përgjithshëm nuk do të emërohet nga partitë politike.

Ulsi Manja: Kemi të bëjmë me një Prokuror të Përgjithshëm, që është prokuror i asaj zyre me ndryshimet nga reforma në drejtësi. Ligji nuk parashikon zgjatjen e mandatit të kryeprokurorit.

Genç Gjencaj (sekretar i përgjithshëm i Kuvendit): Në asnjë rast ne nuk kemi thënë që kuorum për zgjedhjen e Prokurorit kërkohet 84 vota. Kjo është për tu qartësuar. Ajo që kemi në tryezë ka të bëjë vetëm me dy memo: e para ka të bëjë me konstatimin e vakancës së Prokurorit të Përgjithshëm. Në nuk vlerësojmë risinë prokurorit i përkohshëm duhet të zgjidhet me 84, 71 apo 16 vota. Jemi ju që do orientoni Kuvendin. Memo e dytë ka të bëjë me faktin e moskrijimit të KLP-së.

Enkelaj Alibeaj: Interesi i medias dhe publikut e tregojnë se djepa e pazakontë po ndodhi. Ju po filloni procedurën për të emëruar prokurorin. E pazakontë, pasi çështja nuk ka qenë në kalendarin punimeve dhe pa kaluar procedurën, gjendë në tryezën e Komisionit të Ligjeve. Ku e gjen të drejtën sekretari i Kuvendit të inicijonë një procedurë parlamentare. Nuk është tentativë apo aludim që një parti kërkoi të kapë prokurorin e përgjithshëm, sot është fakt. Po tentoni të rrëmbeni kreun e akuzës për ato kompetenca që ka, çdokush e kupton nga buron frymëzimi. Ju mund të keni edhe probleme me Liallin, por më shumë me dosjet dhe ju shtrë të merreni në nisim në shkollë të drejtësive. Duhet t'i thërrasim arsyesh dhe të pozicionohemi ju kundër një individi, por Kushtetutës. Ftesa është edhe politike, se nëse do të hidhni këtë hap të gabuar, veçse do të potencioni konfliktin politik të kësaj vendi, do të bëni një kapje të pastër të drejtësisë. Do të godisni besimin publik të reforma në drejtësi. Sot nuk ka një ngjërë të paqëndrueshmë. Ju po e shpikni ngjërën. Për Prokurorin e Përgjithshëm nuk ka një dispozitë, fakti që

mbetet që Kushtetuta e reformuar nuk ka përcaktuar një rregull që atij i ndërpritet mandati. Deri këtu mund të ketë edhe dilema. Ka pasur edhe më parë dilema. Ima Rama u emërua në bazë të një mandatit të pakufishëm, më pas u vendos që të ishte 5 vite mandati, e përcaktuam me procedurë. Po ashtu edhe drejtësi i ILDKP, e ka pasur mandatin 5 vite, u ndryshua me ligj lu bu 7, dillema ishte e njëjta, 5 me të vjetërin apo 7 me të reën: ju thate jo 5, por 7. Kushtetua në nenin 148/ C parashikon saktë: Deklarimin e përfundimit të mandatit të Kryeprokurorit e bën KLP. Edhe ligji për prokurorinë thotë të njëjtin gjë. Kemi mundësi të zgjidhim këtë problem në mënyrë fisnike dhe dinjtoze, në të kundërt është minim i klimes politike në vend. Tani zgjidhni ose do të jeni dinjtoze me veten ose do i hidhni minat këty vendi.

Ulsi Manja: Në mungesë të Zv-prokurorit të Përgjithshëm po vendosim prokurorin e përkohshëm. Në jemi sot këtu për të zgjidhur këtë situatë ligjore. Kushtetuta flet qartë, në rastin konkret nuk ka parashikim me zgjatjen e mandatit të kryeprokurorit. Mandati mbaron sot. Kjo është arsyeja pse në i lexova me shkrim argumentet, se Kushtetuta nuk t'i fall gabimet.

Nasip Naço: Grupi i LSI e ka ndjekur me vëmendje. Shumica është e interesuar për ta zgjedhur me shumicë të thjeshtë, pa konsensus me opozitën. Do të kërkoja që shumica të reflektonte. Zgjidhja me 37 deputetë në seancë. Kemi frikë dhe panik, kërkoni të kapni Prokurorin e Përgjithshëm.

Oerd Blythkashi: Kjo është Kushtetuta që bazohet në ligji dhe jo në memo. Po ndërtoni një Kushtetutë me defekte dhe boshllëqe të rënda, sa duket si kamionçinë. Ju kërkoni që të mblyni dosjet e nxehta që kemi. Prokurori i ri i përkohshëm mund të lëvizë prokurorët apo shkaktojë, ka kompetencën të plotë. Në në çdo rast kemi detyrimin të ngremë KLP-në, ose Gjykata Kushtetuese e mbyll përfundimisht këtë diskutim, por ky komision nuk e bën dot. Ta mblymim këtë histori. Ju sot jeni gati të kapërceni të bëni trespahës mbi trupin e Kushtetutës me problemet që ka ajo, vetëm e vetëm për një gjë që prokurori që do disiplinonë prokurorët e Krimeve të Rënda që kanë në dora përshirë që ju djeqin ju, të miratohet me 36 vota gjithërisht ata që u mbrojnë me imunitet. Kërkoni që prokurori të mbrojë ata që ju i mbron me imunitet.

Eduard Halimi: Ju kërkoni të zgjidhni kryeprokuror për 30 ditë, pra për festat e Vitit të Ri. Duhet të shprehni se nuk e kemi kompetencën për të kërkuar zgjatjen e mandatit të kryeprokurorit... Në zgjedhim Kushtetutën. Ju ligjin. Këtu mbaron!

Opozita largohet nga Komisioni i Ligjeve pas debatare për zgjedhjen e kryeprokurorit të ri të paktën të kishit ndjenjor për respekt, kështu për hallin që kanë janë gati të bëhen antievropianë dhe antiamerikanë.

Bledi Çuçi: Mendoj se duhet të bëjmë me konsensus deri në fund zgjedhjen e prokurorit të ri. SHBA dhe BE janë shumë të qartë dhe është në harmoni me qëndrimin e shumicës, duhet prokurori i ri i përkohshëm. Do të domim konsensus.

Ulsi Manja: Opozita nuk ka hallin e ligjit, por halli i tyre ka qenë dhe mbeten emrat, për në mbeten prioritet konsensusi dhe jo emrat. Kërkoni që prokurori i përkohshëm duhet të jetë me profil të lartë dhe me integritet. Falënderim të mjeton e SHBA dhe BE, më vjen mirë që ishim në të njëjtin gjatësi vale. Këqardhje për opozitën, ligjet e vendit më mirë i lexojnë partnerët ndërkombëtarë sesa opozita, që e lexon me syze politike. Nuk kemi asnjë qëllim për emrin e prokurorit të ri. Ftesë për opozitën që të japë kontributin e saj.

ANËTARËT E KËSHILLIT TË EMËRIMEVE NË DREJTËSI:

- Besnik Imeraj - Gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese
- Altina Xhoxhaj - Gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese
- Artan Broci - Gjyqtar i Gjykatës së Lartë
- Rovena Gashi - Prokuror nga Prokuroria e Përgjithshme
- Enton Dhimitri - Gjyqtar nga Gjykatat e Apelit
- Fatos Qato - Gjyqtar nga Gjykatat e Apelit
- Gentian Trenova - Prokuror pranë Gjykatave të Apelit
- Fatjona Memçaj - Prokuror pranë Gjykatave të Apelit
- Ahmet Jangulli - Gjyqtar nga Gjykatat Administrative

ANËTARËT ZËVENDËSUES

- Vitorë Tusha - Nga Gjykata Kushtetuese
- Shkëlzen Selimi - Nga Gjykata e Lartë
- Sotiraq Lubonja - Nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë
- Nga Prokuroria e Përgjithshme nuk ka anëtar zëvendësues.



Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi, deklaroi dje gjatë një interviste për "Zëri i Amerikës" se zgjedhja e Prokurorit të Përgjithshëm duhet të bëhet sipas Kushtetutës, e cila kërkon 84 vota dhe jo me shumicë të thjeshtë. Lidhur me ftesën e kryeministrit Rama për t'u ulur në tryezë me PD-në për këtë çështje, Kryemadhi tha se, "çështjet e drejtësisë nuk zgjidhen në tryeza, por zgjidhen në parlament".

Sot të gjithë bien dakord të paktën për faktin që Prokurorit të Përgjithshëm, Adriatik Llalla, i ka mbaruar mandati sot. Debatit lidhet me mënyrën se si interpretohet ligji, apo mënyrën se si interpretohet Kushtetuta, nëse duhet të kemi një kryeprokurore të përkohshme deri në momentin që do të krijohet Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Kemi edhe mendimin e ekspertëve, që thonë që ky Prokuror i Përgjithshëm i përkohshëm mund të zgjidhet edhe me shumicë të thjeshtë në Parlament. I është bashkuar sot edhe ambasada amerikane në Tiranë. Çfarë mendimi keni ju? Pse jeni kundër?

Jo, ne nuk jemi kundër. Jemi për respektimin e Kushtetutës. Ne kemi miratur një Kushtetutë para një viti e gjysmë, pas një debati të jashtëzakonshëm, mbas një pune të madhe të një komisioni Ad Hoc për reformën në drejtësi, e cila është miratur me 140 vota. Për herë të parë në historinë e tranzicionit shqiptar ne kemi miratur ndryshimet kushtetuese, ku 65 për qind e Kushtetutës së Shqipërisë ka ndryshuar, e kemi miratur me 100% të votave në Kuvendin shqiptar. Kemi bërë ndryshime saqë kemi vendosur edhe data në Kushtetutë, kemi vendosur afate, kemi vendosur detaje, për të vetmen arsye që kur të vijmë në këtë proces ku jemi ne sot të mos kemi asnjë lloj mundësie interpretimi. Dhe tashmë ne kemi dy interpretime: I pari nga Këshilli i Monitorimit të Kuvendit dhe i dyti që vjen nga EURALIUS dhe OPDAT. Njëri thotë zgjidhet me 84 vota, ndërsa tjetri thotë zgjidhet me 36. Është shumë e rëndësishme që ne të kemi një standard. Shqipëria vazhdon në këtë periudhë tranzicioni, vazhdon të krijojë mosbesim në institucionet e saj, qoftë shtetërore apo të demokratike dhe kjo ka ndodhur për shkak të zbatimit të ligjit me dy standarde. Në qoftë se ne kemi një Kushtetutë, e cila thotë se prokurori i përhershëm zgjidhet me 94 vota dhe Prokurori i Përgjithshëm i propozuar nga KLP zgjidhet me 84 vota, atëherë kjo është shumë e qartë. Dhe Kushtetuta ka vendosur një dispozitë të tillë, që nuk lë vend për interpretim qoftë nga institucionet konsultative të Parlamentit, por nuk e lë që ta interpretojë as Gjykata Kushtetuese. Pra, as Gjykata Kushtetuese nuk e ka mundësinë dhe fuqinë ligjore për të interpretuar vendimet kushtetuese, që ne i kemi marrë 1 vit e gjysmë më parë. Problemi qëndron nëse ka apo jo vullnet politik për ta zgjidhur. Zgjidhja e çështjes së Prokurorit të Përgjithshëm është nga gjërat më të rëndësishme. Kemi tre muaj që flasim për këtë çështje. Pse vjen ditën e fundit propozimi nga kryeministri që të ulemi dhe të bisedojmë?

Pikërisht në lidhje me këtë doja t'ju pyesja. Ka një propozim

Kryetarja e LSI-së: EURALIUS dhe OPDAT të mos sillen me dy standarde

Kryeprokurori, Monika Kryemadhi: Të respektohet Kushtetuta, ose ta ndryshojmë

"Çështjet e drejtësisë nuk zgjidhen në tryeza, por në Parlament"



të kryeministrit, i cili fton që të zgjidhet çështja e Prokurorit të Përgjithshëm të përkohshëm në një tryezë. Ndoshta mund të shkohet edhe tek varianti i shumicës së cilësuar?

Çështjet e drejtësisë nuk zgjidhen në tryeza, por zgjidhen në Parlament. Nëse do të vazhdojmë të zgjidhim çështjet me tryeza politike, në qoftë se ne do të vazhdojmë të zgjidhim çështjet, të cilat janë shumë të rëndësishme për shqiptarët, siç është reforma në drejtësi, pasi po shpresojmë që të ketë një reformë të tillë që ata të zgjidhin hallin e tyre dhe nëse do të ulemi prapë në tryeza politike, në alishverishe politike, ne nuk kemi bërë asgjë, nuk kemi bërë as reformën në drejtësi dhe as nuk e kemi nxjerrë Shqipërinë nga tranzicioni në të cilin është. Është shumë e rëndësishme të ulemi në institucionet parlamentare. Ne na kanë kaluar të gjitha afatet. Që në shkurt duhet të kishim ngritur Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Këshillin e Lartë Gjyqësor etj. Duhet të ishte ngritur KED. Janë përfaqësuesit e shoqërisë civile, që në njëfarë mënyre po e mbajnë peng ngritjen e KLP-së. Atëherë, hajde të kërkojmë përgjegjësinë ndaj shoqërisë civile. Hajde ulemi dhe të rishikojmë Kushtetutën edhe njëherë. Por, ama ne duhet të fillojmë të vendosim një standard. Nuk mund të përdorim dy standarde. Kur nuk e kemi të shkruar në Kushtetutë që zgjidhet me shumicë të thjeshtë, ta gjejmë dhe EURALIUS, dhe OPDAT, të na e gjejmë ku është e shkruar me shumicë të thjeshtë. Ku, në cilën pikë, në cilin nen, në cilën faqen, në cilin gërmë të Kushtetutës që kemi miratur ne është e shkruar? EURALIUS dhe OPDAT e kanë hartuar Kushtetutën shqiptare. Kjo vjen edhe si rezultat i makutërisë së politikës shqiptare, e cila kërkon të zaptojë të gjitha institucionet dhe të krijojë presion nëpërmjet kapjes së institucioneve. Çfarëdo që të ndodhë, situata në të cilin ne e kemi sot sistemin e drejtësisë është një situatë alarmante, por nuk mund t'i fusim të gjithë në një theks, sepse nuk janë të gjithë të korruptuar, nuk janë të gjithë problematikë e sistemit të

drejtësisë. Ka gra dhe burra shumë të mirë, të cilët përballojnë jetën e tyre me konflikte me kriminelë. Por ka edhe një gjë tjetër, ka një problem tjetër: Problemi është që ne duhet t'u ofrojmë shqiptarëve një standard dhe duhet t'i mësojmë shqiptarët që ka vetëm një standard, nuk ka dy standarde.

Kjo çështje mund të bëhet pengesë për hapjen e negociatave. Ju e dëgjuat deklaratën që z. Juncker bëri para pak ditën në Bruksel, shanset janë të mëdha.

Dëgjova edhe deklaratën e z. Rama, që kërcënoi hapur jo vetëm në BE-në, por edhe në SHBA-të kur tha që ne kemi opsione të tjera në marrëdhënie me Kinën apo Rusinë. Unë nuk mendoj që kjo është zgjidhja e Shqipërisë. Shqipëria është një vend 99% pro amerikan, një vend që e ka parë orientimin e tij drejt Evropës. Madje, edhe lajtmotivi i vizitës së tij në SHBA është "More America in Albania". Kjo është një nga arsyet, të cilat ne e kemi shumë të nevojshme në Shqipëri, të kemi prezencën amerikane sa më të madhe.

Meqenëse thatë "More America in Albania" po i referohem edhe vizitës suaj në Uashington. Do doja një opinion tuaj lidhur me çështjen e drogës në Shqipëri. Sa e përhapur është çështja e drogës në Shqipëri. Ju keni pasur takime në Departamentin e Shtetit lidhur me këtë çështje dhe kryesisht me zyrtarë të byrosë kundër narkotikëve. Çfarë mund të bëhet më shumë?

Ne patëm një takim shumë të gjatë, gati me shumë se një orë me z.v.drejtorin e Byrosë së Luftës kundër Narkotikëve dhe të Zbatimit të Ligjit, z. Don Stolorthy, i cili u njoh me situatën. Sigurisht që ata kanë dënuar për situatën se çfarë po ndodh me krimin e organizuar dhe lëndët narkotike, ku çdo ditë po kapen tonelata të tëra dhe sasi të konsiderueshme të drogës. Por, nuk është vetëm ky problemi. Problemi qëndron në përfshirja e institucioneve shtetërore në trafikimin e kësaj. Ngjarja e radarëve të Ministrisë së Mbrojtjes, të cilët administrohen apo janë menaxhuar nga segmente të

caktuar të grupit të Habilajve, të cilat kanë dalë të qarta dhe hapur në regjistrimet apo në përgjimet që ka bërë Antimafia italiane me vendim gjykatë tregon hapur që institucionet shtetërore kanë qenë totalisht të përfshira, sidomos segmentet e policisë. Kapja e 863 mijë eurove, rreth 1 milion dollarë.

Ju po thonë që situata është në nivel të tillë që e gjithë politika e lartë është e kapur?

Situata është shumë problematike, është shumë e rrezikshme. Unë mund të them vetëm të dhënat e fundit që kanë dalë, që 2.4% e shqiptarëve janë përdorues të kokainës, që është një nga drogat më të shtrenjta. Nuk përdor mamaja ime kokainë, por dorin fëmijët. Pra, janë rreth 70 mijë të rinj përdorues të rregullt të drogave të forta në Shqipëri. Kjo është një situatë alarmante, që ka të bëjë me të ardhmen dhe shpresën e këtij vendi. Ajo që ne diskutojmë dhe kërkuam edhe në takimet që kemi pasur është ndihma dhe prezenca e segmenteve të specializuara, për të zhvilluar me tej luftën kundër krimit dhe trafikimit të lëndëve narkotike, sidomos të drogave të forta.

Pyetja normale që bëhet në këtë rast zj. Kryemadhi është që çfarë përgjegjësie ka partia që ju drejtoni, duke qenë se keni qenë katër vite në qeverisje me PS-në?

Do të ishte hipokrite në qoftë se unë do të justifikohesha. E gjithë klasa politike është përgjegjëse, duke përfshirë këtu edhe veten time, edhe të gjithë pjesëtarët e LSI, por duke qenë pjesë e saj edhe të gjitha partitë politike, edhe media. Për shkak të një stabiliteti fals, ne kemi krijuar një destabilitet të brendshëm. LSI ka qenë katër vjet në pushtet me PD dhe me PS. LSI i kishte shanset për të qenë prapë, prej gjashtë muajsh PS i kërkonte bashkëpunim për të qenë pjesë e kësaj qeverisje, por me një vendim unanim të LSI-së ne nuk pranuan të ishim pjesë e qeverisjes për të vetmen arsye se kërkonim të bënim jo vetëm një reflektim dhe një ndarje përfundimtare. Duke pasur parasysh luftën që është bërë para një viti e gjysmë, pra nëse LSI do të sulmonte çështjen e drogës apo çështjen e korrupsioneve dhe shumë gjëra të tjera, akuzat do të ngriheshin menjëherë jo vetëm nga media dhe ndërkombëtarët, që do thoshin që LSI është kundër reformës në drejtësi. Gjë që ky stabilitet solli një lloj destabiliteti që na erdhi sot. Nuk bëhet asgjë vetëm, gjërat duhet t'i bëjmë të gjithë bashkë. Si fillim duhet të ndërjegjësohen që nga klasa politike, për të mos kërkuar të mbulojnë gabimet. Është më mirë t'i tregojmë gabimet tona dhe t'i themi i kemi bërë që të mos i bëjmë më, sesa të kërkojmë të nxjerrim elementët tjerë për të mbuluar gabimet dhe për të bërë gabime akoma më të mëdha.



Kryemadhi, takime në DASH: SHBA, rol për moskapjen e drejtësisë nga PS

Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi pati dje në Uashington takime të rëndësishme në Departamentin e Shtetit. Në takimin me Zdrejtorin për Europën dhe Euro-Azinë, Don Stolorthy dhe zyrtarë për Çështjet Ndërkombëtare, Stjepahnje Larsen, trafikun i drogës ishte problemi kyç, i cili u diskutua gjerësisht, pasi është një çështje kritike për Shqipërinë. U diskutua gjithashtu edhe qëndrimi i refraktar i mazhorancës për çështjen "Tahiri", si dhe sasi e mëdha të drogës, të cilat po kapen në vazhdimësi, veçanërisht nga vendet fqinje si Italia dhe Greqia. Kryemadhi ngriti gjithashtu shqetësimin për vepimet që lidhen me Këshillin e Emërimeve në Drejtësi dhe zgjedhjen e kryeprokurorit të ri. Autoritetet amerikane shprehën gatishmërinë e plotë për të mbështetur zbatimin e reformës pa asnjë devijim dhe në përputhje me frymën e saj për të reformuar sistemin e drejtësisë. Gjithashtu, ata konfirmuan vëmendjen maksimale të SHBA-ve në monitorimin dhe luftimin e trafikëve të drogës, sidomos të drogave të rënda si dhe luftën frontale ndaj krimit të organizuar dhe elementët terroristë të lidhura me të.

LEVIZJA E DHJETORIT RRËFIMI

Rrëfimi i ish-dhjetoristit: 'Bordura e djemve', vendi ku askush nuk tradhtonte tjetrin

Çollaku: Librat e ndaluar që shkëmbejnim me Edi Ramën

"Si e kopjonim 'Frojdin' dhe kasetat e grupit 'AC/DC'"

Valentina Madani

Dhjetor '90. Ishin ditë të rrezikshme, por plot ëndrra... Studentët ishin në kërkim të ndryshimit. E nisën mesnatën e së shunës së 8 dhjetorit. Errësira mbulononte qytetën e tyre. U vunë në kërkim të dritës derisa e ndezën atë mes shumë rreziqeve. Nisën kështu përballjen me diktaturën komuniste... Kreshnik Çollaku është njëri nga dëshmitarët e shumtë të revoltës rinore të 8 dhjetorit 1990. Ai sjell ndërmend për "Gazeta Shqiptare" thirrjet e para të studentëve të së shtunës së 8 dhjetorit, dyndjen e policisë drejt qytetës, shklopinjët e gomave mbi trupat e të rinjve dhe vendosmërinë e tyre për të mos u kthyer më mbrapsht. Çollaku ishte student i Filologjikut, aty ku guxoi të ngrinte për herë të parë bashkë me dy shokët e tij dy gishtat lart...

Z.Çollaku, çfarë mbani mend nga 8 dhjetori i '90-ës? Si ishte situata në Qytetin Studenti?

Në fakt, 8 dhjetori nuk erdhi si një rrufe në qiell të hapur. Unë mendoj se një sërë ngjarjesh paraprake klimën që shpërtheu më 8 dhjetor. Sigurisht çdokush mund të ketë opinionin e tij mbi vlerën e këtyre ngjarjeve. Unë po dëshmoj ato që në bindjen time, ose të paktën për mua personalisht kanë qënë në ngjarjet që paraprakinë 8 dhjetorin. Sigurisht, vatra e pareshtur e tensionit së regjimit kishte një kundërshti mbase dhe të organizuar ishte ngjarja në Kavajë dhe sidomos në Shkodër, nga ku lajmet vinin se andej kishte përplasje fizike mes njerëzish dhe forcave të regjimit. Një modë barsolësh antiregjim dukej se vinin nga Shkodra dhe mbanin të motivuar edhe në Tiranë idenë se të ishte kundër regjimit ishte jo vetëm e drejtë për ata që e kishin provuar persekutimin direkt. Kishte edhe nga ata që nuk e kishin këtë fat, e bënte të ishte një ndarje e padeklaruar midis atyre që kishin një pavarësi të mendjes, një dimension kulture dhe intelektual dhe midis atyre që i kishin

shpërlarë të gjitha këto nën modelin zyrtar. Pra, të ishte antiregjim, ishte një lloj mode rrezikshme, por interesante dhe gjithmonë e përhërë trendi. Lëvizjet, por edhe barsolëshat e Shkodrës, diskutimet, librat e ndaluar, kasetat me muzikë të ndaluar (roket, hevi metal) që qarkullonin dorë më dorë mes djemve të bordurës së bulevardit në Tiranë ishin si të thuash preambulë e asaj çfarë shpërtheu më 8 dhjetor. Djemtë e bordurave të Tiranës dhe disa intelektualë guximtarë si Sali Berisha, Ismail Kadare, Ylli Popa dhe ndonjë tjetër, por jo shumë të tjerë, ishin si të thuash vatra e asaj që mund të quhej disidencia në Tiranë.

Çfarë ishin 'djemtë e bordurave'?

Ishte një emër që u krijua vetui. Në bulevardin "Dëshmorët e Kombit" përballë hotel "Dajti" kishte disa bordura, janë edhe sot më duket. Kjo ishte zona dhe vendi ku mbledheshin një kategori të rinjsh nga 20-vjeçarët, siç isha unë e brezi im deri te 30-35 vjeçarët. Bordurat ishin vendi ku

frequentuesit e tyre në mënyrë të çuditshme kishim krijuar një kod lirie me njëritjetrit. Psh., qarkullonin kasetat me muzikë rok ose metal, muzikë e ndaluar në atë kohë. Te bordurat ti kishe besimin se mund të kërkoje një kopje të kasetës "AC/DC" dikujt që edhe nuk e njihje. Mund ta kopjoje diku dhe e ktheje të nesërmen. Kjo vetëm të bordurat mund të ndodhte. Kudo tjetër kjo ishte fatale. Por dhe te bordurat ishte po ashtu e rrezikshme, pasi ishte një besim i verbër te të panjohur, por

BORDURA

"Te bordurat ti kishe besimin se mund t'i kërkoje një kopje të kasetës 'AC/DC' dikujt që edhe nuk e njihje. Mund ta kopjoje diku dhe e ktheje të nesërmen. Kjo vetëm te bordurat mund të ndodhte. Kudo tjetër ishte fatale. Të paktën aty askush nuk tradhtonte tjetrin", tregon z.Çollaku.

me një besim okult te vetja se të paktën aty askush nuk tradhtonte tjetrin. Kishte një solidaritet i pashprehur antiregjim te bordurat. E njëjta gjë ndodhte me librat. Kishte libra të ndaluar. Të të kapnin me ndonjë prej tyre ishte vepër penale e kohës dhe rrezikoje dënim. Këto libra qarkullonin mes djemve të bordurave. Po të kujtoj sot rrezikun e kësaj aventure dhe çfarë rrezikohej do të ishte papërgjegjshmëri, por në atë kohë forca që të shtynte drejt kësaj lirie të rrezikshme ishte e papërmbyshme.

Ju kujtohet ndonjë rast konkret?

Me kujtohet një aventurë e këtij tipi. Një miku im pedagog në atë kohë në Akademinë e Arteve, Shpend Bengu më thotë se po qarkullonte fshëhëzazi një libër fantastik "5 leksionet e Frojdit për psikanalizën" në italisht. Këto lloj librash qarkullonin me radhë. Në radhë mund të ishin 10-15 veta. Radha ishte sekret. Secili dinte vetëm kë kishin para në radhë e kujt i duhej dorëzuar libri pas tij. Libri ishte super i



Lëvizja studentore, dhjetor 1990

ndaluar. Iu luta Shpendit të zija radhën që pas tij ta merrja unë. Librin mund ta mbaje dy ose tri ditë. Prisja me padurim që Shpendi të ma dorëzonte librin dhe unë kisha rregulluar një mënyrë klandestine për ta fotokopjuar Libri po vonohej. Pas një jave më takon Shpendi, librin e kishte mbështjellë me ca gazeta të vjetra në përpjekje për ta fshehur. Unë isha student e Shpendi pedagog, por ngaqë ishim miq, kisha lirinë "t'i kërkoja hesap" se pse e vonoi kaq shumë. "E vonova - tha Shpendi - se ma vonoi ai që e kishte para meje, një koleg pedagog i Arteve, Edi Rama. E mora librin dhe sikur kisha ndonjë bombë me vetë, me një frymë ia çova babait të ma fotokopjonte fshëhurazi në Institutin e Historisë ku punonte. Vetëm pasi mora fotokopjen bashkë me qortimet e babait tim se isha i papërgjegjshëm dhe aventurier që nuk llogarisja rrezikun që kjo sillte nëse zbulohej. Përveç kësaj klime mes rinisë, dy ngjarje që në bindjen time shkurtuar fitilin e shpërthimit të 8 dhjetorit, ishte arratisja e Ismail Kadaresë dhe shkrimet e Sali Berishës dhe Ylli Popës. Ika e Kadaresë grisi përfundimisht maskën publike të regjimit, ndërsa shkrimet e Berishës dhe Popës përbënin në një lloj mënyrë një platformë të strukturuar dhe të pjekur të disidencës antiregjim. Mbas atyre shkrimeve, pakënaqësia antiregjim kishte një shenjë se mund të zhvillohej në mënyrë të strukturuar statura intelektuale e këtyre personalitetëve ishte një lloj garancie se kundërshtimi ndaj regjimit nuk ishte një çështje disa të rinjsh të revoltuar, por një vullnet i formësuar i shoqërisë shqiptare të asaj kohe.

Si u përfshitë në lëvizjen studentore të dhjetorit?

Unë banoja pranë Qytetit Studenti, në disa pallate që quheshin pallatet e pedagogëve, disa ndërtesa trekatëshe që ishin ndërtuar me punë vullnetare nga vetë pedagogët e universitetit, siç ishte në atë kohë dhe babai im. Në shtëpi tek ne kishte

ardhur daja i vogël, Goni. Ishim të përmalluar, pasi Goni si krejt familja e nënës sapo ishin liruar nga internimi dhe kishim vite pa u parë. Në shtëpi ishim unë, Goni dhe motra ime e vogël. Nuk më kujtohet për çfarë arsye prindërit e mi nuk ishin. Dëgjua disa zëra si të thirrura në grup nga godinat e studentëve. Në fillim mendova se ishte ndonjë ndeshje futbolli dhe se të thirrur ishin për ndonjë gol, por me pas u dëgjua një shpërthim i fortë. "Dicka po ndodh - më tha Goni - duke u përpjekur të shoh nga dritarja". Nderkaq, u dëgjua sirena zjarrfikëse dhe nga dritarja vumë re disa makina policie që po futeshin në Qytet Studenti. Më pas thirrjet ishin dhe më të forta. Quditërisht e vetmja fjalë që dëgjohej qartë ishte "poshtë...". "Plasi më duket" - më tha daja. Po shiheshim në sy të pavendosur se çfarë do bënim dhe se dënim se çfarë po ndodhte. Ndërkohë nga dritarja u dukën siluetat e një grupi studentësh që po zbrisnin duke bërë trupat poshtë Krugës "Budi", gati poshtë dritares sime. Dalim - i thashë dajës. - Dalim - më tha - por këta po përplasen me policinë, ndaj vish ndonjë gjë të trashë që po na gjuajtën me shklopinj gome, ta kesh si mbrojtëse për trupin. Veshja sa bluza që kisha dhe dolëm. Vazhduam drejt vendit ku kishte kaluar grupi i studentëve. Ndërkohë, mesa duket kishte filluar përplasja e parë me policinë se shihnim disa që po ktheheshin me vrap e disa vajza që bërtisnin. Duke mos kuptuar ç'po ndodhte, u gjendëm përballë me një grup policësh që po vinin përballë gati me vrap. Nuk e di si shpëtua pa ndonjë shkop gome në kurriz. Ajo që më bëri përshtypje ishin të sharët e ndyra të policëve dhe helmimet e zeza mbi kokë.

Si filloi "rebelimi" në fakultetin e Filologjikut ku ju studionit?

Të nesërmen e 8 dhjetorit që në mëngjes vajta të sheshi i Qytetit Studenti, sigurisht prindërit u thashë se po shkoja në leksion. Në Qytet Studenti kishte



Kreshnik Çollaku gjatë protestave të studentëve, dhjetor 1990



← grupe studentësh. Të gjithë flisnin për ngjarjen e një natë më parë. U mblodhëm të sheshi para mesës. Secili përpiqej të fliste. Asnjëri nuk e mbaronte deri në fund atë që donte të thoshte se dikush tjetër ndërhynte e jepte mendim. Kujtoj se një djalë me një xhup të zi lëkure u ngjiti mbi ca shkallë e sikur u imponoi një lloj heshtje të tjerëve, edhe pse zërin e kish të kreyt të ngjirur. Shkoni nëpër fakultetet tuaja dhe thirrini të vinë këtu studentët. Asnjë të mos shkojë në mësim. Mos u trembni - tha - nuk ju gjen asgjë asnjërin nga ju pa më gjet emri, ju betohem në kokën e dy femijëve të mi. Më ngelën në mendje fjalët, por edhe toni i sigurt që i shqiptoi. Na dha siguri e një kurajë të brishtë, por që edhe për të kishim nevojë në ato çaste. Ish të Azem Hajdari. Sot sa herë i shoh dy femijët e rritur të Azemit, Kirin dhe Rudinën më kujtohen ato fjalë e mendoj se unë u fut në politikë prej betimit të Azemit mbi kokën e tyre.

Kush ishin pedagogët e parë që ju mbështetën?

E përmena më sipër, kish të një klimë që e parapriu datën 8 dhjetor. Po ju tregoj dhe këtu një histori personale. Në atë kohë isha në vitin e tretë në fakultet. Kishim një orë leksioni filozofie, që aso kohe e quanin marksizëm. Ish të rutinë që pedagogët para se të fillonte ora e mësimit bënin apelin dhe ne duhej të ngriheshim në këmbë, kur na thërritej në të paraqitnim prezencën. Me dy shokë të tjerë ramë dakord që kur të na thërriste emrin pedagogia, të ngriheshim në këmbë e të ngrinin lart dy gishta kur të bënim prezencën. Ashtu ndodhi. Dy shokëve të mi u fillonte emri për njëri me A (Armand Mero, gazetar i njohur sot) dhe tjetri me M (Miran Kraja sot një biznesmen i suksesshëm). Në fillim u ngrit Mandi pas apelit u përgjigj "këtu" e ngriti dorën me dy gishta. Mesa duket pedagogia mendoi se që rastësi e nuk e dha veten. Shokët e tjerë të grupit e vunë re dhe filloi një pëshpëritje e

lehtë. Më pas i erdhi radha Miri. Edhe ai bëri të njëjtën gjë, në këmbë me dy gishta lart dhe tha "këtu". Pëshpërimat e shokëve u shtuan dhe pedagogia kuptoi se po ndodhte diçka, u skuq pak dhe vrenjti sytë. Në fund erdhi radha ime, u ngrita dhe përsërita të njëjtin veprim me dy gishta lart. U duk qartë se po e bënim me qëllim. E kuptuan shokët e kursit, e kuptoi edhe pedagogia, e cila u vu në pozitë të vështirë. E acaruar tha vetëm kaq: "Armand, Miran e Kreshnik në fund të orës mos u largoni".

U'ndëshkuat nga pedagogia për veprimin që bëtet?

Mësimi ishte thujtë e shturur. Sapo ra zilja e mbarimit, ne të tre ndenjmë në klasë sipas kërkesës së pedagoges. Çfarë nuk mendonim. E sigurt ishte ndonjë dënim ose ndonjë masë. Pedagogia doli dhe pas pak u fut në klasë duke mbyllur derën. Na u afrua dhe na tha "çfarë ishte ajo që bëtet? Mua gjetët të ma bëni këtë? Po të jeni burra, shkoni e bëni diku tjetër, jo mua këtu. I kni tani e kini mendjen". Kur dolëm nuk po e besonim ç'ndodhi. Toni i pedagoges edhe pse qortues, ishte qartësisht një nxitje dhe solidaritet për më të. Në datën 9 dhjetor pas takimit në shesh, vajta të shoh se çfarë bëhej në fakultet, pashë se ishte ngjitur një tabelë letre e madhe me kërkesat e studenteve dhe kishte grupe studentësh që nxinin shokët të mos futeshin në mësim, por të mblidheshin në Qytet Studenti, nëpër shkallë rastësisht përball me pedagogen e filozofisë. Sa e pashë i thashë: "E mbajtëm fjalën profesore, i ngritëm gishtat dhe aty ku duhet". Ajo e buzëqeshur me tha hajde të të përqafoj, (nuk ishte gjë e zakonit të të përqafoje pedagogia). Më përqafoi dhe duke m'u afrua e me zë të ulët më tha: "Shumë mirë e betë, tani mos u tërhiqni". Ashtu bashkë vajtëm në një sallë ku kishin hyrë brenda tre-katër studentë. Ajo hyri në klasë e më ton përçmues u tha: "Skeni turp, pse me katër studentë do të bëj mësim unë? Dilni jashtë edhe ju" dhe iku nga klasa. Unë u kënaqa. Më shtrengoi dhe një herë fort dorën pasi u ndamë. Nuk e kam parë më prej asaj kohe, por e ruaj me shumë respekt në kujtesë dhe nuk e harroj kurrë mbështetjen që na dha në mënyrën e vet në ato ditë të vështira e plot rrezik. Si pedagogia e Filozofisë pati edhe shumë të tjerë, që në një formë a në një tjetër heshtur ose me fjalë nxitën e mbështetën atë çfarë po bënim ne. Sigurisht kishte dhe pedagogë të tjerë që ulërinin e kërcënonin korridoreve, por tashmë ai ishte shndërruar në një lum që nuk ndalej dot më nga asnjë kërcënim.

Si e mbani mend Sali Berishën në atë periudhë?

Sali Berisha ishte një ndër intelektualët e njohur të kohës. Shquhej si kirurg ndër më të mirët. Madje, thuhej se ishte i pari që kishte arritur

"Çfarë bisedohej mes intelektualëve në kafen ku shkante edhe Berisha"

Çollaku: Ngritëm dy gishtat në mësim, si i shpëtuan dënimit

"'Zonja dhe zotërinj', pedagogu që e tha i pari"

të realizonte një ndër operacionet e zëmërës më të ndërlikuarat e në mënyrë moderne sa edhe nëpër Evropë ishin të pakët ata që e bënin. Unë kisha lexuar shkrimet e tij të botuara në ato kohë. Siç e thashë më parë, ishte një ndër garantitë se revolta nuk ishte vetëm çështje e disa të rinjve të pakënaqur, por një vullnet i pjekur i intelektualëve mendjehapur të kohës. Babi im në atë kohë kalonte shumë kohë në Bibliotekën Kombëtare, ku përgjithësisht mblidheshin intelektualët e studiuës të shkencës. E njihje doktor Berishën në kafet e përbashkëta dhe natyrisht bisedonim mbi e për ngjarjet. Baba ma përshkruante si një njeri me karakter të fortë, me ide e mendime moderne dhe i emancipuar, me shumë kulturë dhe mbi të gjitha kurajoz. Më tregonte se kjo kurajë për të thënë të vërtetat ishte bërë një lloj nxitje dhe mbështetje dhe për intelektualët të tjerë, të cilët mendonin ngjashëm, por druanin të flisnin. Kafet e Pallatit të Kulturës ishin këthyer me doktor Berishën në një lloj qendre ku intelektualët e studiuës të kohës po fillonin të artikulonin hapur ide e qëndrime kritike ndaj regjimit". U shpreh ish-dhjetoristi.

Çfarë kujtoni nga takimi i parë i z.Berisha me studentët...?

Ishte hera e parë që unë bëja lidhjen midis figurës së Sali Berishës dhe atyre që kisha dëgjuar për të. Në atë kohë në Qytet Studenti vinin shumë intelektualë, pedagogë, studentë, njerëz të thjeshtë që flisnin përmes brohorimave të studentëve në shesh. Të gjithë artikulonin fraza kundër regjimit, dikush më ashpër e dikush më kujdes. Pak prej tyre arrinin të impononin qetësi në shesh, aq sa gysma e fjalëve që thoshin nuk dëgjohej fare. Në një moment fjalën e merr Sali Berisha dhe vura re se vetiu në shesh pasoi një lloj qetësie, që ishte vëmendje për ta dëgjuar. Dy elemente më bënë përshtypje të fortë në fjalën e tij. Berisha ishte i pari nga gjithë folësit në shesh, që iu drejtua protestuesve duke iu drejtuar "Zonja dhe zotërinj". Ishte e pazakontë në atë kohë ky term. Ishte thujtë tabu. Ndaj kur Sali Berisha iu drejtua njerëzve



Kreshnik Çollaku, kreu i Departamentit për Politikën e Jashtme në PD

BISEDAT

"Kafet e Pallatit të Kulturës ishin këthyer me doktor Berishën në një lloj qendre ku intelektualët e studiuës të kohës po fillonin të artikulonin hapur ide e qëndrime kritike ndaj regjimit". U shpreh ish-dhjetoristi.

me "Zonja e zotërinj" pati një reagim të menjëhershëm nga të gjithë. Nuk e di si u ndjenë të tjerët, por mua personalisht mu duk sikur ajo mënyrë u dha një lloj dinjiteti protestuesve dhe ishte shenjë e thellë se kontrasti mes protestës dhe regjimit fillonte e do të shkante në një përmbysje radikale vlerash e rikthim në Shqipërinë e fisnikërisë dhe respektit për dinjitetin njerëzor. Elementi i dytë që më bëri përshtypje në fjalën e Berishës ishte se ai iu referua "Kosovës Martirë" dhe çështjes kombëtare. Tema e Kosovës dhe Bashkimit Kombëtar ishte gjithashtu një tabu e kohës. Për Kosovën nuk mund të fitej më shumë seç lejonte korniza zyrtare e kohës. Të dilje jashtë asaj kornizë mund të përbente probleme më tej. Berisha insistoi fort në fjalën e tij të Kosova. E ndjeva mirë, pasi unë isha i biri i një historiani që më kishte folur gjatë e me dhimbje për Kosovën e fatet e saj edhe jashtë kornizës zyrtare, por sidogoftë në atë moment, me pjekurinë e një 20-vjeçari e pata të vështirë të bëj lidhjen pse Berisha në atë moment duhej të përmendte Kosovën. Përgjigjen në fakt e kam realizuar në vitet më pas, ku Kosova dhe çështja kombëtare kanë qenë herë në mënyrë të bindur, herë të pa-bindur motivuesit kryesor të vullnetit politik të Sali Berishës. Besoj se z.Berisha dhe intelektualët të tjerë që iu bashkuan protestës, por sido-

mos Berisha, ka përbërë faktorin përcaktues që ajo lëvizje nga një protestë revoltë e disa të rinjve të pakënaqur e kundërshtarë të regjimit të kthehej në një vullnet e projekt politik si PD-ja, që do të realizonte përmbysjen e madhe dhe hapjen e një kapitulli të tij politik e historik për Shqipërinë. Besoj ky është kontributi thelbësor që intelektualët e kohës e mes tyre në mënyrë të spikatur Sali Berisha orientuan lëvizjen, formatuan aksionin e shndërrimit nga një lëvizje rebelësh, në një fenomen politik në Shqipërinë e viteve '90.

Si rrodhën ngjarjet pas 8 dhjetorit dhe a kishte dilema mes studentëve, nëse duhej vazhduar më tej apo jo?

Krijimi në gjirin e lëvizjes studentore të PD-së zgjidhi çdo dilemë nëse lëvizja e protesta duhej apo jo të vazhdohej. Krijimi i PD-së i dha një fuqi lëvizjes dhe garantoi më tej që forca e saj e projektuar në një parti politike të realizonte përmbysjen e madhe dhe triumfin vetë lëvizjes studentore në 22 mars '92.

Ish-dhjetoristët 27 vite më parë ishin të gjithë të bashkuar me një mision të përbashkët, rrëzimin e diktaturës, por prej vitesh festojnë të ndarë 8 dhjetorit. Pse ndodh një gjë e tillë? Çfarë i përçau ndër vite ish-dhjetoristët?

Lëvizja studentore ishte e natyrshe, spontane. Çfarë na bëri bashkë në atë shesh ishte pakënaqësi, revolta, refuzimi ndaj regjimit dhe nevoja për ndryshim. Pasi ndryshimi erdhi në mënyrë po aq të natyrshe çdokush do të ndiqte e realizonte ambicjet e qëllimet e tij në jetë. Në atë kohë, ne ishim bashkë, por nuk ishim njësoj. Kishim prejardhje e historitë të ndryshme, ambicie të ndryshme, formime të ndryshme. Dikush zgjidhi të nd-

jekë jetën e vet pa u përzier me politikën. Dikush zgjidhi të ndjekë angazhimin politik. Pluralizmi lejonte mundësinë që çdokush të zhvillonte bindjet dhe ambicjet e tij. Dikush me sukses e dikush, pa sukses. Por kjo është jeta dhe është kreyt logjike të ndodhte kështu. Sot rastis që pjesëtarë të asaj lëvizjeje të ndodhemi në kampe të ndryshme politike e shpeshherë edhe rivale. Por as kjo nuk është një dramë, pasi secili kudo zgjedh të jetë apo të zhvillojë politike sado në rivalitet me njëri-tjetrin mban dhe ndan me këdo pjesëtarë të asaj lëvizjeje nderin kontributin për produktin e asaj lëvizjeje, produktin e një Shqipërie më të mirë e më të zhvilluar. Po sot dhjetoristët mund të jenë të shpërndarë në formacione të ndryshme politike, shumë prej tyre mbase nuk merrin me me politikë, por një gjë e them me bindje, në asnjë bashkësi njerëzish si në atë bashkësi, njerëzish (dhjetoristët) nuk ekziston kultura se "mund të mos biem dakord, por është e pamundur të mos merremi vesh". Unë besoj kjo frymë mirëkuptimi dhe kulture të pranimit dhe të atij që ke kundër më bindje apo qëndrime është një ndër kontributet që ajo lëvizje ia ka lënë trashëgimi shoqërisë shqiptare, qoftë asaj politike qoftë asaj apolitike.

Pse nuk protestoi këtë herë PD-ja me 8 dhjetor?

PD ka një axhendë të plotë përkuajtimit të ngjarjeve të dhjetorit. Në datë 8 dhjetor ka një aktivitet shumë interesant të FRPD në Qytetin Studenti dhe në datë 11 PD-ja ka një tjetër aktivitet përkuajtimit në Tiranë. Përsa u përket protestave, kam bindjen personale se protestat nuk janë qëllim në vetvete. Protestat nuk mund të shërbejnë as si sfidë për axhendën e ditës politike apo partiake. Nuk jam shumë simpatizant i protestave sensibilizuese apo figurative. Besoj se kur të zbrësë opozita e vendit në protestë, nuk ka kthim më mbra-pa dhe se nëse opozita zbrzet në protestë, qeveria nuk mund të kthehet më nëpër zyrë, pasi po në atë cast duhet të rrezohet. Në atë kohë, me ishim bashkë, por nuk ishim njësoj. Kishim prejardhje e historitë të ndryshme, ambicie të ndryshme, formime të ndryshme. Dikush zgjidhi të nd-

Krerët e shtetit thyjnë protokollin, ikin të gjithë jashtë vendit

Ruçi në SHBA: Do të kemi sistem të besueshëm drejtësie

Protokollin e shtetit është thyer nga krerët e vendit, të cilët njëherësh janë jashtë shtetit, duke e lënë vendin nën drejtimin e zëvendëskryeminstres Mesi. Kryeministri Edi Rama është në vizitë zyrtare në Bullgari, Presidenti Republikës, z.Meta në Francë; ndërsa kryetari Kuvendit, Ruçi është në SHBA. Po ashtu, ministri Jashëm, z. Bushati dhe ai i Brendshëm, z.Xhafaj janë në Bruksel. Kreu i Parlamentit, Gramoz Ruçi ndodhet në një vizitë zyrtare në SHBA me ftesë të kongresmenit Robert Pittinger. Ruçi është pritur në takim nga zëvendëskryetari i nënkomsionit për Terrorizmin dhe Financimin e Paligjshëm, zoti Robert Pit-

SHKELJA

Protokollin e shtetit është thyer nga krerët e vendit, të cilët njëherësh janë jashtë shtetit duke e lënë vendin nën drejtimin e zëvendëskryeminstres Mesi. Kryeministri Edi Rama është në vizitë zyrtare në Bullgari, Presidenti Meta në Francë, ndërsa kryetari Kuvendit, Ruçi në SHBA.

tenger. Pittinger përgëzoi Ruçin për detyrën e Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë dhe shprehu gatishmërinë për intensifikimin e mëtejshëm të marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve. "Të

dyja vendet tona ndajnë të njëjtat angazhime, të njëjtat vlera dhe pikëpamje, si dhe të njëjtat shqetësime. Shtetet e Bashkuara të Amerikës duan që Shqipëria të jetë një vend i fortë, i sigurt, që gëzon paqe

e begati. SHBA-të kanë një lidhje të fuqishme me Shqipërinë dhe ne ju jemi mirënjohës dhe ju falënderojmë për miqësinë që kemi, e cila do të forcohet në vite", tha Pittenger. Nga ana e tij, Ruçi shprehu mirënjohje për mbështetjen e SHBA-ve, duke thënë se falë tyre, Shqipëria është sot një vend anëtar aktiv i NATO dhe partner i rëndësishëm në luftën kundër terrorizmit. "Vizioni për një Shqipëri të fortë dhe të besueshme mbështetet mbi partneritetin strategjik



Kreu i Kuvendit dje gjatë vizitës në SHBA

me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ne u jemi gjithmonë mirënjohës SHBA-ve. Shqiptarët nuk e harrojmë kurrë mbështetjen e SHBA-ve për një Kosovë të lirë dhe të pavarur. Shqipëria është sot një vend anëtar aktiv i NATO-s dhe partner i rëndësishëm në luftën kundër terrorizmit falë mbështetjes së

SHBA-ve. Reforma në drejtësi u përgatit dhe u miratua me mbështetjen e SHBA-ve. Ne do të kemi një sistem të besueshëm drejtësie. Miratimi i reformës është garanci e domosdoshme për sipërmarrjet e huaja, duke përfshirë edhe ato amerikane, për të investuar në Shqipëri", deklaroi Ruçi.

Presidenti dekoron Sylviane Muselier, vajza që i dhuroi lulet mbretëreshës Geraldinë

Meta-Muselier: Do të mbështesim projekte me interes për Mesdheun

"Nxitje, marrëdhëniet dypalëshe"

Valentina Madani

Presidenti i Republikës, Ilir Meta gjatë vizitës së tij në Marsejë u prit në takim nga presidenti i Këshillit Rajonal të Provence-Alpes-Cotes d'Azur (PACA) e eurodeputeti Renaud Muselier dhe zhvilloi gjithashtu një takim pune mbi partneritetin e Shqipërisë me këtë rajon. Presidenti Meta vlerësoi marrëdhëniet e shkëlqyera mes Shqipërisë dhe Francës dhe vuri në dukje nevojën për të nxitur dhe inkurajuar edhe më tej bashkëpunimin dypalësh dhe shumëpalësh mes dy vendeve. Presidenti Meta theksoi rëndësinë e rritjes të bashkëpunimit mes Shqipërisë dhe rajonit të PACA-s, veçanërisht në fushën e mjedisit, atë të turizmit të infrastrukturës detare dhe në kuadër të projekteve të përbashkëta zhvillimore. "Rajoni i Mesdheut ka potenciale të jashtëzakonshme, të cilat mund të shfrytëzohen nga vendet e këtij rajoni për të forcuar lidhjet dhe bashkëpunimin në të ardhmen", shpjegoi z.Meta. Presidenti i rajonit PACA e cilësoi vizitën e Presidentit Meta si një tregues mjaft domethënës dhe ilustrues të nxitjes së këtyre marrëdhënieve dypalëshe.

"Gjatë takimit të punës mbi partneritetin me drejtues të rajonit PACA, me



Presidenti i Republikës, Ilir Meta me Sylviane Muselier

praninë edhe të drejtores së Portit të Marsejës, Christine Cabau-Woerhel, Presidenti i Republikës pasi u njoh me funksionimin e portit dhe veprimtarinë e shumëlojshme të tij duke e quajtur "universitet më vete, edhe gjeopolitik, edhe gjeoekonomik" vuri në dukje se marrëdhëniet e shkëlqyera politike dhe diplomatike dëshirojmë t'i forcojmë, t'i zgjerojmë e t'i lulëzojmë edhe më tej.

"Ne duam ta bëjmë edhe më të spikatur dimensionin tonë mesdhetar", tha Presidenti Meta. Duke nënvizuar rëndësinë e bashkëpunimit me rajonin PACA dhe Marsejën si një qendër e fuqishme jo vetëm për Francën, por për mbarë Mes-

dheun, Presidenti Meta përmendi disa fusha të mundshme bashkëpunimi si infrastruktura bregdetare, shfrytëzimi dhe menaxhimi i kësaj pasurie të vijës bregdetare shqiptare, mjedisi dhe mbrojtja e tij, turizmi, arsimimi dhe përgatitja profesionale, shkëmbimi i përvojave. "Një nga aspektet kryesore të bashkëpunimit mes Shqipërisë dhe rajonit PACA do të ishte rritja e kapaciteteve të njerëzve tanë në përgatitjen e projekteve për të thithur fonde të Bashkimit Evropian dhe kontributi e ndihmesa juaj e vyer, si dhe ndarja e përvojës pozitive do të ishte tepër e vlerësuar në këtë drejtim", u shpreh Presidenti Meta. Ai i siguroi pjesëmarrësit se "do

të gëzojnë mbështetjen e plotë për çdo nisim të mundshme që do të ndërmarrin për çështje dhe projekte me interes për Mesdheun". Meta, i shoqëruar nga presidenti i Këshillit Rajonal Muselier, presidentja e Portit, Cabau-Woerhel, ambasadorja e Francës në vendin tonë Christina Vasak, si dhe ambasadori i Republikës së Shqipërisë, Dritan Tola vizitoi Portin e Marsejës.

DEKORIMI

Po dje kreu i shtetit njoftoi në "Facebook": "Ishte jo vetëm një detyrim institucional, por edhe një nder i veçantë t'i dorëzoja sot (dije) në Marsejë, Sylviane Muselier, një zonje të jashtëzakonshme dekoratën e lartë "Nënë Tereza", për kontribu-



Kukan: Krenar për progresin e Shqipërisë

Hann takon Xhafajn: Periudha në vijim, vendimtare për Shqipërinë

Gjatë vizitës në Bruksel, ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj zhvilloi një takim me komisionerin për Fqinjësinë dhe Negociatat e Zgjerimit, Johannes Hahn. Xhafaj u ndal te lufta antikanabis, duke e vënë theksin tek qëndrueshmëria e rezultateve. "Ministri nënvizoi se janë marrë që tani masat për 2018-en dhe Shqipëria nuk do të jetë më në listën e vendeve ku kultivohet drogë. Një vend të rëndësishëm në bisedën mes palëve zuri njohja me planin e veprimit, operacioni "Forca e Ligjit", duke u ndaluar në elementet e tij, çfarë përfaqëson dhe si do të zbatohet. Ministri pohoi se janë skanuar grupet kriminale dhe asetet e tyre. Ai veçoi ndihmën e ekspertëve të huaj të atashuar në Task Forcën Speciale. Zoti Xhafaj informoi komisionerin për procesin e vettingut, që do të kryhet në Policinë e Shtetit. "Duke u ndaluar tek masat për frenimin e azilkerkimit të paligjshëm dhe migracionin e parregullt, ministri i Brendshëm shqiptar veçoi bashkëpunimin me Francën, si një shembull pozitiv për minimizimin e fenomenit. Komisioneri për Fqinjësinë dhe Negociatat e Zgjerimit tha se shembulli i bashkëpunimit të palës shqiptare me Francën duhet avancuar edhe me vendet e tjera europiane. "Periudha në vijim është shumë vendimtare për Shqipërinë", u shpreh komisioneri Hahn. Ai sugjeroi njohjen më të thellë të arritjeve të palës shqiptare përmes medias së huaj, për të reduktuar efektet negative të stigmatizimit të padrejtë të vendit. Po dje, eurodeputeti Eduard Kukan ka zhvilluar një takim me ministrin e Brendshëm, Fatmir Xhafaj në Bruksel. Në "Twitter", Kukan deklaroi se me Xhafaj ka diskutuar në lidhje me masat që Shqipëria ka marrë në luftën kundër krimit të organizuar dhe çrregjësosjen e kultivimit të kanabisit. Ai u shpreh krenar për progresin që ka arritur Shqipëria në zbatimin e reformave të rëndësishme.

tin e pamatë që ka dhënë me ndihma humanitare e pa-jisje mjekësore për fëmijët, njerëzit në nevojë e spitalet e Shqipërisë. Kjo zonjë me zemër të madhe është, edhe e rezistencës, edhe e paqes, edhe republikane, edhe mbretërore, në shpirt dhe në vepra. Ajo e ka kthyer shpëtimin e saj në Marsejë në

një shtëpi të shqiptarëve. Dashuria e saj për Shqipërinë buron nga dashuria e saj e pafund për Mbretëreshën Geraldinë, motrën e saj më të madhe. Nderimi i figurës së Geraldinës vazhdon ende të frymëzojë shumë njerëz në Evropë e botë për të ndihmuar Shqipërinë e shqiptarët".

Luftë informalitetit, bankat kredi vetëm në bazë të bilanceve zyrtare

Ornela Manjani

Lufta kundër informalitetit dhe ulja e nivelit të kredive të këqija janë dy pikat kryesore të strategjisë së dakordësuar nga Banka e Shqipërisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë, e cila do të startojë në 1 janar të vitit 2018. Strategjia e re u prezantua dje nga ministri i Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj dhe guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Gent Sejko. Në fokus të kontrolleve do të jenë bizneset e mëdha. Kompanitë e biznesit do të detyrohen të mbajnë një bilanc të vetëm, i cili do të jetë i përputhur me deklarin e tyre në Tatime, duke frenuar abuzimin me bilancet fiktive, që nga njëra anë nxisin shmangien e detyrimeve tatimore reale dhe nga ana tjetër ndikojnë në vlerësimin e aftësisë paguese të bizneseve për llogari të kreditimit në bankat e nivelit të dytë. "Sot është fakt që kompanitë e mëdha mbajnë dy bilance, një që deklarohet në Tatime dhe një që dorëzohet në bankat tregtare për qëllime kredimarrjeje. Ne kemi marrë angazhim që kompanitë të biznesit t'u njihet vetëm një bilanc zyrtar, që është i përputhur me deklaratën e tyre tatimore. Kryeministri e ka artikuluar si masë në ditët e fundit dhe ne po e avancojmë, besoj do të konkretizohet me të gjitha detajet teknike nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Banka e Shqipërisë, në një rregullorë të posaçme në fillim të vitit 2018", deklaroi ministri Ahmetaj. Ministri theksoi dy aspekte në kuadër të kësaj nisme. "Së pari, reduktimi i nivelit të kredive me probleme në ekonomi. Problematika e kredive me probleme u trajtua gjerësisht

Sejko e Ahmetaj: Kushtet e reja për të marrë kredi

Bizneset e mëdha në "sitë", BSH dhe Financat plan të përbashkët

gjatë mandatit tonë të parë 2014-2017. Grupi i përbashkët i punës mes Bankës së Shqipërisë dhe qeverisë hartoi një strategji dhe plan konkret veprimi me qëllim reduktimin e NPL, ku një ndër masat e parashikuara ishte pikërisht dhënia e kredive vetëm në bazë të deklaratave tatimore. Sigurisht që ky plan masash është konsultuar në masë të gjerë edhe me bankat e nivelit të dytë dhe unë besoj që ky është momenti që të vendoset një normë e re në marrëdhënien mes bankave dhe kompanive të biznesit. Dhe ky është elementi i dytë që dua të theksoj. Në këtë fazë aktuale të aksionit tonë kundër informalitetit, ne kemi një fokus të posaçëm tek biznesi i



Ministri i Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj dhe guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Gent Sejko

madh, duke bërë një skanim të thellë dhe më kompleks të fenomeneve të riskut, që janë shfaqur si rezultat i të gjitha analizave tona të deritanishme. Bilancet fiktive janë

absolutisht një nga fenomenet kryesore, që jo vetëm shmangin pagesën e detyrimeve tatimore, por reflektojnë edhe pasoja të tjera si deklarimi i pagave tejet të ulëta në raport me referencën e tregut të punës, duke sjellë deformime të

shumëfishta në treg". Guvernatori Sejko tha se Banka e Shqipërisë ka vlerësuar me seriozitet dhe ka mbështetur në vazhdimësi nismat e ndërmarrja për rritjen e formalizimit të ekonomisë. "Plani kombëtar për reduktimin e kredive me probleme përcaktoi

vendosjen e kriterit rregullativ, si një detyrë të rëndësishme për Bankën e Shqipërisë, që duke filluar nga viti 2018, veprimtaria e kredidhënies të mbështetet vetëm në deklaratat tatimore. Banka e Shqipërisë e ka trajtuar edhe më parë këtë dukuri nga pikëpamja rregullative, por duke u kufizuar vetëm të kredimarrësit e mëdhenj të bankave. Koordinimi i veprimeve me organet qeveritare dhe veprimet e përshtatshme të ndërmarrja kanë krijuar hapësirën e nevojshme për ta thelluar këtë masë rregullative në një bazë më të gjerë kredimarrësisht", - u shpreh Sejko.

KREDITË ME PROBLEME

Niveli i kredive me probleme është rreth 14.4% (gati 10% më ulët se viti 2013, ku arriti kulmin e 25% të totalit të kredive në ekonomi. Aktiviteti kredites ka një gjallërim, ende modest gjithsesi, por pa diskutim që aftësia paguese e kredimarrësve është një faktor kyç në sjelljen e bankave në raport me kreditimin. Me qëllim frenimit e fenomenit të kredive të këqija dhe nxitjen e kreditimit është hartuar nisma që është një hap i rëndësishëm, i cili në vetvete përfaqëson sektorin më transparent dhe të formalizuar të ekonomisë.

PËRFITIMET E MASAVE SIPAS BSH:

1. Për industrinë bankare, mbështetja e kredidhënies në deklaratat tatimore lehtëson ndjeshëm procesin e kredidhënies, duke i vendosur bankat në një emërues të përbashkët në leximin e të dhënave financiare. Kjo krijon lehtësi në veprimtarinë e kreditimit, duke u dhënë qartësi të lartë bankave në procesin e analizës financiare dhe përzgjedhjen e kredimarrësve, si dhe në shkëmbimin e informacioneve me njëra-tjetrën për kredimarrës të përbashkët.
2. Për bizneset dhe familjet shqiptare ky proces nxit rritjen e transparencës, çka do të përkthehet detyruesisht në uljen e rrezikut të kredisë dhe ajo që është më e rëndësishme, në uljen e kostos së financimit. Po ashtu, duke krijuar një fushë më të barabartë loje, ky proces rrit konkurrencën dhe eficiencën, çka në analizë të fundit, ndihmon zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të vendit.
3. Për ekonominë në tërësi, ky proces rrit qëndrueshmërinë ekonomike dhe financiare të vendit, si dhe krijon premisa për një sistem tatimor më të thjeshtë dhe për një shpërndarje më të drejtë të barrës së taksave.

ANKETA E BIZNESIT

Përfaqësues të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, anëtarë të Këshillit të Investimeve morën pjesë të mërkurën në mbledhjen ku u diskutuan gjetjet kryesore të anketës së biznesit "Mbi kontrollin tatimor, informalitetin dhe rimbursimin e TVSH-së". I pranishëm në këtë mbledhje ishte edhe ministri i Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj. Gjetjet e kësaj ankete u bazuan në përgjigjet e një numri biznesesh kryesisht të sektorëve industri, ndërtim, shërbime dhe tregti me shumicë e pakicë. Anketuesit vlerësojnë se ka një rritje cilësore të komunikimit me administratën tatimore në raport me gjetjet e vitit 2015. Kjo sidomos në transparencën, komunikimin me biznesin, aksesin në kohë dhe cilësinë e informacionit, ndërkohë që sfida për të ardhmen mbetet rritja e njohurive të kompanive mbi dinamikën e legjislacionit

Rimbursimi i TVSH-së, gjysma e të anketuarve kanë përfituar në kohë



fiskal. Respondentët kanë vlerësuar si shumë të rëndësishëm vijimin e procesit të digjitalizimit të shërbimeve ndaj tatimpaguesve. Sa i përket kontrollit tatimor, në raport me vitin 2015 në anketë evidentohet një rritje e konsiderueshme në vlerësimin për cilësinë e raportit të auditimit, si dhe sjelljen dhe etikën e inspektorëve. Po kështu, të dhënat e anketës tregojnë për një rritje të ndjeshme në ndërgjegjësimin e tatimpaguesve për Modulin e Analizës së Riskut dhe përzgjedhjen për inspek-

tim bazuar në të. Anketa evidenton ndryshime në natyrën e inspektimeve me më shumë vizita fiskale dhe inspekte më vend. Lidhur me rimbursimin e TVSH-së, 22% e të anketuarve kishin aplikuar për rimbursim të TVSH-së, nga ku 52% e tyre raportojnë se e kanë përfituar atë brenda afatit ligjor prej 60 ditësh. Në raport me vitin 2016, anketa tregon se ka një rritje në përfitimin automatik të rimbursimit të TVSH-së dhe një përmirësim të ndjeshëm në përbushjen e afateve të rimbursimit të TVSH-së me rimbursimin brenda 30 ditësh. Aktiviteti informal, ashtu si në 2015 edhe në 2017 konsiderohet nga kompanitë si kosto, veçanërisht në terma afatgjatë. Në tërësi anketa evidenton se ka një perceptim të rënien e informalitetit krahasuar me vitin 2015.



Applikim për të përfituar Statusin e Naftëtarit

Njoftohen të gjithë punonjësit dhe ish-punonjësit e shoqërisë Albpetrol sh.a se, bazuar në Ligjin Nr.8/2017 "Për Statusin e Punonjësve të Industrisë së Naftës dhe Gazit" dhe Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.425 datë 10.05.2017, se ka filluar shpërndarja e dokumenteve për Statusin e Naftëtarit. Personat e interesuar që të pajisen me dokumentet përkatëse duhet të paraqiten pranë njërit prej qendrave të punës ku kanë punuar dhe të fillojnë procedurën.

Shoqëria Albpetrol sh.a sqaron të gjithë personat e interesuar se disponon dokumentacion për periudhën që kanë punuar në shoqërinë Albpetrol sh.a nga viti 1994 e në vazhdim. Për periudhën përpara vitit 1994, dokumentet mund të merren pranë Sigurimeve Shoqërore ose arkivave të tjera.

Personat që duan të pajisen me vërtetim të posaçëm zyrtar për periudhën përkatëse duhet të plotësojnë formularin përkatës, i cili mund të shkarkohet në adresën www.albpetrol.al/statusi-i-naftetarit/ ose mund të tërhiqet fizikisht pranë qendrave ku kanë punuar.

Formulari i plotësuar duhet të dorëzohet në qendrat ku keni punuar së bashku me një kopje të librezës të punës ose mund të dërgohet me postë në qendrën përkatëse.

Prokuroria: Trafikuan 350 kg kanabis nga Vlora

2.5 tonë drogë drejt Italisë, grupi kriminal aktiv prej vitit 2014



Droga e sekuestruar

Zbardhen të tjera detaja në lidhje me grupin kriminal, i cili trafikoi 2.5 tonë kanabis nga porti i Durrësit drejt Italisë në janar të këtij viti. Sipas hetimeve të kryera nga Prokuroria e Krimeve të Rënda, nënkomisari i policisë, Festim Lelaj në bashkëpunim me persona të tjerë ka lejuar kalimin nga porti i Vlorës të një sasive prej 350 kilogramësh kanabis që prej vitit 2014. Mësohet se Lelaj bashkëpunonte me dy të arrestuarit Aurel Laze dhe

BASHKËPUNIMI

Sipas hetimeve të kryera nga Prokuroria e Krimeve të Rënda, nënkomisari i policisë, Festim Lelaj bashkëpunonte me dy të arrestuarit Aurel Laze dhe Skënder Siceqa, të cilët transportuan me kamion drogën drejt Italisë.

Skënder Siceqa, të cilët transportuan me kamion drogën drejt Italisë. Nën komisari i policisë në atë kohë punonte si punonjës i Policisë Kufitare në këtë port. Nga hetimet e akuzës ka rezultuar se droga sigurohej

në zona të ndryshme të Vlorës, e më pas ngarkohej nëpër kamionë në Fier, të cilët kishin si destinacion Europën. Deri më tani në kuadër të këtij grupi kriminal, kanë rënë në pranga 12 persona mes tyre efektiv pol-

icie të nivelit të lartë si dhe policë kufitarë në Durrës, doganier dhe agjent doganorë. Të arrestuarit e këtij grupi pritet të dalin para gjykatës së Krimeve të Rënda për t'u njothur me masën e sigurisë ditën e sotme. Ndërkohë, prokuroria ka depozituar kërkesë për caktimin e masës së sigurisë arrest me burg për policët, doganierët dhe trafikantët. Në bazë të hetimeve, të arrestuarit kanë bashkëpunuar me njëri-tjetrin duke lejuar transportimin e sasisë

prej 2.5 tonë drogë drejt Ankonas në janar të këtij viti. Gjithashtu, Policia e Shtetit në koordinim me zyrën ndërlidhëse të policisë italiane "Interforza" në Tiranë zbardhën dinamiken e plotë të ngjarjes ku u lejuar kalimi i drogës. Në vijim të

këtij operacioni ranë në prangat nënkomisari i policisë së Fierit, Festim Lelaj, dy efektiv të dretorisë së Kufirit dhe Migracionit në Durrës, Gëzim Dervishi dhe Agron Kapllani si dhe dy doganierë të Portit të Durrësit.

Dyshohet për korrupsion, 46-vjeçari kërkon lehtësimin e masës së sigurisë

Gjyqtari Miri në gjendje të rëndë, pritet ekspertiza mjekoligjore

Avokati: Qëndrimi në burg i rrezikon jetën



"Mos festoni Pavarësinë", policia merr në pyetje imamin Armand Ali

Gjyqtari i Apelit, Shkëlqim Miri, i dyshuar për akuzën e korrupsionit, kërkon për të dytën herë brenda dy javësh zëvendësimin e masës së sigurisë "arrest me burg" me masë më të lehtë, për arsye shëndetësore. Në seancën e së enjtes, avokati i tij mbrojtës, Ardian Visha tha para trupit gjykues se 46-vjeçari është transferuar në ambientet e spitalit të burgut, në gjendje të rëndë shëndetësore dhe qëndrimi i mëtejshëm atje i rrezikon jetën. Ai kërkoj ndryshimin e masës së sigurisë në një masë më të lehtë, me qëllim që klienti i tij të ketë mundësinë për t'u kurruar, pasi prej disa muajsh është diagnostikuar me tumor. Pas kërkesës së avokatit mbrojtës, gjykata vendosi të caktojë dy ekspertë mjekoligjorë, të cilët do të verifikojnë gjendjen e Shkëlqim Miri. Specialistët e fushës pas verifikimit do të shprehin nëse është në rrezik jeta e 46-vjeçarit në kushtet e paraburgimit. Gjyqtari i Apelit Tiranë, u ndalua në kuadër të operacionit policor "Një vrasje e dytë". Ai



Gjyqtari i Apelit, Shkëlqim Miri

akuzohet për veprën penale të korrupsionit të funksionarëve të drejtësisë. Shkëlqim Miri dyshohet se favorizoi të dënuarin Gentian Doda, duke i ndryshuar akuzën nga vrasje me paramendim në plagosje të rëndë me pasojë vdekjen, kundrejt një

shume të konsideruar parash. Prokuroria për Krime të Rënda thotë se ka prova të mjaftueshme që e implikojnë gjykatësin në skemën korruptive. Organi i akuzës thekson se gjatë kontrollit në banesën e 46-vjeçarit u gjet dhe sukses-

trua një shumë prej 340 milionë lekësh. Pas ndalimit nga blutë e kryeqytetit me urdhër të Prokurorisë së Krimeve të Rënda, "GSH" ka mundur të zbardhë dëshminë e gjyqtarit Shkëlqim Miri. Gjatë marrjes në pyetje, ai ka thënë se vetëm një

pjesë e parave ishin të tij (rreth 3 mln lekë), ndërsa pjesa tjetër ishte e një të afërmi të tij, i cili do të blinte një pronë në Tiranë. "Rreth 3 milionë lekë janë të miat, pjesa tjetër të një të afërmi i cili mi kishte lënë sepse do blinte një pronë të Tiranë. Kursimet i kisha nga pagat dhe i mbaja në shtëpi", është shprehur gjyqtari. Shkëlqim Miri është marrë në pyetje nga prokurori Klodjan Braho dhe dy oficerë të policisë gjyqësore në prani të avokatit të tij Ardian Visha. 46-vjeçari, i cili u ndalua nga policia për shpërdorim detyre dhe korrupsion, rrezikon të dënohet deri në 4 vite burg. Miri ka një karrierë 25-vjeçare në drejtësi, që nga gjyqtar i Shkallës së Parë, më tej gjyqtar Apeli në Durrës, anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë nga 2007 në 2011-ën dhe së fundmi gjyqtar i Apelit në Tiranë.

Pas festës së Pavarësisë në Shqipëri, imami Armand Ali ka publikuar një shkrim me titull "Mos festoni ditën e Pavarësisë, është haram!", në një rrjet social. Pas publikimit të shkrimit, Policia e Tiranës ka referuar ditën e mërkurë në prokurori materiale për imamin, në lidhje me këtë publikim. Almand Ali menjëherë pas takimit me strukturat e Policisë së Shtetit ka reaguar përmes një statusi në "Facebook", duke dashur të sqarojë gjyqtarët. Imami shpjegon se deklarata kundër Festës së Pavarësisë në profilin e tij u drejtohet besimtarëve myslimanë, duke theksuar se më shumë se 95% e shokëve në profilin e tij janë besimtarë myslimanë, ndërsa një numër i vogël u përkasin besimeve të tjera. "E folura ime pa lejen e Komunitetit Mysliman Shqiptar dhe hapësira që fjala ime ka zënë në media të ndryshme është bërë fenomen shqetësues edhe për vetë gylenistët, të cilët nuk mund t'i japin zgjidhje këtij problemi. Fajin e keni vetë, se nuk më keni lenë të qetë që të isha një imam i thjeshtë xhamie e t'i mësoja xhematit çështjet elementare të besimit", shkruan imami.

TIRANE - E ftuar në emisionin "Të Paekspozuarit" në "News 24", ish-ministria e Bujqësisë në vitet '75-'88, Themie Thomai rrefeu arsyet se pse nuk kishte përmbyteje në atë kohë. Duke iu referuar përmbyteje të fundit në Shqipëri si pasojë e reshjeve të fundit, ish-ministria në qeverinë e Enver Hoxhës tha se në atë kohë merreshin masat më përpara. "Kjo është një shkencë e tërë, por



Themie Thomai

Ish-ministria e Bujqësisë: Në kohën e Enver Hoxhës, vendi nuk përmbytej

funkciononte një rrjet i tërë kullues i kontrolluar. Tokat që shtrihen afër bregdetit në Vlorë, Fier, janë toka në nivel. Kolektori i madh pas trohej çdo vit. Të gjitha stacionet e pompimit në fund të gushitit kontrolloheshin dhe me komision të posaçëm merreshin me hidrovolet. Kontrolloheshin të gjitha

digat. Nuk lejohej të shkelnin as këmbët e bagëtive në diga. Merreshin masat që më përpara. Kanali i ujërave të mëdha dhe pritat përbënin atë që quhej rrjeti kullues", - tha Themie Thomai. Ish-ministria e Bujqësisë për 13 vite në kohën e diktatorës ka treguar edhe si u bë ministria e Bujqësisë në vitin 1976.

"Njeriu që ma komunikoi ishte Hysni Kapo dhe më tha që byroja ka vendosur do bëhesh ministre. U shtanga, u tremba dhe i thash se nuk bëja dot. E kemi menduar do e bësh - më tha. - Shkova në shtëpi, më pyeti nëna se pse të thirrën dhe i thash se më kishin bërë ministre Bujqësi", tha ajo.

Reagon avokati: S'ka lidhje me fisin Çapja, mbiemri i tij është Bylyku

Arrestohet në lokalin e basteve i kërkuari Besnik Çapja me tre mbiemra

I dënuar me 6.4 vjet burg në Itali për trafik kokaine

ELBASAN

Një 40-vjeçar i dënuar për trafik kokaine dhe pjesëmarrje në organizatë kriminale është arrestuar mbrëmjen e së mërkurës nga policia e Elbasanit për llogari të drejtësisë italiane. Bëhet fjalë për Besnik Çapjan, i cili ishte shpallur në kërkim ndërkombëtar nga autoritetet e vendit fqinj më 28 nëntor të këtij viti. Burime zyrtare nga Drejtoria e Policisë së Qarkut të Elbasanit, dhe bëjnë me dije se ai u vu në pranga specialistët e Sektorit për Hetimin e Narkotikëve dhe Trafikeve të Paligjshme në këtë drejtori, në bashkëpunim me Interpolin të Tiranës dhe FNSH-në. "Kapet dhe ndalohet me qëllim ekstradimi drejt Italisë shtetas Besnik Çapja, (alias Besnik Bylyku, Kliton Prifti), lindur dhe banues në Elbasan. Kapja e këtij shtetasi, i cili mbahej nën vëzhgim u bë në një pikë lloj-sporti në rrugën "Rinia", në lagjen "Visarion Xhuvani" Elbasan. Ky shtetas më datë 28.11.2017 ishte shpallur në kërkim ndërkombëtar, nga Interpol Roma, Itali, pasi autoritetet Gjyqësore në Torino, Itali, me vendim nr. SIEP 431/2017, datë 01.06.2017 e kanë dënuar me 6 vjet e 4 muaj burgim, për kryerjen e veprës penale të



I arrestuari Besnik Çapja

"Pjesëmarrjes në Organizatë kriminale, me qëllim trafikimin e lëndëve narkotike". Gjatë periudhës 01.06.2011 deri në 16.11.2011, në Torino, Santena, ky shtetas ka qenë në cilësinë e anëtarit të organizatës kriminale me qëllim trafikimin e sasive të mëdha të drogës, të llojit kokainë", thuhet në njoftimin e policisë së Elbasanit. Pas arrestimit të 40-

vjeçarit Besnik Çapja ka reaguar avokati i tij. Në një prononcim për "News 24", avokati i zgjedhur Alban Qafa mohon lidhjen me fisin Çapja, të njohur në këtë

qytet dhe i përmendur për disa ngjarje kriminale.

REAGIMI I AVOKATIT

Alban Qafa sqaroi se klienti i tij, Besnik Çapja ka mbiemër tjetër nga lindja,

AKUZA

Besnik Çapja është dënuar nga Gjykata e Torinos me 6 vjet e 4 muaj burgim, për kryerjen e veprës penale të "Pjesëmarrjes në Organizatë kriminale, me qëllim trafikimin e lëndëve narkotike".

ashtu si i familjes së tij. "Sqaroj në cilësinë e avokatisë: I arrestuari mbrëmë në Elbasan për llogari të Interpolit, me qëllim ekstradimi drejt Italisë. Nuk ka asnjë lidhje farefisnore me fisin Çapja. Mbiemri i tij nga lindja është Bylyku dhe i familjes së tij. Më pas e ka ndërnuar në Çapja", tha avokati Alban Qafa.

Policia: 41-vjeçari, organizator i një bande droge

Kërcënoi me armë prokurorin e Matit, kapet pas një viti i kërkuari Marko Bushi

TIRANË - Policia e Tiranës ka vënë në pranga një 41-vjeçar nga fshati Urakë i Burrelit, i cili ishte shpallur në kërkim që prej tetorit të vitit 2016. Bëhet fjalë për Marko Bushin, i cili dyshohet të jetë organizator i një grupi të strukturuar kriminal në fushën e kultivimit dhe trafikimit të lëndëve narkotike. Gjithashtu, ai akuzohet edhe për kërcënimin me armë të prokurorit të Matit, Abaz Muça, në tetor të vitit që shkoi. Mësohet se 41-vjeçari u kap në një lokal në rrugën "Jordan



Misja" të kryeqytetit gjatë operacionit të koduar "MYZË". Ai ishte vënë në ndjekje nga Policia e Shtetit që prej vitit 2016. Sipas burimeve policore, Marko Bushi u shpall në kërkim, pasi më datën 5 tetor të vitit të shkuar, gjatë një kontrolli ter-

ritori të ushtruar nga blutë për kultivim të bimëve narkotike në fshatin Myzë, u gjetën dy parcela të kultivuara me bimë narkotike. Gjatë këtij operacioni u asgjësuan gjithsej 10 480 bimë kanabis sativa. Gjithashtu, mësohet se 41-vjeçari ka kërcënuar prokurorin dhe forcat e policisë lokale. "Në vijim të veprimeve të kryera është bërë i mundur identifikimi i autorit, dokumentimi i veprimtarisë kriminale të tij dhe grupit që ai drejton në fushën e kultivimit dhe trafikimit të lëndëve narkotike. Nga hetimet e kryera rezultoi se ky shtetas ishte në rolin e organizatorit të grupit kriminal", bëri me dije policia. Gjykata e Krimeve të Rënda më datë 21.03.2017 ka caktuar masën e sigurisë "Arrest me Burg", për shtetasin e lartpërmendur, për veprat penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve", "Kultivimi i narkotikëve", "Grupi i strukturuar kriminal" dhe "Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal". In.al

OPERACIONI ANTIDROGË

Marko Bushi u shpall në kërkim, pasi më datën 5 tetor të vitit të shkuar, gjatë një kontrolli territori të ushtruar nga blutë për kultivim të bimëve narkotike në fshatin Myzë, u gjetën dy parcela të kultivuara me bimë narkotike. Gjatë këtij operacioni u asgjësuan gjithsej 10 480 bimë kanabis sativa.

PERMBARUESI GJYQËSOR PRIVAT ERMIR GODAJ

Pembaruesi gjyqësor privat Ermir Godaj zhwilloi ankandin e pare për shlyerjen e pasurisë së paligjshme "Trulli me sipërfaqe 200 m², nga të cilat 200 m² Ndërtues, me Nr. Pasurie 554/3, Vol.5, Fq.183, Z.K.3070, e ndodhur në Puke", e lenë kolateral për garantimin e kredisë, për shlyerjen e detyrimit në favor të kreditorit ProCredit Bank Sh.a., për shumën 1822310.51 (një milion e tetëqind e njëzetë e dy mijë e treqind e dhjetë e dhjetë pikë pesëdhjetë e një) Lekë. Çmimi filluesar më të cilin fillon ankandi është në shumën 1354656 (një milion e treqind e pesëdhjetë e kater mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e gjashtë) Lekë. Ankandi zhvillohet në datë 18.12.2017, ora 16.00 në zyrën e përmbareut gjyqësor privat Ermir Godaj, Rruga "Abdi Toptani", qendra Torre Drin, kt.2, nr.33, Tirane, dhe për informacion mund të kontaktoni në nr.0682099471, 0684054605, email ermirgodaj@zyrapembarim.com.

SHKURT

Zhdokja e avokatit Muço, prokuroria italiane kërkon bashkëpunim

me autoritetet shqiptare

ITALI - Prokuroria në Macerata të Italisë ka kërkuar bashkëpunimin e autoriteteve shqiptare për të zbardhur misterin e zhdokjes së avokatit shqiptar, Bashkim Muço. 54-vjeçari është zhdokur që prej 2 nëntorit dhe deri më tani nuk ka asgjë gjurmë të tij. Bileta e tij ishte "shënjuar" për të kryer udhëtimin nga Porti i Durrësit drejt Italisë, ku jetonte familja e tij, por askush nga personeli, apo pasagjerët e tjerë të atij udhëtimi nuk pranoi ta ketë parë në traget. Lidhur me këtë ngjarje, Prokuroria në Macerata ka hapur një dosje për ngjarjen, duke e cilësuar si vrasje në mënyrë që t'i japë një shtysë më të fortë hetimit dhe për të zbardhur rastin. Sipas mediave italiane, për këtë çështje, kjo prokurori u ka dërguar një kërkesë porosi autoriteteve të Durrësit, në mënyrë që të bashkëpunohet për zbardhjen e ngjarjes. I dyshimtë është fakti se bileta e udhëtimit të avokatit shqiptar është e shënjuar në oort, po kështu policia ka gjetur disa sende personale të avokatit në traget, por vetë 54-vjeçarin nuk e ka parë askush. Besnik Muço do udhëtonte drejt Maceratas, ku së bashku me familjen ishin zhvendosur për të jetuar që në fillim të viteve '90.

Foto me armë e flamuj,

si u zbuluan dhe u dëbuan nga Italia

2 shqiptarët e ISIS

ITALI - Të tjerë detaje dalin në dritë nga dëbimi i dy të rinjve shqiptarë nga Italia, me pretendimin se shfaqnin rrezik kombëtar dhe se kishin lidhje me luftëtarët e ISIS. Mediat italiane raportojnë se pas hetimeve të policisë, rezultoi se shqiptarët, 23 dhe 24 vjeç, u përzunë pas kontrollit të imtësishtëm të profileve të tyre në rrjetet sociale. "Il giornale" shkruan se dy të rinjtë kishin publikuar në rrjetin social dokumente antiperëndimore dhe antisemitë edhe në përpunje me atentatet e bëra në Evropë, për të cilët përgjegjësia është marrë përsipër nga ISIS. Po ashtu, në profilet e tyre të "Facebook"-ut shqiptarët kanë publikuar foto me armë në duar. Mediat italiane mes të tjerash shkruajnë se shqiptarët ishin pjesë e një grupi në aplikacionin "Whatsapp" ku fton për xhihad (të jenë pjesë e ISIS). Dy shqiptarët u shoqëruan nga policia në një anije të nisur nga Bari drejt portit të Durrësit dhe më pas u dorëzuan autoriteteve shqiptare të Antiterrorizmit.

Plagos dy persona me thika afër një lokali, prangoset 25-vjeçari

VLORË - Pas një konflikti mes disa të rinjsh në qytetin e Vlorës shërri ka përshkallëzuar me nxjerrjen e thikave, duke përfunduar me plagosjen e dy prej tyre. Burime nga policia lokale bëjnë me dije se ngjarja ka ndodhur për motive banale në lagjen "Pavarësia" të qytetit bregdetar. Në lidhje me këtë ngjarje është arrestuar 25-vjeçari Antonio Veizaj, i cili akuzohet për veprën penale "Plagosje e rëndë me dashje". Sipas bluve, i riu në afërsi të një lokali është konfliktuar me fjalë dhe fizikisht, duke përdorur mjete prerëse (thikë), me shtetasit K.I., dhe I.I., ku ky i fundit ka mbetur i dëmtuar rëndë. Mësohet se dëmtime të lehta ka marrë edhe vetë Veizaj.



NJOFTIM I ALBTELECOM Sh.A.

ALBtelecom ju bën me dije se njoftimi i bërë prej kompanisë në datat 5, 6, dhe 7 dhjetor 2017 nuk është më i vlefshëm.

ALBtelecom do të vijojë t'i ofrojë ofertat/paketat ekzistuese për klientët e saj: SUPER 500(1), 500(2), 700, 1000, 1200, 1500, 2000, të cilat kanë përmbajtje dhe përfitime nga më të mirat në treg.

Për më shumë informacion vizitoni dyqanet tona, faqen tonë zyrtare www.albtelecom.al ose telefononi Shërbimin e Klientit në 125.

"Shteti të hedhë sytë në këtë zonë, banorët izolohen për muaj të tërë"

Udhëtimi i ferrit në Dukagjin, 150 persona humbën jetën në aksidente

Engjëll Rahodina: S'ka rrugë tjetër në Europë, që të ketë një numër kaq të lartë viktimash

Senad Nikshiqi

SHKODËR

Të shkosh gjatë dimrit në zonën malore të Dukagjinit në Shkodër është guxim i madh, pasi rruga është e amortizuar dhe deri tani ka marrë 150 jetë njerëzish. Engjëll Radohina, njohës i zonës, por edhe pronar i një firme që ka mjete për mirëmbajtjen e akteve rrugore dhe tregoi vështirësitë gjatë një rrugëtimi në makinën e tij. Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", ai tha se rruga që të çon në Dukagjin është e tmerrshme dhe pa frikë mund të quhet rruga e vdekjes. "Nuk mendoj se ka një rrugë tjetër në Europë, që në aq pak kilometra të ketë një numër kaq të lartë viktimash", u shpreh Radohina. Ai i bëri apel shtetit që të ndërhyjë me investime në këtë zonë. Ndërkaq, mësohet se që prej 7 ditësh, banorët e Thethit janë të bllokuar nga bora.

Sa e vështirë është të udhëtosh në rrugën që të çon drejt Dukagjinit?

Është shumë e vështirë, sepse njëra anë e rrugës është e amortizuar dhe ana tjetër ka një trashësi bore, që në Qafë-Thore shkon deri në 1 metër.

Është e rrezikshme të udhëtosh në këtë mënyrë?

Shumë e rrezikshme është. Ka afro 50 cm borë këtu ku jemi, mbi Bogë, ndërsa në Qafë-Thore momentalisht ka 1 m bore, ndaj edhe nuk mund të shkohet pa u hapur rruga. Mjafton vetëm 1 sekondë që të shpërndrohet dhe rrezikon jetën. Duhet të jesh një supershofer, por edhe një ngasës shumë i mirë i makinës në borë.

Sa persona kanë humbur jetën nga aksidentet në rrugën e Dukagjinit?

Deri më tani, në aksin e Breg Lumit janë 150 persona që kanë humbur jetën nga aksidentet. Nuk mendoj se ka një rrugë tjetër në Europë, që në aq pak kilometra të ketë një numër kaq të lartë viktimash. Është një rrugë e tmerrshme dhe pa frikë mund të quhet rruga e vdekjes. Ama banorët atje ashtu udhëtojnë, aq sa munden, sepse nuk kanë zgjidhje tjetër, janë të detyruar.

Momentalisht Thethi dhe fshatrat e tjerë janë të izoluar?

Momentalisht mund të themi se po. Janë afro 150 familje që mund të jenë të izoluar, sepse rruga nga Qafë-Thore është e bllokuar, ndërsa nga ana tjetër është shumë e rrezikshme për të kaluar, për shkak të ngriçave dhe trashësisë së borës, që shkon deri në 40 cm.



Engjëll Radohina duke folur për "GSH"



Rruga e Dukagjinit



Deri kur qëndron rruga e bllokuar?

Para 3 viteve unë dhe banorët e Thethit tentuam që me paratë tona të hapim rrugën. Morën në celular ministrin e asaj kohe. Ishte

maj dhe kishte 2 metër e gjysmë borë në Qafë-Thore. Ministri nuk e besoi dhe më tha: "Po tallsh?! Si është e bllokuar rruga, jemi në maj". U detyrova që përmes fotografive që i kam ende ta

bind se rruga ishte e bllokuar. Pra, qëndron për disa muaj e bllokuar, nëse nuk ndërhyhet.

Sa i dëmton banorët e Thethit dhe fshatrat e tjerë kjo situatë?

Natyrisht që i dëmton shumë. Para dy vitesh, disa familje u rikthyen në Theth me idenë se menduan se do zhvillohet turizmi malor. Janë afro 40 bujtina, në të cilat banorët janë rikthyer

dhe kanë investuar gjithë pasurinë e tyre. Tani ata nuk kanë si largohen, sepse janë të detyruar që të mbrojnë bizneset e tyre. I dhanë një zhvillim tjetër zonës dhe u shtuan turistët e huaj. Para dy viteve në Theth nuk kishte as 10 familje, sepse të gjithë ishin larguar. Edhe pse janë kthyer, prapë janë shumë pak në krahasim me sa duhet të jenë aty. Ata shpresojnë se turizmi malor, duke dëgjuar propagandën e geverisë, do të zhvillohet. S'kanë si largohen sepse humbin gjithçka që ndëruan në gjithë këto vite me shumë mund e djersë.

A mund të arrihet që rruga të mbahet e hapur të paktën nga Qafë-Thorja?

Patjetër që po. Janë vetëm 10 km rrugë që duhen shtruar nga Qafë-Thorja ku mbaron asfalti. U investua para disa vitesh duke shtruar rrugën Bogë-Qafë Thore me 4.2 milionë euro dhe tani rruga nuk mirëmbahet dhe qëndron e bllokuar. Kjo nuk është normale. Mjafton që të ketë një angazhim total të institucioneve dhe rruga qëndron e hapur. Unë kam mjetet e mia dhe me vetëm 80 milionë lekë të vjetër, nga Boga në Malësinë e Madhe ku nis bora dhe deri në Qafë-Thore rruga qëndron 24 orë e hapur. Nuk ka asgjë të paarritshme.

Cili është apeli juaj?

Shteti të hedhë sytë në këtë zonë. Është hera e parë në fakt që po mendohet seriozisht për ta hapur rrugën dhe ka ndërhyrë ARRSH për ta bërë një gjë të tillë. Shpresojmë që t'ia arrijë qëllimit, sepse banorët e zonës nuk kërkojnë asgjë tjetër. Kur qeveria thotë turizmi malor, ky është turizmi malor, të mbahen rrugët hapur, tjerat i ofrojnë vetë ata që kanë bujtina.

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE. LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA, ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.



MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ CELULAR SMARTPHONE OSE TABLET



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

BalkanWeb.com
BW

FALAS



BLLOKIMI

Autoriteti Rrugor Shqiptar po mundohet që të hapë aksin Bogë-Qafë-Thore-Theth me mjetet e tonazhit të lartë, por nuk do të jetë e lehtë, edhe pse institucionet për herë të parë kanë një angazhim serioz. Kreu i ARRSH Shkodër, Shkëlqim Sterkaj pohoi se deri në fundjavë parashikon hapjen e atij aksin problematik.

RRUGA E "VDEKJES"

"Deri më tani, në aksin e Breg Lumit janë 150 persona që kanë humbur jetën nga aksidentet. Nuk mendoj se ka një rrugë tjetër në Europë, që në aq pak kilometra të ketë një numër kaq të lartë viktimash. Është një rrugë e tmerrshme dhe pa frikë mund të quhet rruga e vdekjes. Ama banorët atje ashtu udhëtojnë, aq sa munden, sepse nuk kanë zgjidhje tjetër, janë të detyruar", tha biznesmeni Engjëll Radohina.

Ja informacioni që i ofrohet kandidatëve

Ambasada amerikane: Ndhimë për viktimat e dhunës, pavarësisht statusit të imigrimit

Viktimat e dhunës në familje mund të marrin ndihmë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, pavarësisht statusit të tyre të imigrimit. Ky njoftim është bërë me dije ditën e djeshme në faqen zyrtare të ambasadës amerikane. "Në Shtetet e Bashkuara të gjitha viktimat e dhunës në familje, pavarësisht statusit të tyre të imigrimit, mund të kërkojnë dhe të marrin ndihmë", -citon ambasada. Departamenti Amerikan i Shtetit shpreh mirëseardhjen për të gjithë ata që po emigrojnë për të jetuar e punuar në "tokën e premtuar", normalisht duke qenë zbatues të rregullt të ligjit. Nëpërmjet një website-i

MBROJTJA

"Sulmet seksuale dhe abuzimi i fëmijëve janë të paligjshëm në Shtetet e Bashkuara dhe të gjithë njerëzit në SHBA janë të garantuar me ligj nga abuzimi. Të gjithë viktimat e dhunës në familje, pavarësisht nga statusi i imigracionit, mund të kërkojnë dhe të marrin ndihmë." -citetoh në faqen zyrtare të Departamentit Amerikan të Shtetit.

dhe pamfleti, të gjithë kandidatët që do të aplikojnë për vizat K-1 si të fejuar të shtetasve amerikanë, viza K-3 e IR-1 / CR-1 si bashkëshortë të shtetasve amerikanë, dhe

viza F2A si bashkëshortë të banorëve të përhershëm të ligjshëm të SHBA, mund të informohen mbi të drejtat e tyre ligjore lidhur me dhunën në familje, sulmet

seksuale dhe abuzimin e fëmijëve. Gjithashtu, aplikantët kanë të drejtë të marrin informacion në lidhje me ndonjë të shkuar kriminale mbi të fejuarin/en apo bashkëshortin/en amerikane. "Ne e kuptojmë se nuk mund të njihemi me gjithë ligjet në këtë vend. Ne duam që ju të dini, në të gjitha rrethanat, se dhuna në familje, sulmet seksuale dhe abuzimi i fëmijëve janë të paligjshme në Shtetet e Bashkuara dhe se të gjithë njerëzit në SHBA janë të garantuar me ligj nga



Ambasada amerikane

abuzimi. Të gjithë viktimat e dhunës në familje, pavarësisht nga statusi i imigracionit, mund të kërkojnë dhe të marrin ndihmë." -citetoh në faqen zyrtare të Departamentit Amerikan të Shtetit. Më tej ky i fundit

thekson se gjatë përgatitjes për intervistën për vizë, aplikanti, gjithashtu, do të duhet të sigurohet që të ketë gati të gjithë dokumentacionin e kërkuar duke përfshirë aplikimin e plotësuar për vizë.

Kryebashkiaku: Lehtësim procedurash për qytetarët, ja nismat e tjera të Bashkisë së Tiranës

'E-kioskë', 70 dokumente zyrtare do të jepen

Veliaj: Shmangie korrupsionit dhe radhëve të gjata

Voltiza Duro

P prej janarit të 2018, qytetarët e Tiranës do të kenë mundësinë të tërheqin rreth 70 dokumente zyrtare në një e-kioskë, çka do të evitojë pritjet e gjata në radhë dhe do të rrisë transparencën. Burime nga Bashkia e Tiranës bëjnë me dije për "Gazeta Shqiptare" se ende po punohet me listat dhe përcaktimin e dokumentave që do të sigurohen online. Ndërkaq, kryebashkiaku Erion Veliaj, i pranishëm në konferencën rajonale "Qytetet pa korrupsion të së ardhmes", - tha se po punohet për të zgjeruar gamën e këtyre lloj shërbimesh. Sipas tij, kjo do të shmangë kontaktin me punonjësit dhe do të reduktojë mundësinë për korrupsion. Ky takim u zhvillua nga PNUD, ku morën pjesë kryetarë bashkish nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Moldavia dhe Ukraina. "Ajo që po bëjmë është që 70 dokumente, duke filluar nga janari, në Tiranë do të jepen në një kioskë, njësoj si bankomati. Mjafton të futësh ID, do paguash tarifën dhe e merr të printuar", - theksoi Veliaj. Më tej, ai shtoi se në këtë mënyrë qytetarët nuk do të humbasin më 9 ditë në vit për të marrë një dokument zyrtar. "Qeveria shqiptare dhe kryeministri ka marrë një vendim shumë të guximshëm. I ka anuluar certifikatat për nevojat e një institucioni shtetëror me një qytet. Por, për institucionet private, për bankat, për kontrata, për noterë, ende kërkohet certifikata nga palë

të tjera. Një shqiptar mesarisht harxhon 9 ditë në radhë në marrje shërbimesh në vit. Unë besoj se kjo është mënyra më e mirë se tregon jo vetëm modernizim, por edhe shmang korrupsionin", - tha Veliaj. Ky i fundit, gjatë konferencës, prezantoi edhe disa nisma të tjera të ndërmarra nga Bashkia e Tiranës që synojnë lehtësimin e procedurave për qytetarët dhe shmangien e

mundësive për korrupsion. Respektivisht, kryebashkiaku tregoi se kalimi në sistem online të procedurave për lejet e ndërimit, aplikacioni "Tirana ime" për denoncimet e qytetarëve si dhe programi "Open Data"; mundësojnë një proces komplet transparent, modern dhe anti korruptiv. "Qytetet pa korrupsion të së ardhmes" është konferenca e parë rajonale e këtij lloji, e

cila ofron një mundësi për të shkëmbyer përvojat rreth arritjeve dhe sfidave për të

parandaluar korrupsionin në nivel vendor, duke përfshirë ato në nivel qyteti,

garku apo rajoni dhe nivelet e tjera nënkombëtare të administratës publike.



Erion Veliaj në konferencën rajonale "Qytetet pa korrupsion të së ardhmes"



Kryebashkiaku

PROCEDURA

"Ajo që po bëjmë është që 70 dokumente, duke filluar nga janari, në Tiranë do të jepen në një kioskë, njësoj si bankomati. Mjafton të futësh ID, do paguash tarifën dhe e merr të printuar. Unë besoj se kjo është mënyra më e mirë se tregon jo vetëm modernizim, por edhe shmang korrupsionin", - theksoi Veliaj.



PAGUAJ NË POSTË FATURAT E ENERGJISË, UJIT, KËSTET E KREDISË, ETJ.

- * Proces i garantuar direkt në sistemin online
- * Apliko për kredi bankare në çdo sportel të postës
- * Shërbime në zyrat postare në 7 ditë të javës



SHPEJT. SIGURT. KUDO.

POSTA SHQIPTARE



www.postashqiptare.al



Lihen në burg tre krerë të Vetëvendosjes, akuzat për përdorim armësh e mjete të rrezikshme

Gjykata e Apelit e Kosovës ka refuzuar si të pabazuar ankesën e avokatit mbrojtës të të akuzuarit Albin Kurti, kundër aktvendimit mbi caktimin e masës së paraburgimit prej 1 muaji, të nxjerrë nga Gjykata Themelore në Prishtinë, më

27.11.2017. Albin Kurti së bashku me Donika Kadaj-Bujupi, Albulena Haxhiu dhe Faton Topalli akuzohen për veprën penale "Përdorim i armësh apo mjeteve të rrezikshme" nga neni 375, paragrafi 1 i Kodit Penal të Kosovës dhe Veprën penale;

"Pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare" nga neni 409 i të njëjtit kod. Kolegji profesional prej tre gjyqtarësh i kësaj gjykate ka vlerësuar se pretendimet ankimore të mbrojtjes janë të pabazuara, ngaqë sikur del nga

shkresat e lëndës, të akuzuarit Albin Kurti dhe Donika Kadaj-Bujupi më 26.11.2017 e kanë shkelur masën e arrestit shtëpiak, të caktuar nga ana e Gjykatës së Apelit më 25.11.2017. Ndaj sipas Gjykatës së Apelit, Gjykata e Shkallës së Parë ka vepruar drejt, kur u ka caktuar masën e paraburgimit.

Vizita e parë pas 65 vitesh, kërkohet kthimi i ushtarakëve dezertorë në Turqi

Marrëveshja e Lozanës fut në sherr Erdoganin me Pavlopulos

Presidenti turk për rishikim, greku: S'ka vend për reformim

Rexhep Tayyip Erdogan ka mbërritur të enjten në një vizitë dyditore në Greqi, e para e një presidenti turk në 65 vitet e fundit. Erdogan, nën masa shumë të rrepta sigurie u prit në një takim nga presidenti grek, Prokopis Pavlopulos, me të cilin pati edhe një konferencë të tensionuar për shtyp. Presidenti grek ia bëri të qartë Erdogani se marrëveshja e Lozanës, e nënshkruar pas luftës greko-turke në vitin 1923, nuk është një marrëveshje që mund të reformohet. "Nuk besojmë se mund të reformohet, nuk është një marrëveshje e hapur për diskutim", tha Pavlopulos. Marrëveshja e Lozanës është marrëveshja që përcaktoi kufijtë e dy vendeve dhe detyrimet ndaj minoriteteve në dy vende. Por, Turqia duket se është e pakënaqur me vijën kufitare dhe respektimin e të drejtave të minoritetit turk në Greqi.



vetëm mes Turqisë dhe Greqisë, por në të cilën ishin përfshirë edhe 11 shteteve të tjera. "Mendoni që në marrëveshjen e Lozanës është edhe Japonia, Britania e Madhe dhe Portugalia". Erdogan më tej kritikoi Gre-

qinë se nuk po e zbatonte as marrëveshjen ekzistuese në lidhje me të drejtat e minoritetit turk në Trakë. Ai i kujtoi homologut të tij se patriarku i kishës në Turqi nuk zgjidhet nga shteti, e kështu as Athina zyrtare nuk ka të

drejtë të zgjedhë myftiun e myslimanëve në Greqi. Lidhur me debatet për veton greke ndaj futjes së Turqisë në BE, Erdogani solli në kujtesë se pa mbështetjen e Ankarasë, Greqia nuk do të mund të rifutej sërish në

NATO, pasi ishte larguar nga aleanca ushtarake. Tre avionë grekë F-16 shoqëruan avionin e presidentit turk, Erdogani, pasi ai u fut në hapësirën ajrore të Greqisë. Të gjitha rrugët nga kalon autokolona e tij në Athinë janë

MARRËVESHJA
Presidenti grek ia bëri të qartë Erdogani se marrëveshja e Lozanës, e nënshkruar pas luftës greko-turke në vitin 1923, nuk është një marrëveshje që mund të reformohet. "Nuk besojmë se mund të reformohet, nuk është një marrëveshje e hapur për diskutim", tha Pavlopulos. Marrëveshja e Lozanës është marrëveshja që përcaktoi kufijtë e dy vendeve dhe detyrimet ndaj minoriteteve në dy vende. Por, Turqia duket se është e pakënaqur me vijën kufitare dhe respektimin e të drejtave të minoritetit turk në Greqi.

mbyllur për qytetarët për arsye sigurie. Gjatë vizitës dyditore, Erdogan pritet të kërkojë edhe një herë ekstradimin e ushtarakëve turq, që u arratisën në Greqi menjëherë pas tentativës së dështuar për grusht shteti. Të premtën ai do të udhëtojë drejtë Takës, ku do të takojë komunitetin mysliman atje.


TERRORIZMI



Terroristët e ISIS vriten me raketë në tentativë për t'u arratisur

Një kamera GO PRO ka filmuar momentet kur disa terroristë të ISIS vriten gjatë tentativës për t'u larguar nga një bazë e tyre mbrojtëse e improvizuar. Luftëtarët e ISIS u goditën nga një raketë e ushtrisë siriane, pas disfatës në betejë me ushtarët e Hezbollahit dhe ushtrisë siriane. Terroristët u eliminuan menjëherë nga një goditje e drejtpërdrejtë me raketë antitank. Pamjet dramatike tregojnë momentet e fundit të një luftëtari që përpiqej të largohej. Duke bërë turr në arabisht, terroristët e ISIS dëgjohej duke thërritur se nga cilat drejtime po qëllohen. Sipas "Daily Mail", regjistrimet besohet se i përkasin muajit shtator.

JERUZALEM



Njohja e Jeruzalemit nga SHBA, ushtria shtohet në Cisjordani

Ushtria izraelite njoftoi se do të dislokojë një arsenal shtesë në Cisjordani, territor palestinez i pushtuar, pas vendimit të presidentit amerikan, Donald Trump për njohjen e Jeruzalemit si kryeqytet të Izraelit. Një zëdhënës e ushtrisë njoftoi dërgimin e batalioneve shtesë në Cisjordani. Ajo shtoi se forca të tjera po përgatiten për të ndërhyrë, ndërsa njoftimi i Trump ngjall frikën e akteve të dhunës. Zëdhënësja nuk specifikoi numrin e saktë të efektivëve të përfshirë në operacionin ushtarak.

PREMIERA

Gruaja e (pa)ndershme që “paragjykohe” nga Viktor Zhusti

Vdekja e Margerites përshkruhet si një agoni, e cila nuk ka fund, duke e gjetur veten të braktisur nga të gjithë. Është kjo “Dama me kamelie” pjesa e shkruar nga Aleksander Dumas, që vjen në Teatrin Kombëtar, premierë absolute në datat 8, 9, 10 dhjetor në orën 19:00. “Dama me kamelie”, është historia tragjike e një vajze që deshi të bashkojë dy botë dhe një djali që mendoi se mund t'i ndryshojë të dyja! Një histori e trishtë dashurie mes një vajze – shitet dhe një borgjezi të ri... Ajo është një betejë e përjetshme e reales me të drejtën. Realiteti i pandryshueshëm, skamje, luks, mentalitet, fate të mbërthyer fort nga pasioni. Shfaqja vjen në skenë me regjinë e Luli Hoxhës dhe me dramatisimin e Laert Vasilit dhe regjisorës. Në role janë Laert Vasili, Luli Hoxha, Viktor Zhusti, Rajmonda Bulku, Gjergj Mena, Xhino Musollari, Josif Sina dhe Karafil Shena. Mes dashurisë së Laertit me Lulin, është Viktor Zhusti, burri i moshuar, që rron me të vjetrën, për të cilin rëndësi ka imazhi dhe nderi - edhe kur nderi i serës së lartë, bie krejt në kundërshtim me dashurinë, aktori ndan çiftin e dashuruar,

“Dama me kamelie” në Teatrin Kombëtar. E ndërsa Laert Vasili, luan dashnorin e madh të letrave frënge, përkrah tij, është gruaja e ndaluar që dashuron.


Shkruar nga Alexandre Dumas, (1824-1895), kur ai ishte 23 vjeç. U publikua për herë të parë në vitin 1848. “Dama me Kamelie” një vepër gjysmë-autobiografike, e cila bazohet në dashurinë e një kurtizane vendosur në mes të shekullit të XIX në Francë. Vepra tregon një histori tragjike dashurie mes karakterit ëndërrimtar të Margerite Gutier një kurtizane, e cila vuan nga tuberkulozi dhe Armand Duval, një borgjez i ri. Margerite është quajtur “Dama me kamelie” pasi shoqëruese e saj besnike është përhër një kamelie e kuqe në kohën kur ajo është në ciklin e saj muor duke treguar kështu se është e padisponueshme për të bërë dashuri dhe një kamelie e bardhë kur ajo është në dispozicion për dashnorët e saj. Armand bie në dashuri me

Aktori ndan çiftin e dashuruar, “Dama me kamelie” në Teatrin Kombëtar

Laert Vasili, dashnori i madh i letrave frënge e gruaja e ndaluar që dashuron



Poster i shfaqjes



Viktor Zhusti

Margerite dhe në fund bëhet i dashuri i saj. Ai tenton ta bindë atë të lërë jetën e saj si kurtizane dhe të shkojë të jetojë me të në fshat. Kjo marrëdhënie e zjarrtë mes tyre do të ndërpritet nga babai i Armandit, i cili i venë në dijeni për skandalin e krizuar nga kjo marrëdhënie e jashtëligjshme dhe i frikësuar se kjo marrëdhënie do të ndikojë edhe në martesën

e motrës së Armandit shkon të bindë Margeriten të largohet nga biri i tij. Deri në vdekjen e Margerites, Armand beson se ajo e la atë për një burrë tjetër. Vepra hap siparin pas vdekjes se Margerite. Disa studues besojnë se sëmundja e Margerite ishte një sëmundje e shekullit të XIX. Duma është treguar i kujdesshëm në portretizimin e favorshëm të Margerite, i cili pavarësisht nga kaluarja e saj i është dhënë virtytshëm dashurisë së saj të vuajtshme për Armandin dhe vuajtjeve të dy të dashuruarve. Dashuria, e cila do të shkatërrohet nga nevoja dhe morali i kohës, si kontrast i kësaj dashurie të dhunuar nga mentaliteti i kohës, si dhe situatës kaq sakrifikuese deri në momentin kur bëhet e perealizueshme kjo dashuri, me hyrjen e babait të Armandit në skenë. Fa.NI.

PROJEKTI

Teatri shkon në “fshat”

“Festivali francez” si e ardhmja jonë, 25 shfaqje në 6 zona të vendit

Një projekt ambicioz si Festiva li i Teatrit francez, synon të dërgojë teatrin “në fshat”. 25 shfaqje në 6 zona të vendit, do të sjellin një fytyrë të re të teatrit shqiptar. Drejtori Kiço Londo foli për këtë bashkëpunim mes Teatrit Eksperimental dhe ambasadës franceze duke e quajtur këtë përvojë të ardhmen e teatrit shqiptar.

Ky projekt shtrihet nga shtatori 2017 në maj 2018 dhe do të kulmojë në muajin e frankofonisë 2018. Festivali në mënyrë të veçantë synon t'u japë hapësirë dhe mundësi kryesisht krijuesve të rinj dhe në ka në fokus krijues nga të gjashta rajonet ku do të zhvillohet ky festival. Festivali pritet të gjallërojë lëvizjen teatrorë në të gjithë hapësirën e Shqipërisë duke hedhur themelet e lëvizjes teatrorë në bazë të rajoneve, që është edhe një nga objektivat. Njëherit, festivali nxit aktivizimin e krijuesve dhe interpretuesve të rinj duke i lar-



Prezantimi i projektit

guar ata nga debatet shterpë. “Festivali i Teatrit Francez” do të vijë në një formë dhe energji krejt të re, më shumë se paraardhësi i tij “Festivali i regjisorëve të rinj”. Ambasada franceze dhe Teatrit Eksperimental duan të realizojmë gjashtë produksione me rreth 25 shfaqje secili. Territori i Sh-

qipërisë do të ndahet në gjashtë rajone nga veriu në jug dhe secili rajon do të realizojë një produksion.

RAJONET

Rajoni 1 është Shkodër-Kukës që do të realizojë shfaqjen “Darka e lamtumirës” Alexandre de la Patellière, Matthieu Delaporte.

Rajoni 2 është Durrës – Lezhë që do të realizojë shfaqjen “Boing boing” nga Mark Kamoletti.

Rajoni 3 është Tiranë – Peshkopi që të realizojë shfaqjen “Emri” (“Le prénom” – nga Matthieu Delaporte e Alexandre Dubois de La Patellière.

Rajoni 4 është Elbasan –

Korçë që do të realizojë shfaqjen “Shërbëtoret” (“Les bonnes” nga Jean Genet).

Rajoni 5 është Fier – Berat që do të realizojë shfaqjen “Zoti i masakrës” (“Le dieu de carnage” - Yasmina Resa).

Rajoni 6 është Gjirokastrë – Vlorë që do të realizojë shfaqjen “Oskari dhe zozja Rozë” (“Oscar et la dame rose” nga Schmitt). Në mars 2018, përgjatë javës së dytë të Frankofonisë 2018 në sallën e TKEKS në Tiranë do të zhvillohet java e “Festivalit të Teatrit Francez”. Për gjashtë netë, secila trupë do të ngjise në skenë produksionin e vet, vetëm njëherë dhe juria profesioniste e përbërë nga tri personalitete të fushës dhe i ftuari special nga ambasada franceze do të vlerësojnë produksionet me çmimet: Shfaqja më e mirë, Skenografia më e mirë, Kostumografia më e mirë, Aktori dhe aktoria protagon-

nistë më të mirë, Aktori dhe aktoria joprotagonistë më të mirë dhe Përkthimi më i mirë. Ky festival në mënyrë të veçantë synon t'u japë hapësirë dhe mundësi kryesisht krijuesve të rinj dhe në ka në fokus krijues nga të gjashta rajonet ku do të zhvillohet ky festival. Përfaqësuesja e ambasadës franceze, Roza Ambuzu tha se teatri prek çështje me interes për shoqërinë. “Rëndësia e këtij teatri qëndron në faktin se aty shprehet satira sociale dhe përmes tij ngrihen problematika të shoqërisë së cilës ne i përkasim”.

Në TKEKS u vu theksi te përcjellja e idesë se një frymë e re pritet të vijë në Shqipëri, falë bashkëpunimit me ambasadën franceze. Do të jenë 6 trupa të ndryshme që luajnë 25 shfaqje në 6 zona të vendit. Aktori Gentian Zenelaj u shpreh se ky projekt do ta çojë teatrin edhe në ato zona ku ka munguar prej kohësh.

Shfaqja e parë është në qytetin e Durrësit, premiera ‘Boeing, Boeing’.

FA.NI.

Ndërtuan pa leje në tokën e të tretëve, 500 pronarët që marrin tapitë për oborret në të gjithë vendin

ALUIZNI, 638 pronarët përfitojnë kompensimin

Vendimi i Këshillit të Ministrave, lista me 1.138 persona

Ornela Manjani

ALUIZNI publikon listën me 500 personat që kanë ndërtuar pa leje dhe marrin tapitë për parcelën ndërtimore dhe 638 pronarët që u është prekur toka nga ndërtimet pa leje dhe marrin kompensimin për truallin. Përfituesit janë në të gjithë vendin dhe "Gazeta Shqiptare" publikon listën e plotë ku përfec gjeneralleteve të përfituesve është edhe sipërfaqja takuese që legalizohet dhe shuma e përfitimit për pronarët që kompensohen.

PROCEDURAT

Personat që kanë ndërtuar pa leje përfitojnë tapi për një sipërfaqe që është e barabartë me trefishin e sipërfaqes së ndërtimit, por jo më shumë se 500 m². Ndërsa pronarët kompensohen me vlerën e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave në hartën e vlerës. Vlera e kompensimit varion sipas zonave. Sipas ligjit në fuqi kur parcela e ndërtimit të legalizuar shtrihet mbi pasuri të paluajtshme në pronësi private, të subjekteve joposueduese të ndërtimit, nëpërmjet të njëjtit akt administrativ miratohet masa dhe vlera e

kompensimit financiar për sipërfaqet takuese, pronë private, që preken nga ndërtimi. "Vendimi i Këshillit të Ministrave për kalimin e së drejtës së pronësisë dhe miratimin e masës e vlerës së kompensimit për sipërfaqet, pronë private, që preken nga ndërtimet e legalizuara, është i vlefshëm për regjistrimin përfundimtar të parcelës ndërtimore në regjistrin e pasurive të paluajtshme. Sipas ligjit në fuqi, janë një sërë rregullash për kalimin e të drejtës së pronësisë dhe miratimit të masës e vlerës së kompensimit"-thuhet në aktin normativ që rregullon

kompensimin e pronës së prekur nga ndërtimet pa leje. Nëse poseduesi është bashkëpronar në pasurinë ku ndodhet ndërtimi i legalizuar, për rregullimin e pronësisë në parcelën ndërtimore zbatohen këto rregulla: a) Kur pjesët takuese ideale të bashkëpronësisë janë të papërcaktuara, ato prezumohen të barabarta (në përpjesëtim me numrin e të gjithë bashkëpronarëve); b) Pjesa takuese ideale e poseduesit llogaritet në sipërfaqen e parcelës ndërtimore. Nëse, pas kësaj, nuk plotësohet sipërfaqja e parcelës ndërtimore, për sipërfaqen e mbetur të saj kry-

het kalimi i pronësisë në favor të poseduesit, si dhe kompensimi i bashkëpronarëve të tjerë, sipas pjesëve të tyre ideale; c) Mosmarrëveshjet për ndarjen e parcelës dhe për masat e pjesëve takuese zgjidhen nga gjykata. Nëse një nga bashkëposeduesit e ndërtimit të legalizuar është pronar i vetëm i pasurisë ku ndodhet parcela, krijohet bashkëpronësia mbi parcelën ndërtimore, duke u transferuar poseduesve të tjerë pjesët takuese të parcelës. Ndërkohë që për situata e mbivendosjes së titujve nuk pengon procedurat, sipas këtij vendimi.

Mbivendosja në parcelën ndërtimore shuhet me hyrjen në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave që miraton kalimin e së drejtës së pronësisë dhe vlerën e masën e kompensimit financiar. Në këto raste, kompensimi financiar miratohet pa përcaktuar subjektin përfitues të tij, duke pasqyruar faktin e mbivendosjes së titujve në seksionin e veçantë të vendimit të Këshillit të Ministrave. Për zbatimin e kësaj pike, Agjencia e Trajtitimit të Pronës detyrohet të caktojë, në një llogari bankare të posaçme, shumën e miratuar të kompensimit financiar.

500 PERFITUESIT E TAPIVE

AGJENCIA E LEGALIZIMIT DHE INTEGRIMIT TE ZONA/NDERTIMEVE INFORMALE							
LISTA EMERORE E SUBJETEVE QE PREKEN NGA NDERTIMET INFORMALE TE KUALIFIKUARA, MASA DHE VLEREA E SHPERBLIMIT							
Te dhënat e Pasurisë së Legalizuar							
Emër	Aksi	Mbledhje	Leje e legalizimit		Gjendja juridike (pronësia)	Pjesa takuese në parcelë (m ²)	Sipërfaqja për kalim pronësi (m ²)
			Numer	Date			
1	2	3	4	5	6	7	8
TIRANE VERI							
QARKU TIRANE, ZVRRP TIRANE, ZONA KADASTRALE 8170							
MURAT	CEN	BOSHNAKU	69038	05.05.2015			
QARKU TIRANE, ZVRRP TIRANE, ZONA KADASTRALE 8180							
DRIËTAN, DURI	QEMAL	CELA	90380	21.03.2016			
MURAT	SELM	BALLA	79380	10.03.2016			
RAMAZAN	QAMIL	RAMA	79623	30.03.2016			
RAMAZAN	QAMIL	RAMA	79623	30.03.2016			
QARKU TIRANE, ZVRRP TIRANE, ZONA KADASTRALE 8190							
RAMAZAN	ADEMI	LEKA	78375	07.07.2015	E' b' 182656		
QARKU TIRANE, ZVRRP TIRANE, ZONA KADASTRALE 8230							
ISMAIL	HASAN	METAJ	77205	30.05.2015			
TIRANE JUG							
QARKU TIRANE, ZVRRP TIRANE, ZONA KADASTRALE 8260							
SEFER	XHEMAL	HISA	NR. 26215206	30.06.2016	SHTETERORE +TE TRETJEVE		
LUGJ	GLJON	GIJETA	NR. 262139	22.06.2016	TE TRETJEVE		
QARKU TIRANE, ZVRRP TIRANE, ZONA KADASTRALE 3550							
ALEKSANDER	JONLIZ	QORDUA	NR. 262112	20.06.2016	TE TRETJEVE		
QARKU TIRANE, ZVRRP TIRANE, ZONA KADASTRALE 2367							
XHEVDET	RIZA	TRIMI	NR. 262047	30.06.2016	SHTETERORE +TE TRETJEVE		
QARKU TIRANE, ZVRRP TIRANE, ZONA KADASTRALE 8190							
PERPARIM	SINAN	MURATI	NR. 26215176	27.06.2016	TE TRETJEVE		
QARKU TIRANE, ZVRRP TIRANE, ZONA KADASTRALE 3978							
ENVER	HAXHI	BACA	NR. 70300465	06.05.2016	TE TRETJEVE		
QARKU TIRANE, ZVRRP TIRANE, ZONA KADASTRALE 8270							
ARBEN	QAZIM	VAKA	NR. 2621904	06.09.2016	SHTETERORE +TE TRETJEVE		
SAMIR	QAZIM	VAKA					
ASTRIT	QAZIM	VAKA					
QAZIM	QAZIM	VAKA					
DONIKA	HASAN	VAKA					
ALFRED	QAZIM	VAKA					

QARKU TIRANE, ZVRRP TIRANE, ZONA KADASTRALE 1609							
QANI	ABDULLA	DULLA	NR. 262097	16.06.2016	TE TRETJEVE		
ALSHI	ABDULLA	DULLA					
QARKU TIRANE, ZVRRP TIRANE, ZONA KADASTRALE 8230							
PELLUMB	XHELADIN	OSMANI	NR. 26215295	30.06.2016	TE TRETJEVE		
QARKU TIRANE, ZVRRP TIRANE, ZONA KADASTRALE 8230							
REMIS	XHELAL	CULLHAJ	NR. 2624520	28.07.2016	TE TRETJEVE		
QARKU TIRANE, ZVRRP TIRANE, ZONA KADASTRALE 8180							
MURAT	SULEJMAN	BALASHI	NR. 2621503	22.07.2016	BASHKËPRONËSI SHI +SHTETERORE +TE TRETJEVE		
QARKU TIRANE, ZVRRP TIRANE, ZONA KADASTRALE 2953							
KAPLLAN	HAXHI	HIDRI	NR. 70300988	12.10.2015	SHTETERORE +TE TRETJEVE		
QARKU TIRANE, ZVRRP TIRANE, ZONA KADASTRALE 2704							
SKENDER	SELMAN	BERMETA	NR. 70300492	13.01.2016	TE TRETJEVE		
QARKU TIRANE, ZVRRP TIRANE, ZONA KADASTRALE 1604							
NUSRET	MAKSUT	HAFUZI	NR. 2621489	22.07.2016	TE TRETJEVE		
QARKU TIRANE, ZVRRP TIRANE, ZONA KADASTRALE 1609							
AGIM	RAMAZAN	BEQIRI	NR. 2621812	29.07.2016	SHTETERORE +TE TRETJEVE		
QARKU TIRANE, ZVRRP TIRANE, ZONA KADASTRALE 3976							
GEZIM	ABDI	TAKACI	NR. 70301445	21.03.2016	SHTETERORE +TE TRETJEVE		
QARKU TIRANE, ZVRRP TIRANE, ZONA KADASTRALE 3321							
AVDULLA	RIZA	KOLA	NR. 2622339	03.10.2016	TE TRETJEVE		
QARKU TIRANE, ZVRRP TIRANE, ZONA KADASTRALE 1377							
GEZIM	ISA	HOXHA	NR. 70300228	26.04.2016	SHTETERORE +TE TRETJEVE		
QARKU TIRANE, ZVRRP TIRANE, ZONA KADASTRALE 2460							
SHABAN	SALI	HASA	NR. 70300475	06.01.2016	SHTETERORE +TE TRETJEVE		
QARKU TIRANE, ZVRRP TIRANE, ZONA KADASTRALE 3321							
BAKI	BAJRAM	ULLIRI	NR. 2621922	06.09.2016	TE TRETJEVE		
QARKU TIRANE, ZVRRP TIRANE, ZONA KADASTRALE 3866							
DRIËTAN	SABRI	CEKLI	NR. 2621844	30.08.2016	TE TRETJEVE		
QARKU TIRANE, ZVRRP TIRANE, ZONA KADASTRALE 8230							
HYSEN	SHEFOET	BALLA	NR. 2621899	07.09.2016	SHTETERORE +TE TRETJEVE		
QARKU TIRANE, ZVRRP TIRANE, ZONA KADASTRALE 1609							
SHEMSI	HAMDI	KOLA	NR. 8	24.05.2016	SHTETERORE +TE TRETJEVE		
QARKU TIRANE, ZVRRP TIRANE, ZONA KADASTRALE 8260							
NASIBE	SALI	BALA	NR. 2621333	09.07.2016	SHTETERORE +TE TRETJEVE		
QARKU TIRANE, ZVRRP TIRANE, ZONA KADASTRALE 1604							
PETRIT	SINAN	GAPI	NR. 70302079	04.05.2016	SHTETERORE +TE TRETJEVE		
QARKU TIRANE, ZVRRP TIRANE, ZONA KADASTRALE 3976							

BATJAR	ZINI	MERDANAJ	NR. 2622404	12.10.2016	TE TRETJEVE		
HALIT	MUSTAFA	KADILLARI	NR. 2621845	30.08.2016	TE TRETJEVE		
QARKU TIRANE, ZVRRP TIRANE, ZONA KADASTRALE 3866							
ZHANETA	DANIEL	ZEQIRI	NR. 2622382	10.10.2016	TE TRETJEVE		
QARKU TIRANE, ZVRRP TIRANE, ZONA KADASTRALE 8230							
MURAT	MURAT	BARDHI	NR. 2623532	03.02.2017	TE TRETJEVE		
QARKU TIRANE, ZVRRP TIRANE, ZONA KADASTRALE 3321							
GEZIM	AHMET	OSMANI	NR. 2623847	16.03.2017	TE TRETJEVE		
ERJON	AHMET	OSMANI	NR. 2623847	16.03.2017	TE TRETJEVE		
FLORI	AHMET	OSMANI					
QARKU TIRANE, ZVRRP TIRANE, ZONA KADASTRALE 8260							
NAILE	GANI	SULTAFA					
ILIRJAN	SULEJMAN	SULTAFA					
ERMAL	SULEJMAN	SULTAFA	NR. 2621628	26.08.2016	SHTETERORE +TE TRETJEVE		
ERIND	SULEJMAN	SULTAFA					
QARKU TIRANE, ZVRRP TIRANE, ZONA KADASTRALE 3392							
ILIRJAN	EGEREM	MINO	NR. 70302071	03.05.2016	TE TRETJEVE		
QARKU TIRANE, ZVRRP TIRANE, ZONA KADASTRALE 8190							
LUTFI	SULEJMAN	ISMULJA	NR. 2622487	03.11.2016	TE TRETJEVE		
QARKU TIRANE, ZVRRP TIRANE, ZONA KADASTRALE 2105							
RUZHDI	MEKHIT	SULAJ	NR. 2622983	07.06.2016	TE TRETJEVE		
QARKU TIRANE, ZVRRP TIRANE, ZONA KADASTRALE 6260							
MAKSUT	ARTAN	SHEFOET	NR. 2622297	05.10.2016	TE TRETJEVE		
TIRANE 2							
QARKU TIRANE, ZVRRP TIRANE, ZONA KADASTRALE 8330							
MIRANDA	RAMADAN	XHOLI	117263	24.02.2016			
QARKU TIRANE, ZVRRP TIRANE, ZONA KADASTRALE 8340							
ALI	RESHIT	KOKA	117612	08.06.2016			
QARKU TIRANE, ZVRRP TIRANE, ZONA KADASTRALE 8140							
NAZMIE	IMER	MNSAKU	117666	22.06.2016			
SEFER	LIK	BALLA	117369	25.03.2016			
ASTRIT	IBRAHIM	TAFA	117602	07.06.2016			
YLLI	ADEM	SHABAN	117301	09.03.2016			
SUZANA	QAZIM	SHESH					
RAMAZAN	MUSTAFA	DULLA	117302	09.03.2016			
QARKU TIRANE, ZVRRP TIRANE, ZONA KADASTRALE 8180							

GEZIM	DEMO	BAJRAMI	115699	18.05.2015			
QARKU TIRANE, ZVRRP TIRANE, ZONA KADASTRALE 8185							
ZEJNE	AZEM	MICA	118452	04.12.2015			
RUODLF	VASIL	GJORDANI	116284	29.10.2015			
PETRIT	HAMDI	METANI	116283	29.10.2015			
IVAN	SHEFOET	LLOJAJ	116285	29.10.2015			
QARKU TIRANE, ZVRRP TIRANE, ZONA KADASTRALE 8210							
GEZIM	IBRAHIM	TAFAJ					
LUM TURI	TAHIR	ZYKAJ					
PETRIT	SHABAN	MEMA	16132	04.03.2013			
SHERIF	QAZIM	LAÇI					
HIMI	IJET	FRASHERI					
QARKU TIRANE, ZVRRP TIRANE, ZONA KADASTRALE 8255							
ILIR	XHELAL	ÇUFE					
HATIXHE	MAHMUT	HODO	8577	07.02.2012			
DED	MARK	VLADI					
QARKU TIRANE, ZVRRP TIRANE, ZONA KADASTRALE 8265							
XHOVAN	DALIP	DOMI	116998	08.11.2015			
MEHMET		BELA					
LUAN	VELEDIN	XHEMALI	116295	06.11.2015			
GEZIM	SHASHO	LAJTHIA	115705	19.05.2015			
LUBOMIR	PETRO	PESHKATARI	116457	09.02.2017			
STEFAN	RAKO	DIRICI					
QARKU TIRANE, ZVRRP TIRANE, ZONA KADASTRALE 8280							
PELLUMB	TAHIR	SHKURTI	118483	09.02.2017			
SOTIR	MIHAL	PALLOJ	117725	08.07.2016			
QARKU TIRANE, ZVRRP TIRANE, ZONA KADASTRALE 8320							
NDJERAZA	RODRIT	BRANKA	117725	08.07.2016			
MARIKA	ANDREA	BUDRI	117724	08.07.2016			
NEVZAT	NAMIK	GACI	117719	08.07.2016			
QARKU TIRANE, ZVRRP TIRANE, ZONA KADASTRALE 8330							
JONIDA	HYJNI	AGA	14538	02.09.2013			
JONIDA	HYJNI	AGA	14538	02.09.2013			
QARKU TIRANE, ZVRRP TIRANE, ZONA KADASTRALE 8350							
LLAZAR	TUNI	ANDONI	8618	27.01.2012			
QARKU TIRANE, ZVRRP TIRANE, ZONA KADASTRALE 8350							
VIKTOR	HAZIS	PAPA	117318	17.03.2016			
VIKTOR	HAZIS	PAPA					
FADIL	XHEVDET	GJOLEKA	115518	04.03.2015			
SPARTAK	ALAUDIN	IMAMI	116045	29.07.2015			
ARBEN	XHEMAL	FEJZOLLI					
QARKU TIRANE, ZVRRP TIRANE, ZONA KADASTRALE 8210							
SABRI	IDRIZ	XHAJA	5336	22.07.2010			
QARKU TIRANE, ZVRRP TIRANE, ZONA KADASTRALE 8210							

ERVIN	HSMET	MANUSHI	116266	26.10.2015			
GANI	HASAN	HASMUÇA					
ILIR	ZUIA	ÇOKU					
RENATA	ZUIA	ÇOKU	116267	26.10.2015			
LUTFI	SAFET	SINANI	116083	27.08.2015			
ILIRJAN	SOKRAT	PROKO	116084	27.08.2015			
LEGE	JAHE	XHXHA					
AIDA	RIZA	XHXHA	116082	27.08.2015			
ADRIAN	RIZA	XHXHA					
ALBANA	RIZA	KUKA					
NESHET	JASHAR	PAJO					
QARKU TIRANE, ZVRRP TIRANE, ZONA KADASTRALE 8170							
ARTAN	FAHRI	HYKA					
KAMEZ-VORE							
QARKU TIRANE, ZVRRP TIRANE, ZONA KADASTRALE 1649							
IDRIZ	ABDYL	CARA	70201354	18/12/2015	TE TRETËVE (285.3035), SHËTËRORËRE (144.71), PA INFO(47.679)		
ELBASAN							
QARKU ELBASAN, ZVRRP ELBASAN, ZONA KADASTRALE 2124							
DURIM	BEQIR	BUFI	997547	3/9/2015			
QARKU ELBASAN, ZVRRP ELBASAN, ZONA KADASTRALE 8523							
ABAZ	XHEVAHR	HOXHALLARI	53905	27/05/2013			
QARKU ELBASAN, ZVRRP ELBASAN, ZONA KADASTRALE 8526							
JAKUP	ADEM	CANI	5050184	8/9/2016			
ARJAN	HAMIT	TEODORI	13849	28/05/2012			
PERPARIM	SHEFOET	FERHATI	990964	31/12/2014			
QARKU ELBASAN, ZVRRP ELBASAN, ZONA KADASTRALE 8526							
FLAMUR	ZYRI	META	41448	28/03/2013			
AVNI	BAJRAN	ÇELA	991783	6/2/2015			
XHEVAIR	BAJRAN	ÇELA	991743	28/01/2015			
QARKU ELBASAN, ZVRRP ELBASAN, ZONA KADASTRALE 8526							
ARTUR	BESNIK	GUNI	5050185	8/9/2016			
BESNIK	XHEFERR	GUNI	7759266	29/09/2016			
ASAF	BESNIK	GUNI					
SHYQYRI	IBRAHIM	HAKA	995985	27/08/2015			
LAVDIM	RIZA	PEPA	990646	4/12/2014			

DURRES							
QARKU DURRES, ZVRRP DURRES, ZONA KADASTRALE 8512							
ARTEN	SOTIR	JOSIFI	148426	07.05.2015			
QARKU DURRES, ZVRRP DURRES, ZONA KADASTRALE 8515							
ASLLAN	ESAT	KOLAVERI	Nr.99858,	07.05.2013			
QARKU DURRES, ZVRRP DURRES, ZONA KADASTRALE 8516							
ADEMI	QAZIM	BERISHA	Nr.262556	dt.20.03.2017			
QARKU DURRES, ZVRRP DURRES, ZONA KADASTRALE 8517							
PREK	DED	FRANISHTA	Nr.251786	18.05.2016	E të tretëve		
XHELAL	REXHEP	IMERI	Nr.251762	18.05.2016	E të tretëve		
FIQRIE	RAMADAN	YMERI	Nr.251789	18.05.2016	E të tretëve		
BESI	MEHMET	HILAJ	Nr.251628	18.05.2016	E të tretëve		
BEHAR	MEHMET	HILAJ	Nr.251778	18.05.2016	E të tretëve		
MEHMET	RAME	HILAJ	Nr.251787	18.05.2016	E të tretëve		
QARKU DURRES, ZVRRP DURRES, ZONA KADASTRALE 8518							
ROBERT	SHEFOET	SULO	Nr.262747	29.03.2017	E të tretëve		
STEFAN	KOL	VERRIARI	Nr.262745	29.03.2017	E të tretëve		
ISMAIL	GANI	SELIJAJ	Nr.262746	29.03.2017	E të tretëve		
QARKU DURRES, ZVRRP DURRES, ZONA KADASTRALE 8518							
ZAHIDE	DESTAN	SHKINA	Nr.218993	dt. 20.06.2016	E të tretëve		
VLORE							
QARKU VLORE, ZVRRP VLORE, ZONA KADASTRALE 2832							
MUHAREM	HABIB	MERKOHASANI	106169	27.12.2016			
QARKU VLORE, ZVRRP VLORE, ZONA KADASTRALE 8601							
HYSEN	ESAT	CAUSHAJ	101019	12.01.2015			
AVDI	XHELAL	ZHOLI	101144	20.03.2015			
GEZIM	MUHARREM	ÇELA	103256	06.08.2015			
QARKU VLORE, ZVRRP VLORE, ZONA KADASTRALE 8605							
PETRIT	RESUL	QELJANI	104162	09.05.2016			
FERRIK	CIZE	CANAJ	103199	27.07.2016			
SELAUDIN	HAKIM	METAJ	105324	15.09.2016			
VJOLLCA	SERVET	METAJ					
NAMDI	TRAKO	TUSHI	105007	16.08.2016			
GENCI	PAJTIM	LALAJ	104484	20.06.2016			
LELI	XHAFFER	JAUPAJ	105500	09.12.2016			
AGIM	HAXHI	SHEHU	106088	09.12.2016			
MANOLI	KALAM	NAKUÇI	104568	27.06.2016			
AGIM	HAXHI	SHEHU	106823	20.02.2017			
MERQES	MANUR	ALIMUÇAJ	106391	06.03.2017			
QARKU SHKODER, ZVRRP SHKODER, ZONA KADASTRALE 8591							
XHEMAL	ZEK	HYKAJ					
AVDYL	ZEK	HYKAJ					

638 PRONARET QE MARRIN KOMPENSIMIN

Nr. i Pronarëve që marrin kompensim	Komponentë i Pronarëve							Shuma - Vlera e kompenimit (qk)
	Emër	Adresë	Mbledhje	Nr. i pasurisë	Nr. i pasurisë	Masa e kompenimit (qk)	Cmimi (lektor)	
9	10	11	12	13	14	15	16	17
1	AGIM		KOKONDOZ					
2	ALDO		KOKONDOZ					
3	ANELA		KOLNISA					
4	ANELA		MIREPEÇA					
5	ARTAN		DERVISHI					
6	BAHRI		KOKONDOZ					
7	BESNIK		KOKONDOZ					
8	DOKRETE		KOÇKA					
9	EDUART		HOTI					
10	FATMIR		KOKONDOZ					
11	GENC		MANÇIA					
12	HALL		KOKONDOZ	1	3264	374,00	32,878	12,296,372.00
13	HARKE		MATJA					
14	HYSEN		KOKONDOZ					
15	INA		KOKONDOZ					
16	JAKUP		NAKHARU					
17	MAMOZA		KOKONDOZ					
18	NABME		SHUKU					
19	NAZMI		MANÇIA					
20	PRANVER		KOKONDOZ					
21	SAMI		KOKONDOZ					

22	VILMA		KOKONDOZ					
23	ZEDINE		KOKONDOZ					
24	ADRIAN	NAKHARU	NAKHARU					
25	AGIM	SELM	KOKONDOZ					
26	ANLA		MANÇIA					
27	ANLA		NAKHARU					
28	ARTAN		DERVISHI					
29	BAHRI	SELM	KOKONDOZ					
30	BARDHYL	SELM	KOKONDOZ					
31	EDUART		HOTI					
32	FATMIR		KOKONDOZ					
33	FIGURETE		KOKONDOZ (DOKNA)					
34	GENC		MANÇIA					
35	HALL		KOKONDOZ					
36	HARKE		KOKONDOZ (MATJA)					
37	HYSEN	SELM	KOKONDOZ					
38	JAKUP	NAKHARU	NAKHARU					
39	MAMUT	SELM	KOKONDOZ					
40	NABME		KOKONDOZ (SHUKU)					
41	PRANVERA	SELM	KOKONDOZ					
42	SAMI	SELM	KOKONDOZ					
43	ZEDINE	SHABAN	KOKONDOZ					
44	ADRIAN	NAKHARU	NAKHARU					
45	AGIM	SELM	KOKONDOZ					
46	ANLA		MANÇIA					
47	ANLA		NAKHARU					
48	ARTAN		DERVISHI					
49	BAHRI	SELM	KOKONDOZ					
50	BARDHYL	SELM	KOKONDOZ					
51	EDUART		HOTI					
52	FATMIR		KOKONDOZ					
53	FIGURETE		KOKONDOZ (DOKNA)					
54	GENC		MANÇIA					
55	HALL		KOKONDOZ					
56	HARKE		KOKONDOZ (MATJA)					
57	HYSEN	SELM	KOKONDOZ					
58	JAKUP		NAKHARU					

18- SPECIALE

E premtë 8 Dhjetor 2017

GAZETA SHQIPTARE

90	ADELINA	SILAJ (BRARI)	14	8275	15.00	66,969	1,004,036.00	
91	ATLJE	BRARI						
92	BEQIR	BRARI						
93	DYHUE	BRARI						
94	EMINE	BRARI						
95	FLUTURA	BRARI						
96	HAMIT	BRARI						
97	HAKHA	BRARI						
98	KORZ	BRARI						
99	KIMETE	BRARI						
100	KLUTIM	BRARI						
101	LAJE	BRARI						
102	LULJETA	BRARI	15	845	91.90	66,969	6,154,451.10	
103	MEXHAT	BRARI						
104	NEZIR	BRARI						
105	QAZIM	BRARI						
106	REXHEP	BRARI						
107	SHIBAN	BRARI						
108	SULLTANE	BRARI						
109	VATH	BRARI						
110	XHEJE	BRARI						
111	YMER	BRARI						
112	ZENE	BRARI						
113	EMVER	BRARI						
114	SHOQERIA BRARI P.B. sh.p.k		16	8865	7.60	66,969	508,964.40	
115	MURUE	ABAZAJ (XHURAJ)						
116	ISMAIL	ABAZAJ						
117	RIZDHI	ABAZAJ						
118	NAME	ABAZAJ						
119	HAKI	ABAZAJ						
120	LATIF	ABAZAJ						
121	DYLERE	ABAZAJ (SEFERI)						
122	SAT	KOSTA (ABAZAJ)						
123	BEHM	ABDULLA PICALLI	18	33316	339.00	2,560	867,840.00	
124	RESHAT	HAKI	ZIKA	19	2888	368.40	23,703	8,495,155.20
125	YLLI	MUHAMMEDI	FERVATI					
126	ALEXANDER	MACI						
127	GIORGIA	DALL OLMO MACI						
128	KLUTIM	MACI						
129	MUSA	MACI						
130	ROBERTO	MACI						
131	TOMORR	MACI						
132	FIQIR	MUHAMMEDI	DERVISH	21	5218	162.50	878	142,675.00
133	HAKHA	FADIL	GJONI	22	28078	247.40	3,283	812,214.20
134	HAKHA	FADIL	GJONI	23	28079	87.60	3,283	287,590.80
135	HAKHA	IBRAHIM	SHKALLA	24	51280	271.00	5,140	1,392,360.00
136	SAMI	ABAZ	FUSHA	25	2549	77.90	2,560	199,424.00
137	FESTIM	BANISH	IBRAHIM	26	5815	83.30	479	33,900.70
138	ZENEL	BAJRAM	DERVISH	27	43621	331.00	2,560	847,360.00
139	MER	ZENEL	HOVHA	28	6133	212.20	230	48,808.00
140	AGIM	AGIF	META	29	61409	46.10	230	9,223.00
141	KLUTIM	DOH	OSKALI	30	61416	31.00	230	7,130.00
142	LIJAN	ALLAMAN	CELA	31	55081	300.10	2,080	624,288.00
143	VILFRID	ZAVALLAN						
144	ALBAN	XHELLARI						
145	SUZANA	NOZHA						
146	FOHRET	ISMALATI						
147	LIR	HIDI						
148	ISMET	KRIVEZIU						
149	EVA	SHEKULLA						
150	SKENDERI	ISMALATI						
151	NEHAT	ISMALATI						
152	YALBONA	ISMALATI						
153	ELVIS	ISMALATI	32	43611	417.00	2,560	1,087,520.00	
154	SYRJA	BESHIRI						
155	ARSEN	BESHIRI						
156	ELIDA	BESHIRI						
157	EDLIRA	BESHIRI						
158	CEZAR	BESHIRI						
159	PETRI	BESHIRI						
160	BESHA	BESHIRI						
161	DIANA	BESHIRI						
162	AIDA	AGIM	TUGU					
163	ANASTAS	GJORDICA						
164	JARDIAN	ISUF	MACI					
165	EDA	ISUF	MACI					
166	EGJEREM	QAZIM	TUGU					
167	ISLAM	QAZIM	TUGU					
168	MIRAND	AGIM	FUGU					
169	NAZIR	QAZIM	TUGU					
170	AIDA	TUGU						
171	ANASTAS	GJORDICA						
172	EGJEREM	TUGU						
173	ISLAM	TUGU						
174	EDA	MACI						
175	JARDIAN	MACI						
176	MIRAND	FUGU						
177	NAZIR	TUGU						

178	VEBI	MUSTAFA	FLAKU	35	33011	37.50	2,560	96,000.00
179	AIDA	AGIM	FUGU					
180	KBALF	MURAT	QOSJA					
181	MIRAND	AGIM	FUGU	36	6887	162.60	30,783	5,005,315.80
182	SHPRESA	SHIBAN	QOSJA					
183	YMER	MURAT	QOSJA					
184	SEMHA	GARA						
185	SHKOLLE	QEFALJA						
186	VUOLCA	LIRA						
187	LILIANA	ALLA						
188	MERLIN	FAGU						
189	ARTED	META						
190	MAHMUDE	FARKO						
191	RAMAZAN	QOSJA						
192	QAZMEND	QOSJA						
193	MRELA	REKA						
194	IRMA	TAFAJ						
195	ESMA	ÇALI						
196	MIMOZA	KADRIU						
197	RAMONDA	RESNJA						
198	HIVA	RADESH						
199	RUKJE	RADESH						
200	ARDIT	RADESH						
201	NEVILA	ÇELIKU						
202	MAHMUDE	VEHETI						
203	HAKI	RADESH						
204	LILIANA	RADESH						
205	ENKELEIDA	RADESH						
206	NRIVANA	RADESH						
207	ELTON	RADESH						
208	ERJON	RADESH						
209	FATJON	RADESH						
210	ARSEN	RADESH						
211	HYJN	RADESH						
212	SEMHA	RADESH						
213	ALMA	PINA						
214	ORNELA	HUTA						
215	AFERDITA	BERLIRU						
216	EDI	DAJA						
217	FATOS	DAJA						
218	SANJE	KULESHA						
219	MAKELLE	DOKU						
220	MALINDA	JUSUPI						
221	FATMIRA	LINDRA						
222	LRUK	LINDRA						
223	SUZANA	FERRA (LINDRA)						
224	ARJAN	RADESH						
225	EVA	BEJRI	CEREPI					
226	ELINDA	BEJRI	BUDA					
227	SHKOLLE	HAMID	QEFALJA					
228	VUOLCA	LIRA						
229	LILIANA	ALLA						
230	LEJAN	ASTRI	DNIPA	39	5925	40.70	5,140	224,638.00
231	RIZDHI	SHEHU						
232	BASHAM	SEFER	ALLMICA	40	26829	251.70	479	120,564.30
233	NATASHA	HAMIT	SHAKLLARI	41	25811	54.30	479	26,009.70
234	JUSUF	KASEM	SPANA	42	9715	34.40	479	16,477.60
235	IBRAHIM	KASEM	SPANA	44	9727	62.60	479	28,585.40
236	TAP	XHEVDO	KOCI	45	31227	219.00	4,242	928,998.00
237	AIDA	TUGU						
238	ANASTAS	GJORDICA						
239	EGJEREM	TUGU						
240	ISLAM	TUGU						
241	EDA	MACI						
242	ARJAN	MACI						
243	MIRAND	FUGU						
244	NAZIR	TUGU						
245	ARSEN	ÇULLHU						
246	ASTRI	ÇULLHU						
247	BARDOHA	ÇULLHU						
248	EMNE	BHMA						
249	FATME	ÇULLHU						
250	FLUTURA	KANXHA						
251	GEZM	ÇULLHU						
252	HERMA	ÇULLHU						
253	IBRAHIM	ÇULLHU						
254	IDRIZ	ÇULLHU						
255	KLUTIM	ÇULLHU						
256	LUFTI	ÇULLHU						
257	MANE	ÇULLHU						
258	MIMOZA	ÇULLHU						
259	MIRELA	ÇULLHU						
260	ORTAN	BASHAM	NOCI	49	43917	417.00	2,560	1,087,520.00
261	AIDA	AGIM	FUGU					
262	KBALF	MURAT	QOSJA					
263	IRMA	AGIM	FUGU	50	6887	341.00	30,783	10,467,003.00
264	SHPRESA	SHIBAN	QOSJA					
265	YMER	MURAT	QOSJA					
266	KLME	BALI						

267	ZYLFIJE	ABDI	DINGU					
268	ABDULLA	HYKA						
269	LULZIM	ZALTA						
270	FATMIRA	KALLUSH (HYKA)						
271	VUOLCA	XHEK	TAKE (META)					
272	NAME	MEMKO (META)						
273	SEFER	HYKA						
274	FABRIE	HASANAJ (META)						
275	SUZANA	SALI	HYKA					
276	FATBARDH	META						
277	ARSEN	MALOKU						
278	HAKH	HYKA						
279	TATJANA	MUSA						
280	KADRI	XHEK	META					
281	FATMIRA	SALI	KALLUSH (HYKA)					
282	SUZANA	SALI	HYKA					
283	VUOLCA	XHEK	TAKE (META)					
284	KADRI	XHEK	META					
285	NAME	MEMKO (META)						
286	FABRIE	HASANAJ (META)						
287	TATJANA	MUSA (META)						
288	FATBARDH	META						
289	ABDULLA	HYKA						
290	ARSEN	MALOKU						
291	HAKH	HYKA						
292	LULZIM	ZALTA						
293	SEFER	HYKA						
294	ZYLFIJE	ABDI	DINGU					
295	RESHAT	ABDULLA	KORHA	54	731	302.00	4,242	1,692,264.00
296	AGRON	BOGDAN						
297	ATLJE	YLLI						
298	DANA	BIBA						
299	EMINE	BOGDAN						
300	FATMIR	BOGDAN						
301	RAMAZAN	BOGDAN						
302	RESHAT	BOGDAN						
303	SAMIR	BIBA						
304	BLAL	BOGDAN						
305	BARDHYL	LLESH						
306	EGJEREM	BALLVORA						
307	FATMIRA	BALLVORA						
308	IBRAHIM	BALLVORA						

415	MAHMEDE		KADU						
416	MEDHA		KADU						
417	MIRVJEN		KADU						
418	MYNIR		KADU						
419	NEZHAT		KADU						
420	RAMAZAN		KADU						
421	SEMILE		MELLAJ						
422	SHRREDA		SEBOSHAM						
423	ALI		KARROQI						
424	BASHKIM		KARROQI						
425	DASHAMIR		ORZA						
426	DAN		KARROQI						
427	HYSEN	60	KARROQI	6238	80.50	31.270	2.517.235.00		
428	IKOLJE		NEROQI						
429	SHEFKI		NEROQI						
431	AGIM		XHEPA						
432	ASTRIT		XHEPA						
433	BESHK		KAZAZI						
434	BILJAR		XHEPA						
435	DMURATA		MELESKA						
436	ENDRI		XHEPA						
437	ENI		XHEPA						
438	ESAT		XHEPA						
439	FATBAROHA		SPARHU						
440	FATME		NALLBANI						
441	FATMI		KAZAZI						
442	FORI		XHEPA						
443	FITNETE		SALLIU						
444	FLUTURA		HODHA (KAZAZI)						
445	GEZM		DALPI						
446	HASAN		KAZAZI						
447	LEILA	61	BOGDAN (KAZAZI)	6281	5.58	38.814	215.486.12		
448	LMATURJE		DALPI						
449	MAULINDA		XHEPA						
450	MYZEJEN		KUJI (DALPI)						
451	NUME		BILUSHI						
452	PETRIT		DALPI						
453	REKHEP		ABAZI						
454	SAOIK		XHEPA						
455	SEMHA		KAZAZI						
456	SHPETIM		ABAZI						
457	SHRREDA		DUDUJH						
458	SHKENDER		DALPI						
459	VJOLLCA		KODRA (DALPI)						
460	YLLI		ABAZI						
461	LMATURJE	SELMAN	ISAKAJ	62	5884	3.58	30.763	109.587.48	
462	SABRIJE	SABIT	ISAKAJ						
463	LILZM	QAZIM	KIKA						
464	HALL	QAZIM	KIKA						
465	AFERDITA	QAZIM	KIKA						
466	VJOLLCA	QAZIM	VORPSI						
467	LIBI	QAZIM	KIKA						
468	FLUTURA	QAZIM	VERZIVOLLI						
469	NAZIRE	SHABAN	KIKA						
470	SONDOL	MUHARREM	KIKA	63	4831	24.40	30.763	751.105.29	
471	ARJETA	MUHARREM	PLEBHTI						
472	HATUJSE	SHABAN	KIKA						
473	KLITIM	ALI	KIKA						
474	BARDHIL	ALI	KIKA						
475	AVENIR	ALI	KIKA						
476	SADETE	SHABAN	KIKA						
477	AFERDITA	QAZIM	KIKA						
478	ARJETA	MUHARREM	PLEBHTI						
479	AVENIR	ALI	KIKA						
480	BARDHIL	ALI	KIKA						
481	FLUTURA	QAZIM	VERZIVOLLI						
482	HALL	QAZIM	KIKA						
483	HATUJSE	SHABAN	KIKA	64	4866	22.50	30.763	692.817.50	
484	KLITIM	ALI	KIKA						
485	LIBI	QAZIM	KIKA						
486	LILZM	QAZIM	KIKA						
487	NAZIRE	SHABAN	KIKA						
488	SADETE	SHABAN	KIKA						
489	SONDOL	MUHARREM	KIKA						
490	VJOLLCA	QAZIM	VORPSI						
491		MBIVENDOSJE		65	9779	177.00	34.068	6.030.026.00	
492	ARSEN		DONA						
493	VRSHI		DONA						
494	IBRAHIM		DONA						
495	ILIR		HAKRU	66	9780	123.00	34.068	4.190.364.00	
496	MIRELA		DONNA (ALIMHMETI)						
497	GEREME		DONA						
498	SHPETIM		HAKRU						
499	XHAVIT		HAKRU						
500	EDURA		ROQI	67	1305	71.97	66.969	4.819.758.93	

501	EDURA		ROQI	68	1305	13.83	66.969	506.181.27	
502	AFERDITA		HISHO						
503	AGIM		FORTUD						
504	ALMA		HYKA						
505	ARBEN		FORTUD						
506	ASTRIT		FORTUD						
507	AVNI		FORTUD						
508	BEKDI		FORTUD						
509	BLEDAR		FORTUD						
510	BILJAR		FORTUD						
511	DASHARJE		LLAGAMI						
512	DENIS		LLAGAMI						
513	DMURATA		KARAJANI						
514	DONALD	LUTFI	STRAZIMIRI						
515	ELENA		SHEHAJ (FORTUD)	69	5061	7.50	38.614	289.605.00	
516	FATBAROHA		AGUSHI						
517	FENIK		FORTUD						
518	FENIK		PREZA						
519	HELDON		LLAGAMI						
520	HERIT		STRAZIMIRI						
521	JALDIZ		STRAZIMIRI						
522	LIBI		FORTUD						
523	LIJAN		FORTUD						
524	LIJANIE		FORTUD						
525	MIRANDA		FORTUD						
526	SUDANA		HAVERI						
527	VERA		LLAGAMI						
528	ZANA		ZOTO (FORTUD)						
529	AKUR		KURTI						
530	AGIM		GAJDI						
531	ARDIANA		GAJDI						
532	AZEM		SEDAJ						
533	BEQR		SEDAJ						
534	ERVIS		SINELLA						
535	FATBAROHA		ALLAJBEU						
536	FATME		BISHQEMI						
537	FITNETE		SEDAJ						
538	HAMDI		ALLAJBEU						
539	HENJA		KULLOLLI						
540	HENJEA		SEDAJ						
541	HYGOMET		SHYTI						
542	ILIR		GAJDI						
543	ISUF		GAJDI						
544	KADRI		ALLAJBEU						
545	LIRJEA		ALLAJBEU						
546	MIRELA		ISUFI						
547	MUHAMMED		ALLAJBEU						
548	MUHAMREM		SEDAJ						
549	NAJYJE		SINELLA						
550	NETRISTE		BISHQEMI						
551	PETRIT		SHYTI						
552	RABWANE		MILKA						
553	RAMAZAN		SEDAJ						
554	REMIJE		HASHNI						
555	ROVENA		SINELLA						
556	ADAMKURTI		MYSLIMAN SHQIPTAR	71	142	83.85	32.878	3.073.024.70	
559	ALBERT		BANESH	72	8582	132.86	334	42.977.40	
560	ILMUJE		RAMADAN						
561	BRUNDA		IBRAHIM						
562	ZHENJELA		IBRAHIM						
563	AVONELA		IBRAHIM	73	8598	152.75	334	49.491.10	
564	DENSA		IBRAHIM						
565	ENKELIDA		IBRAHIM						
566	MEFAL		REXH	74	8723	323.50	221	71.483.50	
567	FLUTURA		BEDHJA						
568	ALEMSPH		BEDHJA						
569	BARDHOJNE		BEDHJA						
570	EDUJAT		BEDHJA	75	20206	131.10	12.764	1.873.380.40	
571	FATMIR		BEDHJA						
572	LIJAN		BEDHJA						
573	BEKJIE		BEDHJA						
574	ARSEN	REBLL	EDRIZI	76	7119	440.70	12.764	5.861.296.40	
575	THANAS	ARIF	MILA						
576	ROZETA	NEIM	DOGDOFTI						
577	BRUNDA		DOGDOFTI						
578	BARJON	THANAS	MILA	77	44212	325.10	12.764	4.149.576.40	
579	BERTOL	THANAS	MILA						
580	FEJZULLAH	ARIF	DOGDOFTI						
581	OLSHI	QAZIM	DAUTI						
582	ARI	HYGOMET	GJIKAJ						
583	JORDO	HYGOMET	GJIKAJ						
584	SERVET	HYGOMET	DAUTI	78	44218	356.80	12.764	4.551.842.40	
585	AJET	HYGOMET	DAUTI						
586	MIRVET	HYGOMET	DAUTOGJIKAJ						
587	EMINE	HYGOMET	MUSTA						
588	YIJE	HYGOMET	LACI						

619	AGRON	HYSEN	TATA						
620	BUJAR	HYSEN	TATA						
621	SABRIJE	HYSEN	TATA	79	794	1.036.50	12.764	13.217.122.00	
622	MEMETALI	HYSEN	TATA						
623	FLUTURA	HYSEN	TATA						
624	BUKUROJNE	ALI	ODSIA						
625	FERDINAND	ALI	HUSHI						
626	MYRTEZA	NEBI	SHYRA						
627	SHAFIJE	NEBI	SHYRA						
628	ALI	ISMAL	SHYRA						
629	NEBI	ISMAL	SHYRA						
630	DANIE	ISMAL	SHYRA						
631	LIRI	ISMAL	SHYRA	80	217477	999.70	12.764	12.760.170.80	
632	FAK	ISMAL	SHYRA						
633	ORTA	ISMAL	SHYRA						
634	ZENEPE	ISMAL	SHYRA						
635	ARTA	ALI	SHAJA						
636	MERITA	ALI	HUSHI						
637	FRANZVERA	ALI	HUSHI						
638	DURIM	KLITIM	MATSHI	81	31233	798.50	12.764	10.084.414.00	
639	SULEA	XHEMAL	MATSHI						
640	TRASHKEMTARET E FAM MAMA	NEJ		82	19225	274.00	19.155	5.248.470.00	
641	HALL	IBRAHIM	KURTBALAJ	83	5330	301.00	11.780	3.545.780.00	
642	HALL	IBRAHIM	KURTBALAJ	84	5788	13.00	11.780	153.140.00	
643	ETEM	VEBI	KORBI	85	5922	12.00	11.780	141.980.00	

Opinion i Ditës

Nga Pëllumb Karameta

(vijon nga faqja 1)

Dija në “epokën google” dhe rinia



...procesin e nxënies dhe provimet. Kërkime nga qendra me ndikim në reformat arsimore provojnë se, sapo të bëjmë tonën zhvendosjen nga kuptimi i dijes si tregues i “mendjes së edukuar”, drejt dijes si mjet për të stërvitur një seri zakonësh mendore që i përputhen mendësisë së fuqishme për nxënie dhe veprim, një pamje e re e mundësive do të hapet përpara nesh. Për të nxitur diskutimin, po hedhim një vështrim mbi natyrën e kësaj zhvendosjeje.

Rreth 4000 vjet më parë, në Kinë dhe në Lindjen e Mesme, për fëmijët filloi të zhvillohet një model arsimi që i trajnonte ata për klerikë. Këta të fundit ishin persona që siguronin kontaktin mes zotit dhe njerëzve. Gjatë mësimeve, fëmijëve u ofrohej e Vërteta e Zotit dhe mësonin si të bartej kjo e vërtetë të popullsisë. Ky model mësim-nxënies, bazuar mbi autoritetin e padiskutuar të disave, është përsëritur përgjatë rrjedhës së shekujve. Tutorët dhe profesorët e universiteteve mesjetare, p.sh., përshatën një version më pak fetar të rasave dhe të kapuçave të murgjeve, të njëjtën hierarki të statusit si dhe të njëjtën pamje autoritare. Dija shihej si e Vërteta e Përrjetshme, mësimdhënia si transmetimi i qartë i saj dhe nxënia ruajtja e saktë në kujtesë.

Në Mesjetë, dijet në klasa, në universitete apo seminare ndaheshin në disiplina të shkëputura – gjeometri, aritmetikë, gramatikë etj. Mësues të akredituar i zhvillonin këto dije, i përhapnin, vlerësonin përvetësimin e tyre dhe gjykounin për atë që do duhej “llogaritur” si dije. Në shkollat e para publike në botë, në shek. XIX, të rinjve u mësohej leximi, shkrimi, njehsimi dhe disa dije që duhej t’i dinte çdo “njeri i arsimuar” (ose të paktën të familjarizohet me to). Megenese këto dije shiheshin si të besueshme, të përhershme dhe të dobishme, nuk ishte detyra e askujt të pyeste se nga erdhën, si u ndërtuan, kush i bëri apo nëse kishin alternativa, nëse qenë të pjesshme apo mund të përmirësoheshin në një farë mase. Kjo nuk ishte puna e mësuesit, sigurisht, as dhe e nxënësve. Në këtë model organizim të mësim, qëllimi nuk ishte të mendohej për atë që po bënin, ose të zhvillonin ndonjë aftësi apo kuptim të veçantë; qëllimi ishte të vihejshin në punë dhe ta përfundonin atë në mënyrë të kënaqshme. Nuk ishte punë e mësuesit të ndihmonte nxënësit si të mendonin apo si të nxënin; ai caktonte detyrat dhe menaxhonte procesin, që puna të ecte si duhet dhe patrazuar. Sepse dija shihej si diçka që kishte kaluar nëpërmjet “Autoritetit të pagjyqësueshëm” ose ishte nxjerrë dhe pastruar një herë e njëri kohë ashtu si ari/floriri, nga burra (kruesisht) të cilët ishin shumë më të mençur se mësuesit dhe nxënësit, zakonisht në vende që quheshin universitete. Këtë status “standard ari” e fituan, gjithashtu, edhe disa thesare të tjerë kulturore si veprat e Shekspirit, Beethovenit etj.

Mirëpo, ne të gjithë e dimë që dija nuk është si realiteti: ajo është gjithmonë e diskutueshme dhe e paplotë. Fizikani i madh danez N. Bor (N. Bohr), fitues i çmimit “Nobel” në vitin 1922, ofroi për strukturën e atomit modelin “e mini sistemit diellor”. Kjo dije, për shumë vite, iu paraqit studentëve të fizikës sikur të ishte e vërteta. Por në autobiografinë e tij, miku dhe kolegu i Bor-it, W. Hajzenberg (W. Heisenberg) – edhe ai nobelist – ka treguar në kujtimet e tij se Bor i asnjëherë nuk kishte besuar se ato gjërat e vockla, që i quanin elektrone, rrotulloheshin rreth një grumbulli thërmijash të tjera, që

quheshin neutrone dhe protone. Modeli i tij ishte imazhi / mjeti grafik që ai ndërtoi për t’u dhënë kolegëve të tij një ide të përafërt se si ekuacionet matematike shërbenin për të shpjeguar ato që ai kishte vëzhguar. Hajzenberg-u thotë: “Bori ka formuar një pikturë intuitive të atomeve të ndryshëm: një pikturë që të mund ta mbaronte te fizikanët e tjerë me ndihmën e njetëve të tilla të papërshtatshme si orbitat e elektroneve dhe gjendjet e kuantit. Nuk është aspak e sigurt se vetë Bori besonte se elektronet rrotulloheshin brenda atomit”. Më pas, sigurisht, shumë njerëz të tjerë patën sukses dhe

argumentuan bashkë me Borin si dhe përfytyruan ide të reja, që mund t’i shpjegonin edhe më mirë vëzhgimet për kuarket dhe superthërmijat. Të urtit, përpara të cilëve njerëzimi përulet me respekt, e kuptojnë dijen jo si qëllim më vete, por si burim për të bërë gjëra që ia vlejnë si, p.sh., të bindnin njerëzit të mendonin me kokën e tyre. Urtësia e tyre është rrymë ndërhyrjesh dhe provokimesh, sipas personit dhe problemit, sipas situatës dhe rastit; urtësia e tyre nuk sugjeron të Vërtetën e Përrjetshme.

Kjo, pra, është dija. Po të mos jemi në botën e provave dhe të deduksioneve matematike, atëherë gjithçka është e përkohshme dhe e rivlerësueshme. Dija është shpikur nga njerëzit për të shpjeguar gjërat e mistershme dhe për të ndihmuar të bëhen gjëra. Dija historike na ndihmon të mos përsëritim gabimet e së shkuarës. Dija gramatikore ekziston për të ndihmuar njerëzit të komunikuar më mirë – të paktën kjo është teoria. Nëse dija funksionon, shumë mirë. Nëse ajo nuk funksionon, atëherë duhet të kërkojmë diçka më të mirë. Për ta thënë më ndryshe, në “epokën google”,

shumë më tepër se më parë, dija është relative; tani e më tej, dija është ajo “çfarë funksionon”. Dije nuk është ajo që është e vërtetë, por është ajo që ndihmon; ajo që përdorim për t’i bërë gjërat të funksionojnë. Ajo lidhet me situatën dhe rastin. Prandaj, na duhet të rinj që janë të gatshëm dhe të aftë të kritikojnë, të harmonizojnë, të përpunojnë, të sfidojnë dhe të vazhdojnë së punuari me dijet që kanë sukses. Ata duhet ta shohin veten më pak si individë që luten të drujtur në altarin e dijes dhe më shumë si kritikë dhe krijues me besim në veten e tyre. Dhe ata duhet t’i aftësojmë ta bëjnë mirë këtë gjë. Në ekonominë e sotme të dijes, për njerëzit është normë të bashkohen dhe të ndërtojnë dijen që u duhet menjëherë, në kontekstin e problemit plotësisht të pangjashëm me diçka tjetër, të ndërlikuar dhe specifike që po gjurmohen. Ajo që vlen është të jesh i aftë të nxësh dhe të përdorësh dije, jo të kesh një magazinë të pafundme dijesh të përgjithshme për t’i përdorur sipas rastit. Sot, këtë e bën shumë më mirë dhe më lehtë Google.

Për më tepër, sot, duke i trajnuar të rinjtë ta mendojnë dijen si të pandryshuar, i bëjmë ata më pak të zgjuar. Në një eksperiment të para disa viteve, psikologu Ch. Stathopoulos and S. Vosniadou kërkuan të kuptonin nëse qëndrimet që mbanin nxënësit 15 vjeçarë ndaj dijes, ndikoheshin nga mënyra si i mësonin ligjet e lëvizjes së Njutonit. Diçka i befason; ato gjetën se nxënësit, të cilët e kuptonin dijen si konstrukcion njerëzor të përkohshëm në pritje për t’u zëvendësuar, vazhdimisht të hapur ndaj pyetjeve dhe ndryshimit, treguan një kuptim më të thellë dhe më të saktë të ligjeve të Njutonit, krahasuar me shokët e tyre të cilët besonin se shkenca është e Vërteta e Përrjetshme. Kërkueset, pa emocion, arritën në përfundimin se “nëse jemi të interesuar të projektojmë mjedisë nxënies të dobishme, është e rëndësishme të zhvillohen kurrikula dhe mësimet të hartuara qartësisht, që të ndihmojnë përsosjen e aftësive njohëse dhe zbatuese”. Sa kaq, duke trajnuar të rinjtë ta mendojnë dijen si të pandryshuar, i bëjmë kur ata kanë të bëjnë me diçka të respektuar si Ligjet e Njutonit.

Atëherë, nëse dija e dobishme është ndërtim njerëzor i përkohshëm, përse përpiqemi t’i bindim të rinjtë të besojnë të kundërtën? Përse po vazhdojmë të veprojmë sikur studimi i dijes si qëllim më vete – sipas një mënyre që nuk ngjall interes, por frikë dhe respekt – është një gjë interesante për t’u bërë, pa ndërë aspak nevojën të shpjegojmë se çfarë mund të bëhet me këtë studim (përveç se të kalohen provimet)? Përse vazhdojmë t’u mësojnë të rinjtë, të themi, kohët e foljes, kryqarët apo algoritmet teorike pa fund, thua se ata po diplomohen në një botë ku dija bëhet dhe jo në një botë ku dija zbatohet? A nuk do vlen të bëhen shumë, nëse i argëtojmë djemtë dhe vajzat tona, duke u treguar të gjitha shkathtësitë, dyshimet, bisedat dhe kontradiktat që janë materialit përberës i dijes – dhe t’i ndihmojmë ata t’i përvetësojnë më mirë mënyrat sipas të cilave ndërtohet dija?

Tiranë, më 06/12/2017

Rreth 4000 vjet më parë, në Kinë dhe në Lindjen e Mesme, për fëmijët filloi të zhvillohet një model arsimi që i trajnonte ata për klerikë. Këta të fundit ishin persona që siguronin kontaktin mes zotit dhe njerëzve. Gjatë mësimeve, fëmijëve u ofrohej e Vërteta e Zotit dhe mësonin si të bartej kjo e vërtetë të popullsisë. Ky model mësim-nxënies, bazuar mbi autoritetin e padiskutuar të disave, është përsëritur përgjatë rrjedhës së shekujve.

Opinioni *i* Ditës

A ka evoluar konflikti midis brezave në Shqipëri?

NGA ROVENA HOXHA

(vijon nga faqja 1)


... që disa vlera, "risi" të momentit trend, të mbysin e hedhin baltë mbi dhjetëra të tjera, që mbajnë gjallë për një dekadë qindra e mijëra njerëz më të vjetër (sot pensionistë), ndonëse ata jetonin nën një sistem diktatorial. Pavarësisht nga mungesa e lirisë dhe të drejtave të plota të individit, në ato vite trashëgoreshin vërtyte të çmuara njerëzore, si singjeriteti, altruizmi, morali i lartë i familjes, humanizmi, mirënjohja (pa u konvertuar ajo në shpërblim material apo monetar), korrektesia dhe dashuria për punën, edukata në familje e shoqëri, shoqëria me emocionet dhe ngjyrat e moshës multiaktive etj. Fatkeqësisht, sot gjen rrallë e më e rrallë ndonjërin prej tyre, sepse tashmë janë demodë dhe të pavlera për t'i rezistuar kohës "moderne që po gëzojnë rinia sot.

Rinia, - e ardhmja apo "viktima" e tranzicionit absurd shqiptar ??? Motoja e tyre: të duken ekstremisht bukur, dhe qëllimi i tyre: të gjejnë parën me çdo mjet e mënyrë të mundshme. Sipas vazave sot, vlera e madhe është ashpër performanca fizike.

Dëshira e madhe e tyre për t'u dukur të ashtuquajtura femra moderne, i kthen ato në skllave të një shëmtimi si shpirtëror ashtu edhe fizik. Plastikë nga jashtë dhe plastike brenda, ato nuk preferojnë më djalin inteligjent dhe punëtor, por mashkullin që duket i fortë e i pushtetshëm me parat dhe makinën e babit. Por, sigurisht që ato harrojnë, se njeriu ka një staturë të vetën dhe e krijon atë në mënyrë individuale origjinale, me qëllim që me ose pa dashje, veshjen dhe sjelljen e vet të mos e kthejnë në diçka kolektive.

Dhe, me këtë stil jetese apo mbijetese mirë të themi, ato kthejnë në kolektive dhe ndjenjat e tyre. Thjesht jetojnë për të jetër! Sepse, sot nuk konsiderohesh më vajzë apo djalë 'trendy', nëse nuk nxjerr në rrjetet sociale foto me tuftën e luleve, mundësisht më të madhe se shoqja, ushqimet luksoze nëpër restorante, pushimet e shtirura nëpër resorte. Le të mos flasim pastaj edhe për meshkujt e rritur "me pekule", që nuk janë të aftë të marrin përgjegjësitë minimale në jetë dhe ndërtojnë familjet e tyre të reja, ngaqë janë bosh, dembelë abuzivë, të paqartë për jetën, të padenjë për bashkëshortët, e ndoshta dhe fëmijët e tyre të lindur rastësisht diku... Nga abuzimi nuk lind asgjë e mirë në jetë!

Ironia qëndron në faktin, se këta të fundit nuk kanë fatin as të bëjnë dot diferencën reale midis tyre dhe brezave paraardhës, sepse nuk kanë ndjesi për asgjë "hipotetike", janë pafund materi-



alistë dhe këtë e vetëquajnë "pragmatizëm" të kohës.

Kjo është për të ardhur keq! Brezi i kohës po humb shumë nga vlerat njerëzore pa e kuptuar fare sesli.

Të mos harrojmë se, çdo person në një rol të caktuar është objekt sanksionesh, që vjen prej influencave sociale, apo dhe presion prej t'u sjellë sipas normave dhe standardeve të një shoqërie të caktuar. Prandaj, për çdo individ ka një praktikë tradiocinale apo kulturore që nga moment i ngjizjes së tij e gjatë gjithë jetës në vazhdim, ka të drejtë dhe shumë detyra e përgjegjësi. Njeriu ka lindur për të jetuar si i përgjegjshëm në jetë.

Dhe, në këtë këndvështrim asgjë nuk është e parëndësishme në ardhjen në jetë të një individit, e në vazhdim gjatë gjithë kurbës kohore e gjeografike që ai përshkruan me gjithë brezin e vet. Kjo nuk është e rastësishme, por një bashkëprim faktorësh dhe elementesh social-kulturore e psikomocionale që e "trupëzojnë", e konfigurojnë atë qysh nga minuta parë e ngjizjes së tij. Dhe, si rregull vjen në jetë duke qarë "për ta fituar" atë, luftën e jetës si një filiz i ri, të cilit i përkushtohemi kaq shumë.

Megjithatë është i mirënjohur fakti, se faktorët kulturore dhe ekologjikë prekin aftësinë krijative të genies njerëzore. Ndërsa aftësitë intelektuale zhvillohen me rregulla të njëjta shoqërore, dhe ato mund të ndryshojnë nga njëra kulturë tek tjetra, vetëm në varësi të kontekstit ekologjik dhe

vetë normave social-kulturore.

Personaliteti i njeriut, si një rezultat e bashkëveprimit të organizimit me ambientin, ka gjasa të shfaqet me karakteristikë të ndryshme në kultura të ndryshme për shkak të ndryshueshmërisë së përvojave jetësore, e sidomos familjare. Sepse studimi i personalitetit të njeriut lidhet me modelet e sjelljes që janë tipike për një person dhe e dallojnë atë nga të tjerët.

Referuar studimeve mbi karakteristikat e rritjes së individit nëpër vende e kultura të ndryshme gjenden kudo prej më shumë se një shekulli, ato përmbledhin si dallimet, ashtu edhe ngjashmëritë e brezave.

Dimensione të tilla tregojnë, se kulturat janë shpesh të ndryshme nga njëra-tjetra, po ashtu edhe brezat, dhe rolet që u vishen djemve e vajzave janë, gjithashtu, të ndryshme dhe konkurruese ndërmjet kulturave apo dhe brenda vetë një kulture.

Pozicionimi metodologjik ka të bëjë me kuptimin e influencave që i vijnë vetë individit prej ndikimeve që lidhen me familjen dhe popullatën në përgjithësi, prandaj bashkëveprimi i faktorëve të ndryshëm, qoftë në nivel individit, ashtu edhe kombëtare është mjaft i rëndësishëm. Këto faktorë objektivë dhe subjektivë duke u rritur, e bëjnë individin viktimë të futjes instiktive në garë për të fituar me çdo kusht. Kështu, njeriu jeton, rritet dhe përsoset! Dhe nis natyrshëm edhe "konflikti" i brezave, por çdo brez ka "sharmin" e vet.

Çfarë "sharmi" ka brezi i ri i sotëm? - Militantizmin!

Tek ne sot rritet një brez i ri shumë më ndryshe se dikur, ndërkohë që teoria e militantit të bindur qëndron si tendencë mbijetese më e shëmtuar se kurrë. Behu militant i devotshëm, dhe si me magji jeta t'i dhuron të gjitha begatitë e saj. Ky është brezi i së ardhmes për rininë shqiptare sot? Vajtuete vërtet!

Mos vallë realiteti ynë mund të jetë kthyer në një kurth? Ç' mund të presësh nga një brezi i ri, i cili është thjesht një diplomadashës dhe asgjë më shumë? Brez, të cilit i intereson historia e kombit të vet, vetëm sa për kuriozitet. Përkundrazi, marrëdhënia e qytetarit shqiptar me shtetin duhet të jetë jeta e përditshme. Dhe, jo se nuk ka individë të tillë brenda brezit që reagojnë dhe integrohen me seriozitet, vëzhgojnë ngjarjet e ndryshme sociale, por masa dërrmuese thjesht mediton të mirat e siguruara lehtësisht nga familja ose vegjeton brenda privilegjeve të abuzuara.

Përfundimisht, sfida permanente e mbijetesës ka sjellë zhvlerësimin të thuajse gjithçkaje, edhe atë të jetës. Rinia ecën drejt një tuneli të errët e të pafund, të vjetrit ankohen për ta e për jetën e vështirë, e ngajnë si dy shina treni që nuk takohen dot kurrë.

Kështu, brezat po sfidojnë njeri-tjetrin me arrogancë, madje mospëfillje fyese dhe asgjë të sigurt nuk japin dhe marrin dot në këtë vend. E ardhmja është e zymtë për ta!

HOROSKOPI

DASHI

Do të keni një ditë të këndshme të formuar nga treshja Diell, Neptun dhe Mërkur në shenjë tuaj, dhe ky i fundit përballë Hënës krijuese dhe sensuale. Fjalë romantike, por jo vetëm: në çift do të komunikoni me shikime, përkëdhelje dhe gjeiste dashurie.

DEMI

Pozicioni i Hënës do të bëjë që të kërkonti më shumë liri nga familja e sotme nuk do të rotullohen. Veprime të caktuara janë të teprta për një shpirt të lirë si i juaji. Hendeku mes brezave, është domethënës dhe i dyfishit, sepse ju, fëmijët e së ardhmes, kështu jeni gatuar.

BINJAKET

Të llastuar nga Dielli dhe Neptuni, do të ndiheni të mbrojtur dhe do të keni nxitje për të dhënë me shumë. Do të jeni të frymëzuar me fjalë e dashurie që edhe një poet do t'i kishte zili. Hëna do të bëjë që të jeni të ndjeshëm dhe të qëndrueshëm: të lumtur në çift dhe me fëmijë.

GAFORJA

Hëna është e zbehtë, ndërsa planetët përreth saj vënë theksin te shtëpia dhe burimet për ta zbuluar atë. Në qendër të mendimeve tuaja keni familjen. Do të gëzoheni ndërsa do të takoni disa kolegë tuaj, ndërsa keni datë shtëjtje.

LUANI

Hëna nuk ju sheh drejtë, por e bën këtë pa të keq, por thjesht për të futur pak xhelozji që i zbut partnerët. Dielli-Mërkuri-Neptuni në një treshje të mrekullueshme ju bën të keni frymëzim romantik dhe të flisni e të lexoni për dashurinë.

VIRGJERESHA

Do jetë një ditë shumë e qetë dhe paqësore, e dobishme për ata që kanë punë të ngutshme për të bërë ose që duhet të bëjnë punime në shtëpi. Sot është i rëndësishëm edhe kontakti fizik. Me një lehtësi shprehni të gjithë thellësinë e ndjenjës.

PESHORJA

Treshja e formuar nga Dielli, Mërkuri dhe Neptuni, që janë kundra, zbutet me kalimin e Hënës, dhe kjo është arsyeja pse sot shkoni mirë me partnerin! Gjithashtu, të qetë me partinë dhe fëmijët, gjeni pak kohë të lira për të kaluar kohë në natyrë.

AKREPI

Hëna lart në qiell përballë shenjes suaj është gjithmonë një burim keqkuptimesh dhe dhimbje koke, sidomos për ata që kanë pushtet ose për ata që duan të marrin pushtet. Një marrëdhënie pune po fillon që t'ju shtrëngojë: keni nevojë për të nxjerrë në pah cilësitë tuaja.

SHIGJETARI

Hëna është në harmoni me shenjë tuaj dhe treshja Diell-Mërkur-Neptun, me të cilët keni marrëdhënie të mira. Shfrytëzoni pikat e juaja të forta tuaj. Me miqtë keni mirëkuptim të përkryer, dhe kur dikush ju këshillon dëgjoni me kënaqësi.

BRICJAPI

Me mendjen e turbullt, mes fantazive të paralizueshme dhe projekteve të cunuguara. Nëse kërkonti gjëra, dhe është mirë që e bëni, mbështetja nuk do t'ju mungojë. Ajo që mungon sot është në veçanti dëshira të hyrë në lojë, duke shfrytëzuar kapacitetit tuaja.


UJORI

Hëna ju bën të ndiheni të sigurt, të mbështetur nga Dielli, Mërkuri dhe Neptuni. Do të shfaqni prova të mëdha të miqësisë dhe idealesh të përbashkëta me të njohurit. Do të tregoni gatshmëri drejt një kolegu, i cili po kalon një fazë të vështirë. E dini që vepra do t'ju shpërblehet.

PESHQIT

Planifikimi i mirë është shpirti i punës, sidomos kur ju duhet të merreni me çështje praktike, dhe, për t'i përmbledhur, të mërztishme. Vizioni mi ngjyra portokalli për të rënë në sy, dhe bëni mirë të shmangni të kuqen: nëse jeni të lodhur,

Kristiano Ronaldo është mbreti i futbollit edhe për vitin 2017. Ylli portugez i Real Madridit fiton çmimin prestigjioz "Topi i Artë", duke mposhtur në finish rivalin e tij më të madh, Leo Mesin dhe brazilianin Neymar. Në një mbrëmje spektakolare të organizuar në Tur Eifel, ka qenë një tjetër Ronaldo, fenomeni brazilian, ai që shpallur fituesin, ndërsa në



Portugezi fiton çmimin e madh "Topi i Artë"

Kristiano Ronaldo, mbret i futbollit për vitin 2017

strukturën gjigante prej çeliku në mes të kryeqytetit parizien, qëndronte asi portugez me trofeun e çmuar në duar. "Jam shumë i lumtur, është një moment fantastik për karrierën time. E kam pritur gjatë kësaj. Ky vit ka qenë madhështor. Fitimur Champions League dhe kam

pionatin dhe në aspektin personal, unë isha kryegolas-hënues në Champions. Trofetë në nivele të tilla nuk fitohen vetëm dhe unë dua të falënderoj kolegët e mi të Real Madridi dhe Portugalia". 31-vjeçari arrin këtë sukses për herë të pestë në karrierë dhe barazon rekor-

din e argjentinasi të Barcelonës, duke u bërë kështu dy lojtarët që e kanë fituar më së shumti këtë trofe në histori, shenjë kjo edhe e rivalitetit të madh mes tyre në fushën e futbollit. Madrileni e ka siguruar këtë trofe dhe në vitet 2003, 2013, 2014 dhe 2016.

Jang Bojs fitojnë "in extremis" ndaj korçarëve dhe përmbysën golin e Enis Gavazajt në minutën e 51-të

Skënderbeu humbet në Zvicër, trajneri Daja e ka me gjyqtarin

Korçarët akuzojnë: Li Evans, katastrofë



Jeton Selimi

Skënderbeu nuk ia del të marrë pikë në Bernë ndaj Jang Bojs. Skuadra korçare është mposhtur në limitet e takimit nga helvetët dhe e ka mbyllur aventurën e saj në Kupat e Europës me humbje. Ndeshja në "Stad de Suis" është e fortë dhe bardhekuqtë shfaqen kryelartë në fushën e lojës, të mbështetur dhe nga mjaft bashkatdhetarë nga Zvicra. Pjesa e parë e takimit do të mbyllet me rrjetat të paprekura, por e dyta nis furihëm për të besuarit e Ilir Dajës, teksa Enis Gavazaj tregohet më i shpejtë se të gjithë në një top të mbetur vakant në zonë dhe çel rezultatin e ndeshjes në minutën e 51-të. Megjithatë, Jang Bojs do të reagojë shumë shpejt dhe katër minuta më pas, Horo reali-

zon një gol shumë të bukur me kokë, duke vendosur në barazpeshë takimin. Ndeshja është e hapur, me dy ekipe që kërkojnë ta fitojnë takimin, por duket se gjithçka do të vultose në barazim. Por në kohën shtesë vjen përmbysja e madhe e të zotëve të shtëpisë, me Asale, që përfiton nga një rrëmujë në zonë dhe tund rrjetën e Shehit. Dëshpërohen korçarët pasi nuk ka më sekonda për të rikuperuar, ndërsa Skënderbeu me këtë humbje zbrret i fundit në grupin B me 5 pikë, teksa u parakalua pikërisht nga Jang Bojs, që



u ngjiti në kuotën e 6 pikëve. Partizani i Beogradit ishin kualifikuar më herët.

TRAJNERI

Pas humbjes 1-2 kundër Jang Bojs, trajneri i Skënderbeut, Ilir Daja u shpreh: "Si duket Europa na do kaq shumë sa nuk na jep vizat. Sot s'kishim asnjë sulmues. Soue ishte i dëmtuar, ndërsa Xhejms nuk mori vizën. Arbitri nuk na dha një penallti dhe erdhi më kërcënoi se do të bënte raport pas ndeshjes. Ishte katastrofë, nuk di ç'të them. Donim ta mbyllim me vendin e tretë, por nuk kemi ç'të bëjmë. Nuk ishim me nervozë, por arbitri. I thashë gjyqtarit që s'mund të më qëndronte aq pranë në momentin që po bisedonte me mua. Jo ai, po askush s'ka shanse të më rrijë aq afër. Secili ka hapësirën e tij dhe mund të bisedojë me mua atje ku ka vendin e tij".

TRAJNERI VË PIKAT MBI "I"

Milinkoviç: Asnjë përplasje me Halilin, Gjici nuk më ndërhy

Në konferencën e zakonshme për shtyp, që të Kukësi zhvillohet dy ditë para ndeshjes, trajneri i kampionëve, serbi Mladen Milinkoviç, para se të fokusohet te ndeshja me Lushnjën dhe objektivat, u pyet në lidhje me përplasjen me menaxherin e ekipit, Naim Halilin. "Me z. Halilin nuk kam pasur asnjë konflikt. Ato që thuhet në gazeta janë tërësisht të pavërteta. Z. Halili më ka prezantuar te presidenti Gjici dhe e ka bërë se ka besuar tek unë. Kemi pasur dhe kemi bashkëpunim shumë të mirë, pavarësisht debatave konstruktive. Kjo është çështje e mbyllur". Më tej, trajneri i Kukësit foli për ndeshjen e radhës me Lushnjën dhe objektivin për 9 pikë në 3 javë: "E rëndësishme është të kthehem te fitorja dhe për këtë po i kushtojmë rëndësi ndeshjes. Besoj se ekipi do të reagojë dhe do të marrë fitoren, jo vetëm në këtë ndeshje, por edhe në vazhdim. Patjetër që duhen marrë jo vetëm këto pikë, por edhe të tjerat, pasi besojmë te titulli. Po t'i referohemi fazës së parë të vitit të kaluar, jemi në të njëjtat rezultate. Nëse nuk arrijmë objektivin e 9 pikëve, megjithëse kam marrëdhënie korrekte me presidentin, do të respektoj vendimin e tij. Ai kurrë nuk ka ndërhyrë në punën time. Edhe me tranjerët që kanë qenë te Kukësi para meje, me të cilët kam flur, kanë thënë të njëjtën gjë. Ne flasim disa herë në javë, pasi ai interesohet për ekipin".



DERBI I MAŇÇESTERIT

Basti i Pogbas: Po nuk mposhtëm Sitin, lë futbollin

Pas ndeshjeve të fundit në fazën e grupeve për "Champions League", ekipet e Mañçesterit do të kthehen në Angli për të diskutuar fitoren në një nga derbit më të zjarrtë në Europë. Siti është duke kaluar një sezon të mrekullueshëm në Premier League, deri në këtë fazë të kampionatit. Mañçester Siti është ndalur vetëm në një barazim kundër Evertonit, duke i fituar të gjitha takimet e tjera. Por Paul Pogba nuk beson se kjo ecuri e rivalit "të përjeshëm" nuk do të vazhdojë për shumë gjatë. I pyetur nga mediat angleze në lidhje me performancën e kundërshtarit, i cili është i pandalshëm në kampionat, Pogba shprehet: "Nëse unë nuk besoj, atëherë unë e lë futbollin tani. Fatkeqësisht nuk do të luaj në atë takim, por do të jem prezent në stadium për të ndihmuar skuadrën. Kjo është një ndeshje e madhe mes dy ekipeve të mëdha, në një qytet. Por kam besim të plotë tek ekipi i Junajdit. Në duhet të mbyllim ndeshjen me rastin e parë që paraqitet, pasi kundërshtarit mund ta bëjë këtë në çdo moment me kualitetet që ka në ekip", është shprehur Pogba.



NË SULMUES PËR DURON



Flamurtari prezanton serbin


Nedeljkoviç

Merkatoja e dimrit nuk është hapur ende zyrtarisht, por klubi vlonjat e ka bërë tashmë afrimin e parë zyrtar. Bëhet fjalë për një lojtar sulmues. Serbi Igor Nedeljkoviç është prezantuar si lojtari më i ri i Flamurtarit. Lojtari 26-vjeçar vjen nga një përvojë në Hong Kong me Pegasus, ndërkohë që më parë është aktivizuar në Serbi, Mal të Zi, Maqedoni dhe Bosnjë Hercegovinë. Periudhën më të mirë, sulmuesi serb e ka pasur me Sileksin në Maqedoni, ku në 91 ndeshje ka shënuar 27 gola. Trajneri Duro duket se e njeh mirë këtë lojtar nga koha kur edhe ai ka drejtuar Shkëndijën e Tetovës në kampionatin maqedonas. Klubi ende nuk ka dhënë detaje në lidhje me kohëzgjatjen e kontratës apo anën financiare. Faqja zyrtare e klubit kuqzi ka publikuar lajmin e afrimit të këtij lojtari dhe foto e prezantimit të tij me fanellën e Flamurtarit. Vlonjatët duan të forcohen në merkaton e dimrit dhe në planet e tyre është edhe maqedonasi Muarem Muarem.


80 MILIONË EURO PËR ARGJENTINASIN

Në Spanjë e bëjnë të kryer, Ikardi në janar kalon te Reali

Mauro Ikardi do të jetë futbollisti i ri i Real Madrid spanjolle, të cilat insistojnë se ka një akord mes palëve për transferimin e futbollistit nën urdhrat e Zinedin Zidan. Sipas "Diario Gol", gjithçka është caktuar në detaje, në mënyrë që lojtari të fillojë që në ditët e para të janarit punën me klubin e tij të ri. Tri ditë pas "El Clasico" ndaj Barcelonës, më saktësisht më 26 dhjetor, ai do të kryejë vizitat mjekësore për klubin e tij të ri në një klinikë në Madrid. I njëjti burim shpjegon se Interi do të përfitojë 80 milionë euro menjëherë nga shitja e kapitenit në radhët e klubit madrilen, ndërsa do të sigurojë më pas edhe bonuse që kanë lidhje me paraqitjen e tij të mëtejshme me klubin e ri. Nga ana tjetër, lojtari do të përfitojë një rrogë prej 9 milionë eurosh në klubin e tij të ri.



Fjalëkryqi (1)



- 37. Fillojnë detyrën.
- 38. Bektashi këngëtare.
- 39. Andrea aktore.
- 41. Sampras i tenisit.
- 43. Shkroi Korbi (indic).
- 44. Triolet e Trëndafilë me kredi.
- 46. Kilmer aktor.
- 47. Në krye të robotëve.
- 49. Unë dhe ti.
- 50. Një mund të jetë fetar.
- 51. Stephanie poet francez

VERTIKAL.


- 1. Fillojnë praktikën.
- 2. Britma e Arkimedit.
- 3. Ekstreme në trap.
- 4. Në fund të fundit.
- 5. Janë fjetoret e ushtarëve
- 6. Parker regjisor.
- 7. Vivaldi kompozitor.
- 8. Një shkop për karambol.
- 9. Janë firmat rentiere.

HORIZONTAL

- 1. Riza aktor.
- 7. Një fjalë si hiç.
- 11. Një mund të jetë diplomat.
- 12. Premtori të bëhet as.
- 14. Janë felinë... të zinj.
- 16. Ami i Maupassant.
- 18. Heroi i Emilio Salgarit.
- 19. Qe anarkist i famshëm rus
- 21. Një mungesë gjaku.
- 22. Susanna shkriktare
- 23. Të parat në cilësi.
- 25. Mbyllin një shtëpi.
- 26. Mbeten në fund.
- 27. Qendër në kaos.
- 28. Ka bërë piktoreskë një i tillë
- 30. Inicialet e Camus.
- 31. Motra...e Kolë Idromenos
- 33. Një konfuzion total.
- 34. Rastet pa set.
- 36. Rastisin në krye.

- 10. Një i fundit mbi të gjithë
- 11. Kufizojnë tatimet
- 13. Janë nomadë.
- 15. Panik pa kufij.
- 16. Fryn detin
- 17. Sidney regjisor i Serpico.
- 18. Jep alarmin.
- 20. Fillojnë nazet.
- 24. Janë llogari.
- 25. Alan regjisor.
- 29. Roman regjisor.
- 32. Eshhtë X ajo e sulmit.
- 33. Kapen të parat.
- 35. Një provë... inteligjence.
- 37. Një markë lap top.
- 40. Fillojnë matjet.
- 41. Rruga e Ferenc Molnar.
- 42. Qerre pa qe.
- 45. Fillojnë lirinë.
- 46. Fillojnë vallen.
- 48. Në mes të dhomës.


Fjalëkryqi (2)




- HORIZONTAL
- 1. Një doktor... i Fritz Lang
 - 6. U paraprind hoteleve.
 - 11. Kush nuk ka... nuk ha
 - 13. Eshhtë djall
 - 14. Një mund të ketë i rrallë.
 - 15. Ishin perëndi të Samotrakias.
 - 17. Institucione Botuese Autonome.
 - 18. Eshhtë infeksion në bark
 - 20. Fundi i një samurai.
 - 21. Një markë kafeje.
 - 22. Mbyllin një hark.
 - 23. Mund të jetë emërore.
 - 25. Ishte muzikanti që nuk përsriste.
 - 28. Në krye të avokatëve.
 - 29. Qerre pa qe.
 - 30. Një pjesë e adoleshentëve.
 - 32. Një banor imagjinar i planetit të kuq.
 - 35. Nuk shuhej dot nga Tantal.

VERTIKAL


- 1. James, armiku i Sherlock Holmes.
- 2. Eshhtë edhe ajo saudite.
- 3. Imami aktore
- 4. I kanë çift turket.
- 5. Inicialet e Seagal aktor.
- 6. Eshhtë dëshmore... çudibërëse.
- 7. Në fund të lutjes.
- 8. Eshhtë sporti me stil të lirë.
- 9. Mbeten në fund.
- 10. Eshhtë rasti i veçantë, karakteristik.
- 12. Conan ai i Schwarzenegger.
- 13. Gjysmë ditari.
- 15. Mario, që qe bomber argjentinas.
- 16. Mund të prishej nga një... klepçë.
- 18. Në hyrje të pistës.
- 19. Një numër... femrash.
- 21. Eshhtë qyteti i Besësë.
- 24. Qyteti që quhej edhe Sebaste.
- 26. Njëloj për latinët.
- 27. Mund të bëjnë stil të lirë.
- 31. Damon aktor.
- 33. Eshhtë pije e jona.
- 34. Në krye të noterëve.
- 36. Film i Robert Altman.
- 38. Skuadra merengue.
- 39. Një pjesë e hasmërisë.
- 40. Rrallë eshhtë përgjysmë.
- 42. Nisur pa kufij.
- 45. Fillojnë mobilizimin.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

	5	8					9	
			7	5			2	
	3	1	9				4	
					9	4		
9		3				1		6
		6	8					
	6				8	5	1	
		7		9	5			
9						7	6	

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

3	9	5	1	7	2	8	6	4
6	1	7	8	4	3	9	2	5
2	4	8	6	9	5	7	3	1
5	3	9	4	8	7	6	1	2
1	2	4	3	6	9	5	7	8
7	8	6	2	5	1	4	9	3
4	7	3	5	1	6	2	8	9
8	6	2	9	3	4	1	5	7
9	5	1	7	2	8	3	4	6

Argëtim filozofik

- Duke mbrojtur veten ke mbrojtur tjerët; duke mbrojtur tjerët ke mbrojtur veten.
- Fjalët kanë fuqinë e të shktruarit dhe të krijimit; kur fjalët janë të singerta dhe të këndëshme mund të ndryshojnë botën.
- Asgjë e gjallë s'duhet vrrarë, as insekti apo kafsha më e vogël, sepse çdo jetë është e shenjtë.
- Sa më pak të keni, aq më pak duhet të shqetësoheni.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm

6	2	9	13	15	11	7	2		1	11	2	7		
4	9	12	4	11		2		14	13	15	8	2		
	1	12	4	2	12	4	11		6	1	8			
4	11	2			5	10	3	1	15		12	2		
7	4	12			5	10	3	4	6	1	7	2	12	
3					5	10	3	1	14	4	6	1		
4	12	2			5	1	7	2	12		11	4	3	
7	10	6	10		14	4	8		12	10	7	4		
12	11	1			9	4			12	6		8	15	8
1	12				12	15	12	15		1	12	1		14
7	2	14	4	12										
4	12	1	7											

- Vdekja do jetë shumë e bukur nëse di të komunikohet me të. Eshhtë një shpërbërje, bie prapë në burimin e gënies për tu çlodhur e për tu rinovuar. Do të thotë, të zhdukesh në burimin e ekzistencës dhe të bashkohesh me Zotin – dhe mund të rilindësh prapë, deni sa të bëhesh i Zgjuar.

Chënie të mençura

- "Njeri lakimtar, që dëshiron që e gjithë bota të jetë e jotja. Kur gjaku yt do të bëhet ujë dhe do të rikthehet tek lumenjtë, kur kockat e tua do të bëhen dhë, dhe do t'i rikthehen tokës, atëherë do të jetë shumë vonë për të kuptuar se nuk është toka që të përket ty, por je ti që i përket tokës".

Shprehje Indiane

PËRGJIGJET E FJALËKRYQVE TË NUMRIT TË KALUAR

A	T	M	L	T	R	A	J	T	A	T		
P	L	K	A	P	A	L	I	E	N	E		
R	E	K	O	R	D	E	T	P	M	T	R	
I	A	N	S	A	M	B	L	I	H	E	M	
M	A	R	T	I	N	E	D	E	N	I	N	
O	H	A	R	A	T	T	I	T	R	A	T	
B	A	N	A	P	I	S	H	E	I			
E	P	I	T	E	T	E	T	T	E	S	T	
M	I	N	A	T	N	A	I	I	M	A	R	
I	K	A	A	K	R	I	M	A	R			
L	A	P	A	R	A	R	O	J	A			
E	T	I	K	A	S	E	N	A	T	O	R	
K	A	S	L	U	L	I	M	A	T	A		
A	R	R	A	S	B	A	R	N	U	M	R	
L	A	I	A	B	R	O	A	E	F	I		
L	E	L	E	M	E	N	T	A	R	E		
A	N	E	T	A	R	E	S	I	A	I	N	
M	I	N	I	M	A	L	A	L	E	K	O	
I	K	L	I	T	A	R	E	T	E	M	A	
E	S	E	N	I	T	E	R	I	E	R		
P	A	N	A	I	M	E	K	N	I			
E	T	N	I	E	M	I	N	E	M	A		
L	O	T	A	S	D	R	I	T	A	I		
A	L	A	I	N	E	M	I	S	A	R	E	T

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

GSH

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE



Tashmë edhe lundroni!

